



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 421 Akti

Nr. 541 Vendimi  
Tiranë, më 15.6.2022

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Kryesuese
<b>Olsi Komici</b>	Relator
<b>Xhensila Pine</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datat 10.3.2022, ora 10:00 dhe 13.6.2022, ora 14:05, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Bevis Shehaj**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, i cili kërkoj konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, z. Olsi Komici, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Bevis Shehaj, me detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e datës 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Subjekti i rivlerësimit iu nënshtrua procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët, Valbona Sanxhaktari kryesuese, Xhensila Pine anëtare dhe Olsi Komici në cilësinë e relatorit të çështjes. Nga anëtarët e trupit gjykues u deklarua mospasja e konfliktit të interesit, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, DSIK) dhe Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme. Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

4. Në datën 9.1.2020, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit (njoftimi i subjektit nga Komisioni dhe anasjelltas është bërë me postë elektronike) për fillimin e hetimit administrativ duke i komunikuar subjektit trupën e cila do të shqyrtojë çështjen. Subjekti deklaroi se nuk kishte konflikt me asnjë nga anëtarët e trupit gjykues.

5. Subjekti i rivlerësimit, në fillim të hetimit administrativ në datën 22.1.2020, depozitoi me postë elektronike një kërkesë paraprake për mosfillimin e procedurës së rivlerësimit. Në kërkesën e tij, ndër të tjera, subjekti parashtroi se nuk është subjekt rivlerësimi, pasi është emëruar në detyrë pas datës 22.7.2016, kur është ndryshuar Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ka hyrë në fuqi ligji nr. 84/2016. Qëllimi i ligjit nr. 84/2016 është rivlerësimi i gjyqtarëve e prokurorëve në detyrë dhe jo ata të cilët emërohen më vonë në kohë. Subjekti parashtron se emërimin në detyrë e ka marrë në datën 20.1.2017, ndërsa caktimi në pozicionin e gjyqtarit administrativ pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë e ka marrë në datën 10.2.2017. Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se KLD-ja deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, duhet të bëjë emërimin, si dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për magjistratë, të diplomuar në vitin 2016. KLD-ja ka kryer verifikimet përkatëse për secilin prej magjistratëve të diplomuar në vitin 2016, referuar dokumentacionit të ardhur nga ILDKPKI-ja, Prokuroria e Përgjithshme dhe prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe pas këtyre verifikimeve është bërë edhe emërimi magjistrat i subjektit të rivlerësimit.

Subjekti vlerëson se, kur është emëruar në detyrën e gjyqtarit, janë aplikuar të gjitha kriteret, të cilat duhet të aplikohen për çdo gjyqtar të ri, i cili ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të periudhës korrik-tetor 2016.

Sa më sipër, subjekti parashtron se duke qenë se në periudhën e rivlerësimit nuk ka qenë gjyqtar në detyrë, por kandidat për magjistrat (e shprehur qartësisht në ligjin nr. 96/2016, neni 160), si dhe meqenëse procesi i verifikimit është kryer nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (me kompetencat e plota të Këshillit të Lartë Gjyqësor), përpara emërimit “magjistrat” dhe caktimit të tij në pozicion, me vendimet respektive nr. \*\*\*, datë 20.1.2017 dhe nr. \*\*\*, datë 10.2.2017 (duke ushtruar kjo e fundit kompetencat që ushtron Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për gjyqtarët

dhe prokurorët e emëruar pas datës 8.10.2016), vlerëson se nuk është subjekt i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe, si i tillë, procesi administrativ për rivlerësimin tij duhet të përfundojë me një vendim jo përfundimtar (vendim mospranimi për shqyrtim, parashikuar nga neni 39/2 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”).

**6.** Komisioni në datën 29.10.2021 njoftoi subjektin e rivlerësimit se Komisioni ka vendosur me shumicë votash që të vazhdojë procesin administrativ ndaj tij. Komisioni arsyeton se:

*Së pari*, qëllimi i procesit të rivlerësimit nuk është të emërojë apo caktojë një magjistrat në detyrë, por të kryejë rivlerësimin kalimtar sipas Kushtetutës dhe ligjit për konfirmimin ose jo të tij në atë funksion.

*Së dyti*, parimet mbi të cilat zhvillohet ky proces parashikohen shprehimisht në Kushtetutë dhe jurisprudenca së cilës i referohet subjekti për përjashtimin nga procesi i rivlerësimit nuk cenon parimin e sigurisë juridike dhe atë të gjësë së gjykuar, i njeh të drejtat themelore të individit (jo ndaj zyrtarëve të lartë të shtetit apo funksionarëve të sistemit të drejtësisë).

*Së treti*, kufizimi i disa të drejtave për gjyqtarët dhe prokurorët, sipas Kushtetutës dhe Aneksit të saj, ka për qëllim krijimin e besimit të publikut te drejtësia dhe institucionet e reja të sistemit dhe ky qëllim realizohet përmes zbatimit drejtpërdrejt të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, nga institucionet e rivlerësimit dhe jo nga institucionet e emërtesës.

Organet e emërtesës, sipas ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, të ndryshuar, nuk mund të bëjnë rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, por vetëm verifikimin për efekt të procedurës së parashikuar nga rregullat e ligjit të ri nr. 96/2016. Pretendimi se subjekti është verifikuar nga organet kompetente, sipas ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, të ndryshuar dhe nenit 160 të ligjit nr. 96/2016, nuk do të thotë se është rivlerësuar. Kjo do të përbënte cenim të juridiksionit të institucioneve të rivlerësimit dhe tejkalim të parashikimeve kushtetuese nga organet e tjera.

*Së katërti*, Kushtetuta nuk ka parashikuar një rregullim të veçantë apo përjashtim të shprehur nga procesi i rivlerësimit, përkundrazi e lidh qëndrimin e mëtejshëm në detyrë, nëse kalohet me sukses procesi i rivlerësimit. Për pasojë, atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta tejkalojë asnjë ligj apo organ tjetër. Kushtetuta njeh institucionet e rivlerësimit dhe përcakton juridiksionin e tyre për zbatimin e procedurave të rivlerësimit ndaj subjekteve *ex officio* ose me kërkesë. Komisioni nuk emëron magjistratë, pasi është tagër dhe juridiksion i organeve kushtetuese të emërtesës, që parashikohen në ligjin themeltar dhe në ligjin organik të tyre.

Ligjet që janë miratuar pas ndryshimeve të Kushtetutës, nr. 84/2016 dhe nr. 96/2016, janë në zbatim dhe në frymën e Kushtetutës dhe juridiksioni i organeve kushtetuese duhet të jetë brenda kufijve që Kushtetuta përcakton për institucionet e rivlerësimit dhe për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë (KLGJ, KLP dhe ILD), përfshirë edhe kompetenca të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për periudhën tranzitore.

*Së pesti*, arsyeja pse ligji nr. 96/2016 bën përjashtim për subjektet magjistratë kandidatë të diplomuar në vitin 2016, që emërohen nga ish-KLD, qëndron për faktin se:

- Në pikën 1, të nenit 173, “shfuqizime”, të ligjit nr. 96/2016, shfuqizohen menjëherë me hyrjen në fuqi të ligjit për statusin disa dispozita të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, të ndryshuar, ndër to, edhe neni 28 “emërimi i gjyqtarëve”.
- Në pikën 2, të nenit 173, të ligjit nr. 96/2016, parashikohet shfuqizimi në tërësi i gjithë ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, të ndryshuar, me ngritjen e institucioneve KLGJ dhe KLP. Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe

prokurorëve” është botuar në Fletoren Zyrtare nr. \*\*\*, datë 7.11.2016 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit, pra, në datën 22.11.2016. Emërimi dhe caktimi i subjektit në detyrën e gjyqtarit është bërë në bazë të procedurave të reja të këtij ligji (96/2016), por organi i emërtesës është ligji nr. 8811, datë 17.5.2001, i ndryshuar.

- Në dokumentacionin e administruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor rezulton se subjekti ka pasur emërim të përkohshëm si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me dekretin nr. \*\*\*, datë 20.11.2015, të Presidentit të Republikës dhe “emërimi i përkohshëm” është një institut, që parashikohet edhe nga ligji nr. 8811, datë 17.5.2001, i ndryshuar, edhe nga ligji i ri nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Praktika/stazhi si gjyqtar me emërim të përkohshëm, e cila zhvillohet në vitin e tretë të Magjistraturës (vitet 2015-2016), e vendos subjektin në kushtet e ushtrimit të funksionit dhe të qenit në detyrën e gjyqtarit edhe pse me emërim të përkohshëm.
- Për rrjedhojë, automatikisht subjekti është në sferën e zbatimit të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe subjekti i këtij ligji. Ndërkohë që vetë ligji nr. 96/2016, i cili parashikon rregullimet tranzitore në nenet 164 dhe 169 të tij për gjyqtarët dhe prokurorët, në frymën e Kushtetutës dhe në zbatim të drejtpërdrejt të saj dhe të ligjit nr. 84/2016, e lidh qëndrimin e subjektit në detyrë dhe gëzimin e të drejtave dhe detyrimeve të gjyqtarëve me kalimin me sukses të procesit të rivlerësimit kalimtar. Subjekti, nga aktet e administruara rezulton të jetë trajtuar me pagën e gjyqtarit dhe pas përfundimit të stazhit duke u trajtuar si magjistrat në pritje të emërimit.

*Së gjashti*, vetë subjekti i rivlerësimit e ka konsideruar veten e tij si subjekt rivlerësimi, subjekt i ligjit nr. 84/2016, për arsye se me vullnetin e tij të lirë ka plotësuar dhe depozituar brenda afateve ligjore të përcaktuara nga ky ligj, deklaratat dhe dokumentacionin përkatës shoqërues, në lidhje me kriterin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

**7.** Në përfundim, trupi gjykues, për sa arsyeton më sipër, vlerëson se z. Bevis Shehaj, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ishte subjekt që duhej t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit *ex officio*.

**8.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 18.2.2022, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Bevis Shehaj, për të tria kriteret, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47, të Kodit të Procedurës Administrative.

**9.** Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 18.2.2022, mbi rezultatet e hetimit, të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e përfuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjektit iu la afat për dërgimin e prapësimeve dhe provave deri në datë 3.3.2022.

**10.** Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, në datën 27.2.2022, dërgoi pranë Komisionit prapësimet dhe provat në lidhje me rezultatet e hetimit.

**11.** Komisioni, në datën 4.3.2022 njoftoi subjektin e rivlerësimit që vendosi të administrojë provat dhe shpjegimet dhe e ftoi atë në seancën dëgjimore të caktuar për t’u zhvilluar në datën 10.3.2022, ora 10:00.

**12.** Subjekti i rivlerësimit në datën 9.3.2022, një ditë përpara seancës dëgjimore (më 10.3.2022), ka dërguar pranë Komisionit disa shpjegime të tjera shtesë së bashku me provat shoqëruese.

**13.** Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 10.3.2022, subjekti u njoftua për seancën e shpalljes së vendimit që do të mbahej në datën 16.3.2022, ora 09:30.

**14.** Komisioni, në seancën e datës 16.3.2022 që ishte caktuar për shpalljen e vendimit, i komunikoi subjektit të rivlerësimit se për shkak të depozitimit të një denoncimi, lind e nevojshme që të bëhen verifikimet përkatëse nga Komisioni, duke njoftuar riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë dhe kontrollin e figurës.

**15.** Komisioni, në datën 23.3.2022 ka njoftuar subjektin se ka vendosur, gjithashtu, të riçelë hetimin edhe për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe se do të njoftohet në vijim për seancën dëgjimore të radhës.

**16.** Subjekti i rivlerësimit në datën 11.4.2022 ka parashtruar dy kërkesa paraprake për të përfshirë motrën dhe bashkëshortin e saj si persona të lidhur me arsyetimin se dhe motra ka qenë në certifikatën familjare bashkë me prindërit deri në fund të vitit 2020, si dhe subjekti ka kërkuar nga Komisioni rillojaritjen e të ardhurave të tij dhe të prindërve.

**17.** Komisioni, në datën 3.6.2022, ka njoftuar subjektin se, në lidhje me kërkesën e tij për përfshirje të motrës I. Sh. në hetimin administrativ, ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë, ndërsa për rillojaritjen e të ardhurave do të merren në konsideratë për aq sa ato janë të ligjshme, në përputhje me ligjin dhe pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, Komisioni i njoftoi subjektin edhe rezultatet shtesë pas riçeljes së hetimit dhe të drejtën e tij për të depozituar prapësimet dhe provat përkatëse.

Në lidhje me arsyet e mospërfshirjes së motrës së subjektit I. Sh. në hetimin administrativ, Komisioni parashtron si vijon:

*Së pari*, nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike dhe në deklaratën *Vetting* nuk është deklaruar asnjëherë motra e tij as si person i lidhur dhe as si person tjetër të lidhur.

*Së dyti*, për pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting* (apartamenti dhe automjeti), subjekti ka deklaruar si burim të tyre ekonominë familjare me prindërit e tij, pa përfshirë motrën I. Sh. C.

*Së treti*, subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ ka kërkuar të mos përfshijë në asnjë hetim administrativ motrën I. Sh. C. dhe bashkëshortin e saj, të cilët jetojnë dhe punojnë në Gjermani

**18.** Subjekti i rivlerësimit në datën 9.6.2022 i ka dërguar Komisionit parashtrimet dhe provat përkatëse dhe ka paraqitur tri kërkesa paraprake, konkretisht: (a) kërkesën e përsëritur për përfshirjen në hetim të motrës dhe bashkëshortit të saj, në cilësinë e personave të lidhur, kërkesë për të cilën Komisioni i ka bërë me dije se kjo ka qenë refuzuar prej tij dhe është njoftuar me e-mail-in e datës 3.6.2022; (b) kërkesën për marrjen e tabulateve të dy numrave të telefonit dhe verifikimin e tyre prej vitit 2011 – 2019, me qëllim verifikimin nëse ka kontakte me ungjin e tij, kërkesë të cilën, Komisioni, bazuar në germën “a”, të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, nuk e ka pranuar.

**19.** Komisioni, në datën 10.6.2022 ka njoftuar subjektin e rivlerësimit në lidhje me kërkesat paraprake, si dhe me datën e seancës dëgjimore, e cila do të mbahej më 13.6.2022, ora 14:05.

**20.** Po, në datën 13.6.2022, subjekti i rivlerësimit përpara seancës dëgjimore depozitoi edhe disa shpjegime shtesë.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**21.** Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore të caktuar në datën 10.3.2022, ora 10:00 dhe pas riçeljes së hetimit administrativ të tri kritereve u ftua në seancën dëgjimore të datës 13.6.2022, ora 14:05. Të dy seancat dëgjimore u zhvilluan në përputhje me kërkesat e nenit 55

të ligjit nr. 84/2016, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar. Në të dy seancat, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe parashtrori shpjegimet e tij përpara Komisionit.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit Bevis Shehaj, kërkoi konfirmimin në detyrë.

### **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**22.** Z. Bevis Shehaj ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka zbatuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**23.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**24.** Për subjektin e rivlerësimit Bevis Shehaj, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

**25.** Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

##### **A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**26.** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.1.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Bevis Shehaj, i cili është subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së që prej vitit 2015, me numër indeksi \*\*\*, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Subjekti i rivlerësimit, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë - shtojca 2, në datën 24.1.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo pasuri të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e pasurive të deklaruara;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*

- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave

## A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

**27.** Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- b) deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- e) deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

**28.** Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; si dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

**29.** Në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë - shtojca 2, në zbatim të nenit 31/1<sup>1</sup>, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Bevis Shehaj ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, në datën 26.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

- Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *Vetting*

### Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit

**1. Apartament<sup>2</sup> dhe garazh, ndodhur në ish-Komunën \*\*\*, në pallatin e ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., me përfaqësues ligjor, z. A. Sh. Sipërfaqja e banesës është 62.94 m<sup>2</sup>, vendosur në katin e tretë të banimit të godinës. Banesa është blerë së bashku me garazhin dhe kanë vlerë totale 33.000 euro. Pjesa takuese: 100%.**

Subjekti, gjithashtu, ka deklaruar në deklaratën *Vetting* : “Kontrata e lidhur midis subjektit dhe shoqërisë ndërtuese identifikohet si në vijim: kontratë porosie (sipërmarrjeje), nr. \*\*\*, datë 20.8.2012. Ende nuk ka fituar statusin e pronarit të banesës, pasi midis tij dhe shoqërisë ndërtuese nuk është lidhur kontrata përfundimtare e shitjes. Në momentin e lidhjes së kontratës, shoqërisë i është derdhur në llogari si detyrim pagese bazuar në këtë kontratë, shuma prej

<sup>1</sup>Subjekti i rivlerësimit ka detyrim të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

<sup>2</sup>Subjekti ka depozituar: kontratë porosie (sipërmarrje) nr. \*\*\*, datë 20.8.2012 + praktika e kontratës; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 20.8.2012; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 20.8.2012; mandatpagesë nga “Tirana Bank”, datë 21.11.2011; mandatpagesë nga “Raiffeisen Bank”, datë 26.6.2013.

25.000 euro. Shuma tjetër prej 2.000 euro është paguar më vonë. Pjesa e mbetur e detyrimit është 1.000 euro, e cila do të likuidohet në momentin kur të merret certifikata e pronësisë. Shuma tjetër është mbajtur si penalitet për mosdorëzimin në kohë të sendit.

Kontrata fillestare e porosisë për të blerë apartamentin është lidhur në datën 16.11.2011 me kontratën noteriale nr. \*\*\*, të lidhur përpara noterit publik M. T.. Kjo kontratë është shfuqizuar në vitin 2012 me deklaratën noteriale nr. \*\*\*. Kjo pasi apartamenti i blerë nuk ishte ndërtuar ende dhe nuk dispononte ballkon.

Menjëherë, pasi është shfuqizuar kjo kontratë, është lidhur menjëherë kontrata e dytë, në të njëjtën ditë përballë të njëjtës notere (kontrata në fuqi). Banesa e re ndodhet në të njëjtin objekt ndërtimi, një kat më poshtë, pasi vetëm kështu sigurohej banesa me ballkon.

Në të njëjtin akt noterial, ku është lidhur kontrata e mësipërme e banesës, është bërë e mundur edhe blerja e garazhit, në të njëjtin objekt ndërtimi.

**1.1 Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** subjekti ka qëndruar deri në shtator të vitit 2016 në një ekonomi familjare me prindërit e tij, duke ndarë së bashku çdo gjë. Familja e tij ka paguar shkollimin në universitetin e \*\*\* dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ku edhe ka punuar). Pagesa është kryer nga kontoja bankare e familjes në emër të babait të tij (dëftesa bankare e bashkëlidhur). Gjithashtu, ka punuar në disa punë si brenda dhe jashtë vendit. Në Shqipëri ka punuar si pedagog i brendshëm pranë Universitetin \*\*\* dhe në SHBA në dy punë gjatë programit \*\*\* në vitin 2009 dhe 2010 (për më shumë shiko dokumentet e bashkëlidhur).

#### **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

1.2 Subjekti i rivlerësimit në datën 20.8.2012 ka lidhur kontratë porosie (sipërmarrje) nr. \*\*\*, me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., për apartamentin me sip. 62.94 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, të ndodhur në komunën \*\*\*, Tiranë, në katin e tretë dhe një garazh në katin bodrum nën tokë.

Çmimi në kontratë për të dy pasuritë është caktuar në shumën 33.000 euro. Në nenin 4 të kontratës përcaktohet se pagesa është paguar jashtë zyrës së noterisë, para lidhjes së kontratës.

1.3 Nga verifikimi i planimetrisë së këtij apartamenti dukej se apartamenti kishte në përbërjen e tij dhe një verandë me sipërfaqe 62.94 m<sup>2</sup>. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti në përgjigje të pyetësorit, datë 22.11.2021, ka sqaruar se nuk zotëron asnjë apartament, i cili të jetë pajisur me një verandë me sip. 62.94 m<sup>2</sup>. Banesa ka një ballkon të vogël prej rreth 2 m<sup>2</sup>. Subjekti ka vendosur në dispozicion foto të apartamentit të tij nga ku rezulton se nuk është i pajisur me verandë.

1.4 Për të provuar deklarinimin e tij, subjekti së bashku me deklaratën *Vetting* ka depozituar deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 20.8.2012, me deklarues subjektin dhe shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., të cilët me vullnetin e tyre prishin kontratën e porosisë nr. \*\*\*, datë 16.11.2011, duke u kthyer në gjendje fillestare pa asnjë detyrim.

1.5 Komisioni ka administruar kontratën nr. \*\*\*, datë 16.11.2011<sup>3</sup>, lidhur midis subjektit dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ku sipas kësaj kontrate sipërmarrësi merre përsipër të ndërtonte një apartament, me sipërfaqe 62.94 m<sup>2</sup> në katin e katërt të banimit dhe një garazh për çmimin 33.000 euro. Në nenin 4 të kësaj kontrate përcaktohet se është paguar e gjithë shuma prej 33.000 euro para lidhjes së kontratës jashtë zyrës së noterit.

1.6 OSHEE-ja konfirmon se kontrata për këtë apartament është hapur në emër të subjektit në datën 27.5.2015.

---

<sup>3</sup>Kthim përgjigje noter M. T., datë 24.11.2021.



1.7 Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar në deklaratën *Vetting* sipërfaqen e garazhit. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti në përgjigje të pyetësorit, datë 22.11.2021, ka sqaruar se arsyeja e mosdeklarimit, posaçërisht, të sipërfaqes së garazhit është se nuk është e përcaktuar në kontratë, por vetëm është pasqyruar në planimetrinë e garazheve dhe se nga praktikat e mira të shitjes së apartamenteve dhe garazheve në Tiranë dhe Vlorë, në dijeninë e tij, sipërfaqja e garazhit nuk përcaktohet në pjesën e shkruar të kontratës, pasi kjo sipërfaqe është standarde 4x3, rreth 12 m<sup>2</sup>. Sipërfaqja e garazhit nga matjet e tij në terren rezulton se është rreth 12 m<sup>2</sup>. Subjekti ka vënë në dispozicion foto të garazhit.

1.8 Subjekti në deklaratën *Vetting*, në lidhje me pagesën e çmimit, ka deklaruar se në momentin e lidhjes së kontratës shoqërisë i është derdhur në llogari si detyrim pagese bazuar në këtë kontratë shuma prej 25.000 euro. Shuma tjetër prej 2.000 euro është paguar më vonë. Pjesa e mbetur e detyrimit është 1.000 euro dhe do të likuidohet në momentin kur të merret certifikata e pronësisë. Shuma tjetër është mbajtur si penalitet për mosdorëzimin në kohë të sendit.

1.9 Deklarimi i subjektit nuk përputhet me:

i) Deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 20.8.2012, me deklarues subjektin e rivlerësimit dhe shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., të cilët me vullnetin e tyre deklarojnë se:

- subjekti ka porositur apartamentin nr. \*\*\*, në katin e tretë të banimit të shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në shumën 33.000 euro, shumë të cilën ia ka kaluar z. A. H. me llogari bankare për llogari të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.;
- z. A. Sh. si përfaqësues i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. i ka dhënë me kontratë porosie apartamentin nr. \*\*\*, kati i tretë i banimit, shtetasit Bevis Shehaj, këtë apartament e kishte porositur shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me A. H. me *klering*, por kontratën e bëri direkt me shoqërinë e tij, shuma e porosisë të këtij apartamenti i ka kaluar në llogari shtetasve A. H. nga Bevis Shehaj.

ii) Deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, plotësuar në datën 20.11.2015, ku deklaruar se ka shlyer detyrimin e plotë për një apartament me sip. 62.94 m<sup>2</sup>.

1.10 Në lidhje me mospërputhjen për shumën e shlyer të çmimit të apartamentit, subjekti ka sqaruar se të dyja deklaratimet, pavarësisht mënyrës së përpilimit të tyre prej tij, synonin të tregonin që kontrata e apartamentit dhe e garazhit ka përfunduar së likuiduari. Në deklaratën *Vetting* ka dashur të jetë më specifik, duke ndarë llojet e pagesave të kryera për llogari të sipërmarrësit, duke dashur të nënvizojë se pjesa tjetër nuk do të paguhet për shkak të vonësive në dorëzim, por edhe për shkak të punimeve të pakryera prej sipërmarrësit si lidhja e dritave, ujit apo edhe punime të tjera relativisht të vogla të kryera nga vetë banorët e pallatit.

1.10.1 Për të provuar pagimin e çmimit të apartamentit, subjekti së bashku me deklaratën *Vetting* ka vënë në dispozicion: (a) mandatpagesë nga “Tirana Bank”, ku në datën 17.11.2011, z. B. Sh. i ka depozituar z. A. H., për blerje apartamenti shumën 25.000 euro. Burimi i deklaruar janë të ardhura nga kursimet; (b) mandatpagesë dt. 26.6.2013, nga “Raiffeisen Bank”, ku z. B. Sh. i ka depozituar znj. A. D. G. me përshkrim “A. H. për A. Sh., shumën 2.000 euro”.

1.11 Komisioni, për sa më sipër, ka konstatuar se:

i) Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se ka shlyer shumën 27.000 euro, deklarim i cili përputhet dhe me dokumentacionin bankar të vënë në dispozicion nga subjekti.

ii) Subjekti në DIPP-në e vitit 2015 ka deklaruar se ka shlyer plotësisht apartamentit në shumën 33.000 euro.

iii) Në nenin 4 të kontratës së shitblerjes përcaktohet se pagesa është paguar jashtë zyrës së noterisë, para lidhjes së kontratës.

1.12 Bazuar në konstatimet e mësipërme, rezulton një mospërputhje në lidhje me shumën totale të paguar nga subjekti i rivlerësimit për këtë apartament, pasi në DIPP/2015 dhe në kontratë ka deklaruar se ka paguar shumën 33.000 euro, ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se ka paguar shumën 27.000 euro dhe i detyrohet shoqërisë shumën prej 1.000 euro.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

1.13 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka shpjeguar se për deklarimin e pasaktë të të dhënave mbi pasurinë e tij në ILDKPKI ka qenë në një bindje të gabuar se deklaramet pranë ILDKPKI-së nuk duhet të shoqëroheshin me dokumentet justifikues, por duhet vetëm të deklaroheshin, duke plotësuar formularin standard të vetëdeklarimit të pasurive.

Në rastin e deklarimeve *Vetting*, përveç plotësimit të deklaratës tip, subjekti ka bashkëlidhur edhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar burimin e pasurive të tij. Për sa më sipër, subjekti thekson se deklaramet e tij janë kryer me ndërgjegje dhe ndershmëri të plotë për të provuar të gjitha pasuritë dhe burimet e ligjshme të tyre, pavarësisht faktit se nuk ka bashkëlidhur gjithë dokumentacionin e plotë provues.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga ana e tij nuk është depozituar asnjë dokumentacion për të vërtetuar se është paguar vetëm shuma 27.000 euro dhe se i detyrohej shoqërisë shumën 1.000 euro. Deklaramet e subjektit për sa kohë nuk janë të shoqëruar me dokumentacion provues mbeten në nivel deklarativ, duke mbetur e paprovuar për Komisionin vlere reale e paguar nga subjekti për këtë apartament, si dhe zbritja e çmimit në shumën 5.000 euro, e shoqëruar kjo me dokumentacionin përkatës mes palëve. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se subjekti, në kuptim të nenit 33/5 germa “a”, të ligjit nr. 84/2016, nuk ka kryer deklarim të saktë në përputhje me ligjin në lidhje me shumën e paguar për blerjen e apartamentit, detyrimin që subjekti kishte ndaj shoqërisë dhe zbritjen e çmimit të këtij apartamenti në vlerën 5.000 euro.

### **Analizë burimit të krijimit të këtij apartamenti**

1.14 Subjekti në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës ka deklaruar se apartamentin e kishte përfituruar dhuratë nga familja (nëna dhe babai). Në lidhje me këtë deklaramet, subjekti në përgjigje të pyetësorit të datës 22.11.2021 ka sqaruar se si në deklaratën *Vetting*, ashtu edhe pranë ILDKPKI-së, ka evidentuar faktin që kjo pasuri është blerë nga familja e tij (prindërit). Ajo që ka deklaruar shtesë në deklaratën *Vetting*, duke dashur të jetë më specifik, është se në blerjen e kësaj pasurie ka ndikuar modestisht edhe pasuria e tij personale, në kohën kur ishte student dhe ka punuar në SHBA, në vitin 2009 dhe 2010. Por në asnjë moment nuk e mohon faktin që kjo pasuri është dhuratë nga familja e tij, pjesë e së cilës është edhe ai vetë.

1.15 Në përgjigje të pyetësorit të datës 22.11.2021<sup>4</sup>, subjekti ka qartësuar se nga puna e tij si student në SHBA, në vitin 2009 dhe 2010, ka fituar rreth 15.000 USD (duke përfshirë edhe taksat e paguara për shtetin amerikan, por të kthyer më pas, sipas një procedure ligjore). Në lidhje me të ardhurat e babait, subjekti ka bashkëlidhur me deklaratën *Vetting* të ardhurat nga paga si mjek gjinekolog pranë Spitalit Rajonal të V., si dhe të ardhurat e tij, ndër vite, të deklaruara pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, apo edhe pranë Drejtorisë të Tatim-Taksave pranë Bashkisë Vlorë pas vitit 2010, kohë kur është formalizuar regjistrimi i subjekteve tregtare

---

<sup>4</sup>Shihni pyetësorin datë 22.11.2021.

edhe për personat fizikë. Babai i subjektit ka qenë pronar i një klinike private prej vitit 1998 e në vijim në qytetin e V., fakt që provohet nga dosja e legalizimit numër \*\*\*.

1.16 Komisioni, referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ (ku përfshihet dhe dokumentacioni i depozituar nga subjekti) dhe deklarimeve të subjektit, kreu analizën financiare<sup>5</sup>, për periudhën 1994 – 17.11.2011, për të ardhurat, shpenzimet, detyrimet dhe pasuritë e subjektit dhe personave të lidhur me të.

1.17 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit në datën 17.11.2011, blerjen dhe krijimin e pasurive të tjera, si dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara, për periudhën 1994 – 17.11.2011, duke rezultuar me një balancë negative në vlerë 46.763.434 lekë<sup>6</sup>.

Për këtë konstatim, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

1.18 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me konstatimin e Komisionit, në prapësimet e tij, ka shpjeguar se e gjithë pasuria e mësipërme është e prindërve të tij. Të ardhurat e tij nga puna si student në SHBA gjatë vitit 2009 dhe 2010 ishin tërësisht modeste dhe në total nuk kanë qenë më tepër se 15.000 USD, ndërsa të ardhurat nga puna si pedagog pranë Universitetit \*\*\* të Tiranës kanë qenë në vlerën 30.000 lekë/muaj (*bruto*). Madje, edhe të ardhurat nga rroga si pedagog nuk kanë qenë të plota, pasi punëdhënësi herë i paguante dhe herë jo. Në këto kushte, pasuria e mësipërme e formuar nga prindërit e tij, pavarësisht se ishte në një certifikatë familjare me ta, është tërësisht pronë e tyre dhe ai nuk ka ndikuar në asnjë lloj forme në krijimin e tyre. Nuk ka asnjë lidhje logjike dhe racionale midis subjektit dhe krijimit të këtyre pasurive, pasi nuk ka transaksione bankare apo edhe dyshime të vogla që ato janë krijuar prej tij, qoftë dhe pjesërisht. Për më tepër, këto pasuri, ose të paktën pjesa dërrmuese e tyre, janë krijuar përpara se subjekti, jo vetëm të emërohej si gjyqtar (shkurt 2017), por edhe të shpallej fitues si student magjistrat pranë Shkollës së Magjistraturës (shtator 2013).

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

1.19 Komisioni, pasi mori në konsideratë: (i) deklarin e subjektit të rivlerësimit se deri në vitin 2016 ka qenë në një certifikatë familjare me prindërit e tij, e provuar edhe nga certifikata e gjendjes civile<sup>7</sup>; (ii) deklarin e subjektit të rivlerësimit në pyetësin standard se ka bashkëjetuar me prindërit nga shkurti i vitit 2017; (iii) deklarin e subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore se arsyeja e shkëputjes nga trangu familjar më 23.9.2016 është bërë për shkak të procesit të rivlerësimit, me qëllim mospërfshirjen e prindërve në procesin e hetimit administrativ, i ka konsideruar prindërit e subjektit të rivlerësimit persona të lidhur në kuptim të pikës 13, të nenit 3, të ligjit 84/2016 dhe i ka përfshirë ata në analizën financiare, për verifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Komisioni vlerëson se në bazë të ligjit nr. 84/2016 subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin që për pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting* dhe duhet të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre.

---

<sup>5</sup>Shihni rezultatet e hetimit.

<sup>6</sup>Shihni rezultatet e hetimit dhe aneksin 1.

<sup>7</sup>Certifikatë familjare e gjendjes familjare, datë 23.9.2016, nr. \*\*\* dhe certifikatë e gjendjes familjare, datë 22.9.2016, lëshuar në datën 18.3.2022, me nr. \*\*\*.

Pas dërgimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në seancë dëgjimore se prindërit e tij kanë blerë në vitin 2003<sup>8</sup>, në të njëjtin vend me apartamentin ku jetojnë edhe një dyqan, me qëllim për t'ia vënë në dispozicion vajzës së tyre (motrës së subjektit), e cila, ndërkohë, studionte stomatologji në Poloni. Duke qenë se motra e subjektit të rivlerësimit nuk zgjodhi të jetojë në Shqipëri, ky dyqan është dhënë me qira në mënyrë të herëpashershme, por për të ardhurat nga qiraja nuk është paguar tatim në burim.

**Për pasurinë apartament dhe garazh, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e krijimit të këtyre pasurive me të ardhura të ligjshme (deklaruar si burim të ardhurat nga prindërit e tij), pasi nga analiza financiare e rishikuar (janë reduktuar shpenzimet e shkollimit për motrën e subjektit nga 3.845.700 lekë në 1.730.565 lekë<sup>9</sup> dhe është shtuar pasuria “dyqan” në vlerën 3.984.834 lekë), prindërit e tij kanë rezultuar me një balancë negative në shumën 48.633.133 lekë, për periudhën 1994 – 17.11.2011.**

Komisioni, në përputhje me detyrimin ligjor për verifikimin e pasurive *Vetting*, analizoi edhe mundësinë e krijimit vetëm të pasurisë apartament me sip. 62.94 m<sup>2</sup>, Komuna \*\*\*, në deklaratën *Vetting*, me burim të ardhurat e prindërve nën statusin si persona të tjerë të lidhur, nga ku rezultoi mungesë burimesh të ligjshme në shumën 6.905.990 lekë, për pagesën e shpenzimeve jetike në Shqipëri dhe Poloni dhe krijimin e pasurisë apartament për pagesën e këstit në vlerën 25.000 euro ose 3.518.000 lekë, në datën 17.11.2011.

<b>Përshkrimi</b>	<b>Periudha 1994 – 17.11.2011</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>6,628,749</b>
Të ardhura nga paga e babait 1994 – 17.11.2011	4,741,273
Të ardhura nga paga e nënës (asistenca) 16.7.1994 – 16.7.1995	24,655
Të ardhura nga interesat bankare	1,250,128
Të ardhura nga punësimi në SHBA, 2009-2010 (11.624 USD – 5.214 USD)	612,693
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>Shpenzime</b>	<b>10,016,739</b>
Shpenzime jetike 1994 – 17.11.2011	4,409,274
Shpenzime shkollimi Poloni motra e subjekti 2000 – 2006	1,730,565
Shpenzime shkollimi Poloni subjekti 2005 – korrik 2011	3,876,900
<b>Pasuri</b>	<b>3,518,000</b>
Apartament me sip. 62.94 m <sup>2</sup> , Komuna ***, “Tirana Bank”, më 17.11.2011 (k. k 140.72)	3,518,000
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>-6,905,990</b>

**Për sa më sipër, rezulton se subjekti, në kuptim të nenit 33/5 gjerat “a” dhe “b”, ka kryer deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe jo në përputhje me ligjin, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë në vlerën 3.518.000 lekë (pagesa e këstit të parë të apartamentit dhe garazhit), për arsye se rezulton me balancë financiare negative në shumën 6.905.990 lekë.**

<sup>8</sup>Kontratë prenotim shitje (dyqani) në datën 25.2.2003, në shumën 34.000 USD.

<sup>9</sup>Shpenzimet e shkollimit në Poloni, përfaqësojnë shpenzime për jetesë marrë në konsideratë faktin se si subjekti ashtu edhe motra kanë studiuar në Poloni dhe nuk kanë paguar tarifë shkollimi.

Komisioni vlerëson të ndalet në lidhje me faktin e krijimit të kësaj pasurie përpara fillimit të detyrës. Bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>10</sup>, rivlerësimi është analizë e së shkuarës së një funksionari publik, duke mbajtur në konsideratë që objekt kontrolli është pasuria dhe, për këtë shkak, institucionet e rivlerësimit kontrollojnë burimin në të shkuarën, për të cilin është krijuar kjo pasuri dhe rivlerësimi *Vetting*, mund të përkufizohet si vlerësim i integritetit për të përcaktuar përshtatshmërinë për funksione publike. Legjislacioni i posaçëm për rivlerësimin kalimtar nuk vendos kritere kohore lidhur me provueshmërinë e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive në pronësi apo përdorim, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Në një interpretim të dispozitave të zbatueshme lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurive, sipas qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, të përcaktuar në pikën 1, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka arritur në konkluzionin se, nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive, synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit, apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj. Në këtë proces, subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, i duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij dhe organet e rivlerësimit kanë si qëllim që të identifikojnë ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

**Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk plotëson kriteret e pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer si burim krijimi.**

### **Cenimi i besimit të publikut**

Komisioni vlerëson se shkëputja e subjektit të rivlerësimit nga trangu familjar në shtator të vitit 2016, pas miratimit të ligjit nr. 84/2016, është kryer me qëllim mospërfshirjen e prindërve të tij në kategorinë e personave të lidhur dhe, për rrjedhojë, shmangien e tyre nga përgjegjësia ligjore për deklarimin e pasurive në deklaratën *Vetting* me qëllim shmangien e çdo pasoje që do të mund t'i vinte subjektit të rivlerësimit në varësi të rezultatit të analizës financiare që do të kryhej për prindërit.

Komisioni e konsideron këtë sjellje të subjektit të rivlerësimit si shmangie e qëllim të në përmbushjen e detyrimeve ligjore, duke sjellë si pasoje cenimin e besimit të publikut të drejtësia.

**2. Automjet<sup>11</sup>, tip “Ford Focus \*\*\*”. Shitja ka ndodhur sipas kontratës së shitjes nr. “\*\*\*\*”, datë 27.10.2014, lidhur midis subjektit dhe shoqërisë “\*\*\*\*”. Vlera: 13.150 euro. Vlera është paguar në të njëjtën ditë kur është lidhur kontrata në “Credins Bank”.**

**2.1 Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*:** ky automjet është paguar nga ekonomia familjare, pasi subjekti deri në shtator të vitit 2016 ka qenë së bashku në ekonomi familjare me prindërit. Paga është bërë si pasoje e shitjes së automjetit që ka pasur në përdorim më parë

<sup>10</sup>Vendimet: nr. 15/2019, nr. 8/2019, nr. 19/2019 dhe nr. 13/2020.

<sup>11</sup> Subjekti ka depozituar: kontratë shitje nr. “\*\*\*\*”, datë 27.10.2014; mandatpagesë nga “Credins Bank”, datë 27.10.2014; faturë tatimore nr. \*\*\*, datë 27.10.2014, për automjetin tip “Ford Focus”; certifikatë pronësie e mjetit, me targa \*\*\*; kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 30.9.2014.

(në pronësi të babait të tij) tip “Mercedes-Benz \*\*\*”, me kontratë e shitje nr. \*\*\*, datë 30.9.2014. Vlera: 4.800 euro. Kjo kontratë është lidhur një muaj përpara se të lidhej kontrata për blerjen e automjetit ekzistues.

Pjesa e mbetur është paguar nga ekonomia familjare ku ka qëndruar së bashku me prindërit e tij. Babai është financuesi kryesor i kësaj familjeje, pasi ushtron profesionin e mjekut gjinekolog pranë Spitalit Rajonal V. dhe është pronar i një klinike private.

Subjekti ka qenë kontribuues i kësaj ekonomie me punët e kryera: (i) në SHBA gjatë kohës kur ka qenë student (vitet 2009 - 2010); (ii) si pedagog i brendshëm pranë Universitetit \*\*\* të Tiranës; apo (iii) bursën e marrë gjatë studimeve pranë Shkollës së Magjistraturës. Zotërimi: 100% në pronësi të subjektit.

## **Rezultati i hetimit<sup>12</sup>**

2.2 Subjekti, me kontratën e shitje nr. “\*\*\*”, datë 27.10.2014, ka blerë nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., automjetin tip “Ford Focus”, në vlerën 13.150 euro. Për këtë kontratë është lëshuar faturë tatimore nr. \*\*\*, datë 27.10.2014. PAGESA është kryer me mandatpagesë nga “Credins Bank” datë 27.10.2014, ku subjekti i ka kaluar shoqërisë “\*\*\*” shumën 13.150 euro.

2.3 Si burim për këtë automjet subjekti ka deklaruar:

i) Shumën 4.800 euro, përfituar nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz \*\*\*”. Në datën 30.9.2014 babai i subjektit, me kontratën e shitblerjes (kontrata është firmosur nga subjekti në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë) nr. \*\*\*, ka shitur automjetin tip “Daimler Chrysler” në shumën 4.800 euro. Ky automjet rezulton të jetë blerë nga babai i subjektit me faturë tatimore nr. \*\*\*, datë 12.2.2007, për shumën 12.600 euro.

ii) Të ardhurat familjare

2.4 Komisioni kreu analizën financiare<sup>13</sup> për periudhën 1994 – 27.10.2014 për të ardhurat, shpenzimet, detyrimet dhe pasuritë e subjektit, personave të lidhur, deri më 27.10.2014, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 54.172.300 lekë, në datën 27.10.2014, për blerjen e automjetit dhe kryerjen e shpenzimeve.

Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me konstatimin se prindërit e subjektit nuk kanë patur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me konstatimin e Komisionit, ka dhënë të njëjtat shpjegime si për apartamentin me sip. 62.94 m<sup>2</sup> të ndodhur në Komunën \*\*\*, se e gjithë pasuria e tij është krijuar nga prindërit para se të ishte magjistrat.

## **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

Komisioni vlerëson se në bazë të ligjit nr. 84/2016 subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin që për pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting* duhet të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre.

<sup>12</sup>Kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2020,e DPSHTRR-së.

<sup>13</sup>Shihni rezultatet e hetimit.

Për pasurinë konkrete, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e krijimit të kësaj pasurie me të ardhura të ligjshme (deklaruar si burim të ardhurat nga prindërit), duke rezultuar me një balancë negative në shumën 54.172.300 lekë për periudhën 1994 – 27.10.2014.

**Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk plotëson kriteret e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer si burim krijimi.**

Për pasurinë automjet, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e krijimit të saj me të ardhura të ligjshme (deklaruar si burim të ardhurat nga prindërit), pasi nga analiza financiare e rishikuar, pas prapësimeve dhe seancës dëgjimore, prindërit e tij kanë rezultuar me një balancë negative në shumën 56.041.999 lekë për periudhën 1994 – 27.10.2014.

Komisioni, duke qenë se kreu një analizë të mirëfilltë financiare për të parë mundësitë financiare për pagesën e këstit të parë për blerjen e pasurive apartament dhe garazh deri në datën 17.11.2011, analizë nga e cila subjekti dhe personat e lidhur/tjerë të lidhur dolën me balancë negative, me qëllim mos ngarkimin dy herë të subjektit me një rezultat negativ për të njëjtat pasuri, e pa të arsyeshme të analizonte edhe mundësinë financiare për periudhën nga 17.11.2011 (data e pagesës së këstit 25.000 euro) deri më 27.10.2014 (data e blerjes së automjetit tip “Ford Focus \*\*\*\*”), nga ku sipas rezultatit të treguesve financiarë për këtë periudhë (të ardhura, shpenzime dhe pasuri) rezultoi mungesë burimesh të ligjshme në shumën 7.087.204 lekë për pagesën e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive, ndër të cilat edhe blerjen e automjetit tip “Ford Focus \*\*\*\*” me çmimin 13.150 euro.

<b>Përshkrimi</b>	<b>17.11.2011 – 27.10.2014</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>4,685,573</b>
Të ardhura nga paga e babait 17.11.2011 – 27.10.2014	2,056,243
Të ardhura nga aktiviteti privat i babait	0
Të ardhura nga interesat bankare	1,011,045
Të ardhura nga punësimi i subjektit si pedagog/bursa (sipas bankave)	946,813
Të ardhura nga shitja e automjetit “Mercedes-Benz” me targa *** datë 30.9.2014 (4,800 x 139,89)	671,472
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>Shpenzime</b>	<b>1,643,294</b>
Shpenzime jetike 17.11.2011 – 27.10.2014	1,428,083
Shpenzime mobilimi	500,000
Shpenzime udhëtimi	0
Humbje nga aktiviteti privat i babait	-284,788
<b>Pasuri</b>	<b>10,129,484</b>
Kursime (shtesa/pakësime likuiditeti)	2,696,429
Apartament 62.94 m <sup>2</sup> , Komuna ***, datë 26.6.2013 (k.k. 140,69)	281,380
Automjet *** ft. ***, datë 30.8.2013, me çmim 32,500 euro	4,549,350
Automjet “Ford Focus ****” ****, datë 27.10.2014, derdhur cash në “Credins Bank” 13,150 euro	1,830,743
<i>Dozja e legalizimit 2016, viti 2014, shtëpi në ***, sip. ndërtimi 286 m<sup>2</sup></i>	
*Tokë 392 m <sup>2</sup> pagesë e këstit të fundit datë 25.9.2014	210,075
<i>Dozja e legalizimit *** datë 21.3.2005 për klinikën, sip. ndërtimi 76 m<sup>2</sup></i>	
*Parcelë ndërtimore (klinika private) datë 26.10.2012	550,000

*Vlera e tarifës së shërbimit K II, pagesë 5.4.2013/ALUIZNI V.	4,000
*Vlera e tarifës së shërbimit për dokumentacion, pagesë 5.4.2013/ALUIZNI V.	6,000
*Taksa e ndikimit në infrastrukturë 5.4.2013/ALUIZNI V.	1,507
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>-7,087,204</b>

Komisioni, në përputhje me detyrimin ligjor për verifikimin e pasurive *Vetting*, analizoi edhe mundësinë e krijimit vetëm të pasurisë automjet tip “Ford Focus \*\*\*”, në deklaratën *Vetting* me burim të ardhurat e prindërve të subjektit nën statusin e personave të tjerë të lidhur, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime të mjaftueshme financiare për periudhën 17.11.2011 – 27.10.2014 për pagesën e shpenzimeve, pagesën e kështit 2,000 në datën 26.6.2013 për apartamentin dhe blerjen e automjetit tip “Ford Focus \*\*\*” në datën 27.10.2014 në shumën 13.150 euro.

Përshkrimi	17.11.2011-27.10.2014
<b>Të ardhurat</b>	<b>3,738,760</b>
Të ardhura nga paga e babait	2,056,243
Të ardhura nga interesat bankare	1,011,045
Të ardhura nga shitja e mjetit “Mercedes-Benz”, datë 30.9.2014, me targa *** (4,800 x 139,89)	671,472
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>Shpenzime</b>	<b>1,143,294</b>
Shpenzime jetike 17.11.2011 – 27.10.2014	1,428,083
Humbje nga aktiviteti privat i babait	-284,788
<b>Pasuri</b>	<b>2,112,123</b>
Apartament 62.94 m <sup>2</sup> , Komuna ***, datë 26.6.2013 (k.k 140,69)	281,380
Automjet “Ford Focus ***” ***, datë 27.10.2014, derdhur <i>cash</i> në “Credins Bank” 13,150 euro	1,830,743
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>483,343</b>

### Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

**3. Llogari<sup>14</sup> rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” (monedha lekë), me gjendje në datën 23.1.2017, në vlerën 121.56 lekë.**

**Llogari rrjedhëse dhe kartë krediti në “Raiffeisen Bank” (monedha euro).** Karta e kreditit nuk është përdorur asnjëherë, me gjendja aktuale në datën 23.1.2017 është 0 (zero) euro.

**Kartë krediti në “Raiffeisen Bank” (monedha lekë), me gjendje në datën 11.1.2017, -18.000 (minus tetëmbëdhjetë mijë) lekë.**

**Të drejtë tërheqjeje nga kontoja e nënës V. Sh..** Subjekti ka kërkuar nga “Raiffeisen Bank” që në datën 7 të çdo muaji kjo bankë të transferojë nga kontoja e tij rrjedhëse, ku merr pagën, drejt kontos së nënës së tij shumën prej 20.000 lekësh. Nga kjo depozitë, subjekti ka të drejtën e tërheqjes. Kjo vjen si ndihmë ndaj nënës së tij, pasi është pensioniste.

**3.1 Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** nuk deklarohet burim.

<sup>14</sup>Subjekti ka depozituar: nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank” në emër të z. Bevis Shehaj në lekë; faturë kartë krediti për periudhën 24.6.2016 – 30.10.2016; nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, në emër të z. Bevis Shehaj, në euro.



## Rezultatet e hetimit<sup>15</sup>

3.2 Nga nxjerrja e llogarisë në “Raiffeisen Bank” në lekë të subjektit rezulton se:

- i) gjendja në datën 23.1.2017 është në vlerën 121.56 lekë;
- ii) ka kalime mujore në shumën 20.000 lekë në llogarinë e nënës së subjektit V. Sh.;
- iii) ka depozitime (transferime) periodike në shumën 15.000 lekë/muaj nga z. A. H. H.

Subjekti, në lidhje me këto transferime, ka sqaruar se me shtetasin A. H. qëndrojnë në një marrëdhënie gjaku në shkallën e pestë (djali i dajës), e vërtetuar kjo lidhje me certifikata të gjendjes civile<sup>16</sup>. Arsyeja e derdhjes së pagesave periodike ka qenë ndihma e të afërmit të tij, pasi ishte kthyer nga studimet e tij në Poloni dhe vështirësitë në tregun e punës në vitin 2011 - 2012. Z. A. H. është me profesion mjek urolog, mbaruar studimet jashtë Shqipërisë dhe prej kthimit të tij ka qenë mjek pranë Spitalit \*\*\* në Shqipëri.

3.3 “Raiffeisen Bank”<sup>17</sup> konfirmon llogari rrjedhëse në valutë në emër të z. Bevis Shehaj me gjendje 0 (zero) euro. Në këtë llogari nuk janë kryer veprime. Gjithashtu, banka konfirmon edhe llogari në valutë për tërheqje me *Master Card* në monedhën euro me gjendje 0 (zero) euro.

3.4 Nga nxjerrja e llogarisë së *Master Card*, subjektit rezulton se gjendja në datën 11.0=1.2017 është në vlerën 24.732.84 lekë.

**4. Llogari<sup>18</sup> rrjedhëse në “Credins Bank”.** Kontoja është hapur nga ish-punëdhënësi Universiteti \*\*\* i Tiranës (njohur ndryshe si “\*\*\*\*” sh.p.k.), në vitin 2011. Gjendja aktuale e datës 7.11.2016 është 0 (zero) lekë. Kontoja është mbyllur në datën 7.11.2016.

**4.1 Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** nuk deklarohet burim.

## Rezultatet e hetimit<sup>19</sup>

4.2 Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Credins Bank” evidentohen kalime periodike të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën 16.12.2011 – 5.2.2014, në vlerën 337.395 lekë.

**Kjo llogari është mbyllur nga subjekti në datën 7.11.2016.**

## 5. Në lidhje me të ardhurat e subjektit dhe babait të subjektit

### Rezultatet e hetimit

5.1 Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhurat si vijon:

a) Gjatë vitit akademik 2008 - 2009, kohë kur ka qenë student pranë Universitetit të \*\*\*, ka aplikuar për programin studentor \*\*\*. Ky program i mundësoi të udhëtonte në SHBA, ku mund të punonte për kompaninë amerikane “\*\*\*\*”, New York. Në këtë kompani (shërbim transport udhëtarësh) ka punuar në intervalin kohor 21.6.2009 – 30.9.2009. Numri social i domosdoshëm për të punuar legalisht në SHBA është 105 98 1079. Shuma e paguar në vlerën *neto* janë 9.811 USD. Taksat federale dhe ato të shtetit, të cilat i janë kthyer më vonë janë 1.139 USD dhe 414 USD.

Për të provuar këto të ardhura, subjekti ka depozituar: (i) vërtetim lëshuar nga punëdhënësi “\*\*\*\*”, sipas së cilit subjekti ka punuar 910 orë për periudhën qershor-shtator 2009; (ii) letër

<sup>15</sup>Kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2020, e “Raiffeisen Bank”.

<sup>16</sup>Certifikatë martesë (nga akti) me nr. \*\*\*, datë 30.9.1980, të prindërve B. dhe V. Sh., sipas të cilit vërtetohet mbiemri paramartesor i nënës (H.), si dhe certifikatën personale dhe familjare të shtetasit A. H. të nxjerrja nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile 2010, sipas të cilave ndër të tjera, vërtetohet se është i biri i H., vëlla i nënës së tij V. Sh.

<sup>17</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2020.

<sup>18</sup>Subjekti ka depozituar: veprim në llogarinë pranë “Credins Bank” datë 7.11.2016; nxjerrje llogarie në “Credins Bank”.

<sup>19</sup>Kthim përgjigjeje nr. \*\*\*, datë 14.5.2020, e “Credins Bank”.

rekomandimi nga punëdhënësi “\*\*\*\*”; (iii) manualin e personelit të punëdhënësi “\*\*\*\*”; (iv) formularin W-2 “Wage and Tax Stament”, sipas së cilit subjektit ka pasur të ardhura në total për vitin 2009, në shumën 9.811.06 USD, taksa federale mbi të ardhurat e mbajtur 1.139,54 USD, si dhe taksa shtetërore mbi të ardhurat 414.12 USD.

b) Gjatë vitit akademik 2009 - 2010, kohë kur ka qenë student në Universitetin e \*\*\*, në Poloni, ka aplikuar përsëri në programin \*\*\*, për të shkuar e punuar përsëri në SHBA. Gjatë intervalit kohor 19.6.2010 – 5.9.2010, ka punuar pranë kompanisë amerikane \*\*\* (shërbime argëtim). Shuma totale e paguar personit *neto* është 3.546 USD. Taksat paguar shtetit amerikan, por të cilat nuk i janë kthyer, pasi nuk aplikoi, janë në vlerën e 154 dhe rreth 25 USD.

Për të provuar këto të ardhura, subjekti ka depozituar: (i) letër verifikimi lëshuar nga punëdhënësi “\*\*\*\*”, për punën e ushtruar nga subjekti për intervalin kohor 19.6.2010 - 5.9.2010; (ii) formularin W-2 “Wage and Tax Stament”, sipas së cilit subjektit ka pasur të ardhura në total për vitin 2010, në shumën 3546.11 USD, taksa federale mbi të ardhurat e mbajtur 154.41 USD, taksa shtetërore mbi të ardhurat 25.24 USD, qiraja e punëmarrësit 761.8 USD; (ii) kopje e kartës së numrit social të subjektit; (iii) certifikata e vizës e tipit J-1, e cila është dhënë për programin studentor; (iv) çeqe të përfituar nga punësimi i subjektit për vitin 2009; (v) çek i përfituar nga subjekti në datën 1.7.2010, për periudhën e punësimit 28.6.2010-11.7.2010, shuma 190 USD.

c) Në datën 10.10.2011, midis tij dhe Universitetit \*\*\* të Tiranës është lidhur kontrata e punës me afat të pacaktuar me nr. \*\*\* prot. Sipas kësaj kontrate, subjekti do të ofronte punën e pedagogut të brendshëm pranë këtij Universiteti. Paga do të ishte 30.000 lekë/muaj. Kontrata ka qenë në fuqi deri në korrik të vitit 2014, ku këtij Universiteti iu hoq licenca. Paga *neto* shkonte rreth 24.500 lekë.

5.2 Subjekti ka paraqitur së bashku me deklaratën *Vetting*, kontratë individuale pune nr. \*\*\*, datë 10.10.2011, lidhur me Universitetin \*\*\* të Tiranës, ku subjekti është punësuar si pedagog, me kohë të plotë nga data 10.10.2011 me afat të pacaktuar me shpërblim në shumën 30.000 lekë/muaj, mbi të cilën do të mbahet tatimi personal mbi të ardhurat.

5.3 Nga hetimi, në lidhje me të ardhurat e subjektit, ka rezultuar se:

- DRSSH-ja Tiranë<sup>20</sup> konfirmon pagimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për subjektin në periudhën nëntor 2012 – dhjetor 2013, për totalin e pagave *bruto* në shumën 387.000 lekë.
- Drejtoria e Arkivit Qendror Lundër<sup>21</sup> konfirmon pagimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për subjektin për muajin janar 2012, për pagën *bruto* në shumën 29.600 lekë.
- Në llogarinë bankare në “Credins Bank” janë kredituar në mënyrë periodike (jo të përmuajshme) për periudhën 16.12.2011 – 5.2.2014, paga *neto* në shumën 24.640 lekë/muaj, në shumën 337.395 lekë.

5.4 Subjekti, për të provuar të ardhurat e babait të tij, ka depozituar dokumentacionin, si vijon:

i) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2016, nga Spitali Rajonal V., ku vërtetohet se B. Sh. ka qenë punonjës pranë: Këshillit Popullor të Bashkuar \*\*\* për periudhën 16.8.1978 – 16.10.1990; shkollës së mesme mjekësore “\*\*\*\*” për periudhën 16.10.1990 – 20.10.1991, spitalit Rajonal V. për periudhën 1.11.1991 – e në vijim.

<sup>20</sup>DRSSH-ja Tiranë me nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2021.

<sup>21</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2021, nga Drejtoria e Arkivit Qendror Lundër.

ii) Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë<sup>22</sup> vërteton se subjekti B. Sh., me NIPT \*\*\*, ka deklaruar: në vitin 2011 – të ardhura 32.619 lekë – shpenzime 223.510 lekë; në vitin 2012 – të ardhura 204.886 lekë – shpenzime 318.680 lekë; në vitin 2013 – të ardhura 236.410 lekë – shpenzime 284.756 lekë; në vitin 2014 – të ardhura 149.000 lekë – shpenzime 272.102 lekë; si dhe në vitin 2015 – të ardhura 416.372 lekë – shpenzime 1.614.625 lekë.

iii) Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë<sup>23</sup>, vërteton se subjekti B. Sh. është regjistruar në datën 1.7.2010 dhe aktualisht është me status aktiv. Ky subjekt ka paguar tatim fitim të thjeshtuar në vlerën 25.000 lekë për vitin 2014-2015.

iv) ISSH-ja Vlorë<sup>24</sup> vërteton se shtetasja V. Sh. përfiton pension pleqërie për periudhën 2.5.2016-dhjetor 2016.

5.5 Nga hetimi, në lidhje me të ardhurat e babait, ka rezultuar se:

i) QKB-ja<sup>25</sup> konfirmon se shtetasi B. T. Sh.: (i) është i regjistruar si person fizik me NIPT \*\*\*, me fushë veprimtarie “\*\*\*”, regjistruar në datën 1.7.2010, me status aktiv; (ii) figuron i regjistruar si person fizik me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.4.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për të cilin nuk gjendet NIPT-i. Nga verifikimi i vendimit të gjykatës rezulton se kërkesa për regjistrim si person fizik është bërë për ushtrimin e profesionit të obsteter-gjinekolog.

ii) DRT-ja Vlorë<sup>26</sup> konfirmon se shtetasi B. Sh. është person fizik me NIPT \*\*\*, i regjistruar në datën 1.7.2010, me status aktiv. Deklarimet për vitet 2011 – 2016, si vijon: në vitin 2011 – qarkullim 32.619 lekë – fitim -180.891 lekë; në vitin 2012 – qarkullim 204.886 lekë – fitim -113.794 lekë; në vitin 2013 – qarkullim 236.410 lekë – fitim -48.346 lekë; në vitin 2014 – qarkullim 149.000 lekë – fitim -123.102 lekë; në vitin 2015 – qarkullim 416.372 lekë – fitim -1.198.253 lekë; si dhe në vitin 2016 – qarkullim 993.210 lekë – fitim 859.434 lekë.

iii) ISSH-ja<sup>27</sup> konfirmon të dhëna për kontributet për shtetasit: B. Sh., ka të dhëna për kontributet për periudhën janar 2012 – prill 2017 nga subjektet: “Spitali i rrethit” dhe subjekti “B. Sh.”; V. Sh. përfiton pension pleqërie që nga maji i vitit 2016, me masë aktuale 11.124 lekë.

iv) Spitali Rajonal V. <sup>28</sup> konfirmon punësimin e z. B. Sh., për periudhën 1.1.1994 – 31.10.2021, nga ku ka përfituar të ardhura *bruto* në shumën 16.580.484 lekë dhe të ardhura neto në shumën 13.231.551 lekë. Për vitin 1991-1993 nuk disponohet dokumentacion.

v) Bankat e nivelit të dytë konfirmojnë si vijon:

“**Credins Bank**”<sup>29</sup> konfirmon llogari depozite me nr. \*\*\* në monedhën dollarë, në emër të shtetasit B. Sh. Gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 është në shumën 25.000 USD.

Llogari page me nr. \*\*\*, në emër të B. Sh. Në këtë llogari kanë kaluar pagat nga Spitali Rajonal V., për vitet 2005-2006 dhe 2009-2016 dhe gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 është në shumën 83.020 lekë.

Llogari rrjedhëse në emër të nënës së subjektit V. Sh., e hapur në vitin 2016, në të cilën kreditohen pensionet. Gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 në shumën 60.000 lekë.

<sup>22</sup>Vërtetim nr. \*\*\*, datë 25.10.2016, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë

<sup>23</sup>Vërtetim nr. \*\*\*, datë 25.10.2016, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë

<sup>24</sup>Vërtetim nr. \*\*\*, datë 10.1.2017, nga ISSH-ja Vlorë

<sup>25</sup>QKB-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2020.

<sup>26</sup>DRT-ja Vlorë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.8.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 1.12.2021.

<sup>27</sup>ISSH-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2017.

<sup>28</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2021 nga Spitali Rajonal V.

<sup>29</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.5.2020, “Credins Bank”.

“**OTP Bank**”<sup>30</sup> konfirmon depozitë me afat në monedhën lekë me nr. \*\*\*, hapur në datën 21.11.2008 dhe datë maturimi 21.5.2020, në emër të B. Sh., në vlerën 2.500.000 lekë dhe depozitë me afat në monedhën lekë me nr. \*\*\*, hapur në datën 29.4.2014 dhe datë maturimi 2.5.2017, në emër të B. Sh. në vlerën 2.200.000 lekë.

**BKT-ja**<sup>31</sup> konfirmon depozitë në monedhën dollarë në emër të B. Sh., hapur në datën 12.7.2016 në shumën 25.000 USD, me burim tërheqjen e datës 12.7.2016 në “Credins Bank”.

“**Raiffeisen Invest**”<sup>32</sup> konfirmon investimin në Fondin \*\*\* në datën 7.3.2017, në shumën 2.954.000 lekë dhe tërhequr në datën 9.10.2017, nga z. B. Sh. dhe investimin në datën 7.2.2017, në shumën 1.200.000 lekë. Gjendja e llogarisë është në shumën 472.337,82 lekë, në datën 31.1.2020.

“**Tirana Bank**”<sup>33</sup> konfirmon investimin në obligacione 3-vjeçare nga B. Sh., për periudhën 7.4.2014 – 7.4.2017, në vlerën 4.000.000 lekë.

“**Raiffeisen Bank**”<sup>34</sup> konfirmon depozitë me afat në monedhën lekë, në emër të B. Sh., hapur në datën 30.7.2007, në shumën fillestare prej 2.021.000 lekësh dhe aktive deri në datën 7.3.2017, ku shuma prej 2.954.000 lekësh është kaluar në fondin e investimit ‘Raiffeisen Prestigj’<sup>35</sup> deri më 9.10.2017

Depozitë me afat në monedhën dollarë në emër të B. Sh., hapur në datën 30.7.2007 në shumën fillestare prej 27.472 USD dhe aktive deri në datën 3.2.2020, në vlerë 37.922 USD.

Pagesë<sup>36</sup> 1.500 euro e datës 25.9.2014 kryer për llogari të H. K. Gj. nga B. Sh. me përshkrimin ‘likuidim këst i fundit i blerjes së tokës në lagjen \*\*\*, \*\*\*, në shumën 23.500 euro’. Në të njëjtën llogari në datën 13.3.2015, B. Sh. transferon si dhurim për llogari të I. M.C. shumën 30.071 euro.

Në lidhje me nënën e subjektit V. Sh., nga “Raiffeisen Bank” konfirmohet depozitë me afat në monedhën lekë hapur në datën 14.10.2014, në shumën fillestare prej 573.200 lekësh dhe aktive deri në datën 7.2.2017, në vlerën 950.200 lekë, kur kjo shumë është kaluar në fondin e investimit ‘Raiffeisen Prestigj’.

## **6. Pasuri të paluajtshme në emër të babait të subjektit të rivlerësimit B. Sh.**<sup>37</sup>

**i. Subjekti, në pyetësin standard, ka deklaruar se prej muajit shkurt të vitit 2017 banon në qytetin e Vlorës, bulevardi “\*\*\*”, pranë stadiumit “\*\*\*”, pallati “\*\*\*”, kati i \*\*\*, apartamenti nr.\*\*\*. Apartamenti është nën pronësinë e prindërve të tij, prej datës së emërimit banojnë të tre në këtë apartament, nuk ka paguar qira për këtë apartament për shkak të lidhjeve të ngushta të gjakut dhe kjo banesë nuk është regjistruar në regjistrat publikë të pronave të paluajtshme të hartuara e të administruara nga ASHK-ja Vlorë.**

Në përgjigje të pyetësit të datës 22.11.2021, subjekti në lidhje me këtë apartament ka sqaruar se sipas deklarimeve të prindërve ky apartament është marrë në dorëzim faktik nga familja në qershor-korrik të vitit 2006. Paga e blerjes së këtij apartamenti ka përfunduar dhe është kryer

<sup>30</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2020, “OTP Bank”.

<sup>31</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2020, BKT-ja.

<sup>32</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2020, “Raiffeisen Invest”.

<sup>33</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2020, “Tirana Bank”

<sup>34</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2020, “Tirana Bank”

<sup>35</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2020, “Raiffeisen Invest”

<sup>36</sup>Veprim në llogarinë me nr. \*\*\*.

<sup>37</sup>Shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 10.04.2020, nga ASHK Vlorë.

në *cash*. Në lidhje me burimin e të ardhurave, subjekti deklaron të njëjtin deklaram si më sipër për apartamentit e tij.

Subjekti ka vënë në dispozicion kontratë prenotim shitje nr. \*\*\* rep., datë 30.9.2002, sipas së cilës babai i subjektit ka prenotuar apartament në shumën 40.590 USD. Nga kontrata rezulton se pagesat janë kryer deri në vitin 2005.

Komisioni e ka përfshirë këtë pasuri në analizën financiare<sup>38</sup>, për periudhën 1994 – 31.1.2005, mbi të ardhurat, shpenzimet, detyrimet dhe pasuritë e subjektit, personave të lidhur, deri më 31.1.2005, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 14.634.325 lekë, në datën 31.1.2005 (ka përfunduar pagesa), për blerjen e apartamentit dhe kryerjen e shpenzimeve. Veç kësaj, Komisioni e ka përfshirë këtë pasuri edhe në analizën financiare të subjektit dhe personave të lidhur me të, për periudhën 1994 – 17.11.2011<sup>39</sup> (data e pagesës së këstit të parë prej 25.000 euro për blerjen e apartamentit dhe garazhit në Tiranë), nga ku ka rezultuar një balancë financiare negative paraprake prej 46.763.434 lekë .

**ii. Në datën 21.3.2005, babai i subjektit ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit për legalizim për objektin studio mjekësore, me sipërfaqe ndërtimi 40 m<sup>2</sup>, numri i kateve mbi tokë 2. Viti i ndërtimit daton më 31.10.1996.**

Në datën 18.4.2013 është lidhur kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore nr. \*\*\*, nëpërmjet së cilës babai i subjektit ka blerë nga ALUIZNI Vlorë parcelën ndërtimore me sipërfaqe 55 m<sup>2</sup>, me nr. Pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*. Në datën 26.4.2013 është lëshuar leja e legalizimit nr. \*\*\*, për objektin godinë shërbimi 2 kate me sipërfaqe ndërtimi 33 m<sup>2</sup>, sipërfaqja totale e ndërtimit 76 m<sup>2</sup>. Sipas kartelës së pasurisë objekti ka nr. Pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sipërfaqe 55 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtesë 33 m<sup>2</sup>, në seksionin përshkrimi i veçantë ka shënim “godinë shërbimi 2 kate”, sipërfaqja e katit përdhe 33 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqja kati të parë 43 m<sup>2</sup>.

Në lidhje me këtë objekt, subjekti në përgjigje të pyetësorit të datës 22.11.2021, ka sqaruar se sipas deklarimeve të prindërve ndërtimi i tij ka nisur në vitin 1996. Fillimisht ka filluar me ndërtimin e një garazhi dhe, më pas, me zgjerimin e hapësirës së ndërtimit dhe shtimit të një kati. Kati shtesë është kryer vetëm me qëllim ngritjen e një studio mjekësore, pasi deri atëherë babai i subjektit e kishte kthyer pronën e vetme të familjes, shtëpinë e banimit, pjesërisht në një studio. Mbarimi i katit të dytë ka ndodhur në vitin 1998-1999. Nga deklarimet e prindërve të tij, vlera e ndërtimit të këtij objekti, duke marrë parasysh kohën kur është ndërtuar, por edhe punimet e ndjekur dhe kryera nga vetë babai (ndërtimi/formimi i blloqeve, instalimet elektrike, ndërtimi i çatisë etj.), kanë vlerën prej 500.000 lekësh. Është pothuajse pamundësi e plotë për të provuar me dokumente zërat e këtyre punimeve, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar (më shumë se 20 vjet).

**iii. Në datën 4.12.2014, me vetëdeklarim nr. \*\*\*, babai i subjektit ka kërkuar legalizimin e një objekti informal, me sip. 286 m<sup>2</sup>, dy kate+kat nëntokë, ndodhur në \*\*\*, \*\*\*. Viti i ndërtimit është deklaruar 2007.**

Në datën 24.7.2017 është lëshuar leja e legalizimit nr. \*\*\*. Bazuar në përshkrimin e pronës në regjistrin e ASHK-së rezulton se objekti ka sipërfaqe baze 81 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimit/banimit kati nëntokë 72 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimit/banimit kati përdhe 107 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimit/banimit kati i parë 107 m<sup>2</sup>.

Në lidhje me këtë objekt, subjekti në përgjigje të pyetësorit të datës 22.11.2021, ka sqaruar se ndërtimi i tij, sipas deklarimeve të prindërve, ka nisur në vitin 2007- 2008. Ndërtimi ka filluar,

<sup>38</sup>Shihni rezultatet e hetimit, tabela financiare në faqen nr. 8.

<sup>39</sup>Shihni tabelën e analizës financiare në faqen 7 të rezultateve të hetimit.

pasi më parë është lidhur kontrata e parablerjes apo kaparit e lidhur midis babait B. Sh. dhe shitësit H. Gj. (për më shumë në lidhje në këtë kontratë do të shprehem më poshtë). Nga deklaratimet, të cilat ia ka marrë babait për ndërtimin e objektit me qëllim banimi, ai i ka deklaruar se banesa ka kushtuar rreth 5.000.000 lekë. Te kjo vlerë, që tanimë duket si e ulët, merret parasysh fakti koha kur është ndërtuar (viti 2007-2008), si dhe se ndjekësi i punimeve ka qenë ungji N. Sh., me profesion teknik ndërtimi, i cili përveç projektit të godinës ka ndjekur edhe punimet në terren. Nga pyetja që i ka bërë babait nuk i garantoi se, mund të më gjente fatura apo dokumente për të provuar zëra punimesh për ndërtimin e këtij objekti për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar. Gjatë kohës të blerjes së truallit dhe ndërtimit të objektit subjekti ka qenë me studime në \*\*\*, Poloni, duke kryer vitin e parë dhe të dytë të studimeve

Nga hetimi ka rezultuar se ky objekt është ndërtuar në një tokë ullishte me sipërfaqe 392 m<sup>2</sup>, me nr. Pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, ndodhur në \*\*\*, me vendndodhje \*\*\*, në pronësi të babait të subjektit. Në lidhje me këtë tokë, subjekti në përgjigje të pyetësorit të datës 22.11.2021, ndër të tjera, ka sqaruar se me z. Ll. /H. Gj. kanë lidhur kontratën e parablerjes, të titulluar “kontratë kapari”, me nr. \*\*\* Kol., datë 13.12.2008, pranë noteres publik Xh. L.. Sipas kësaj kontrate, babai i subjektit do të blinte sip. 500 m<sup>2</sup> pronë të llojit “ullishte”, nën pronësinë e z. Ll./H. Gj., kundrejt vlerës 60 euro/m<sup>2</sup>. Sipas kontratës, babai ka derdhur menjëherë në favor të z. Ll./H. Gj., shumën prej 3.000 eurosh. Pronën e ka marrë menjëherë në dorëzim dhe i ka paguar me këste mujore palën shitëse (2-3 mijë euro në çdo 2-3 muaj), deri në arritjen e shumës prej 23.000 euro. Kontrata e shitblerjes ka ndodhur në mars të vitit 2017<sup>40</sup>, pasi më parë babai kishte iniciuar një procedurë administrative për regjistrimin e veçantë të pasurisë së paluajtshme në regjistrat e ASHK-së Vlorë (për pasurinë e llojit “ullishte” të kthyer, tanimë, në truall të objektit). Sipas kësaj kontrate nuk është blerë sip. 500 m<sup>2</sup>, por vetëm sip. 392 m<sup>2</sup>.

Subjekti ka vënë në dispozicion dokumentacionit në vijim: (i) kontratë kapari nr. \*\*\*, datë 13.12.2008, nëpërmjet së cilës babai i subjektit ka blerë një truall me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup> për 60 euro/m<sup>2</sup>. Në kontratë përcaktohet se është dhënë një kapar në shumën 3.000 euro; (ii) kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 23.3.2017, nëpërmjet së cilës babai ka blerë pasurinë e mësipërme për shumën 80.000 lekë dhe me sipërfaqe 392 m<sup>2</sup>.

Ndërsa, në datën 30.12.2021, ka vënë në dispozicion: (i) kontratë premtim shitje nr. \*\*\*, datë 18.7.2009, sipas së cilës babai do të blinte një sipërfaqe toke ullishte 500 m<sup>2</sup>, për shumën 30.000 euro. Në kontratë përcaktohet dhe modalitetet e pagesës, sipas së cilës shuma 15.000 euro ishte paguar para nënshkrimit të kontratës, shuma 10.000 do të paguhej me përfundimin e ndërtimit të objektit dhe shuma 5.000 euro me përfundimin e ndërtimit të murit rrethues; (ii) planvendosje; (iii) shënime dore në një fletë A4 për punimet; (iv) deklaratë dore, datë 31.5.2009, që babai i subjektit i ka dhënë shitësit shumën 12.000 euro.

Në lidhje me burimin e ligjshëm të dy objekteve të mësipërme (ii dhe iii), subjekti ka deklaruar se burimi i ligjshëm i të ardhurave të babait të tij në atë periudhë ishte kryesisht paga e tij si mjek në Spitalin Rajonal të V. apo edhe vizitave të ndryshme që bënte në atë kohë pas orarit zyrtar të punës. Gjithashtu, në këtë periudhë ka ushtruar punë edhe nëna e subjektit V. Sh., e cila është merceologe e lartë<sup>41</sup>. Më pas, me të ardhurat e sigluara nga aktiviteti në klinikën mjekësore, por edhe me të ardhurat si mjek në Spitalin Rajonal të V., është ndërtuar banesa në fshatin \*\*\*.

<sup>40</sup>Kontratë shitje nr. \*\*\* datë 23.3.2017, hartuar përpara noteres publike S. H.

<sup>41</sup>V. Sh. ka punuar në ish- \*\*\* (prej këtu e njohur si “NTUS”) në periudhën 1978 – 1988. Pastaj, në cilësinë e Kryetares së Degës së \*\*\* (pozicioni i punës së Drejtoreshës) pranë degës e \*\*\*, Vlorë (ish-hotel \*\*\*, Vlorë) në periudhën 1988 – 1995. Më pas, për rreth 1 vit në ish \*\*\* sh.a., \*\*\*, Vlorë (ish-ndërmarrje publike e privatizuar pas rënien së sistemit komunist)

Komisioni i ka përfshirë këto dy pasuri në analizën financiare të subjektit dhe personave të lidhur me të, për periudhën 1994 – 17.11.2011<sup>42</sup> (data e pagesës së këstit të parë prej 25,000 euro për blerjen e apartamentit dhe garazhit në Tiranë), nga ku ka rezultuar një balancë financiare negative paraprake prej 46.763.434 lekë .

Për konstatimin e mësipërm, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

6.1 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar, ndër të tjera, se pasuritë e prindërve janë krijuar kryesisht në kohën kur ka qenë i mitur ose student në Poloni dhe nuk kanë asnjë lidhje me detyrën e tij. Ndër të tjera, subjekti shpjegon se nuk ka kontribuar për krijimin e këtyre pasurive në asnjë lloj forme për shkak të moshës së tij të mitur (koha kur është ndërtuar klinika private e babait dhe apartamenti në Vlorë) ose të rritur (koha e ndërtimit të banesës në \*\*\*). Pra, subjekti jo vetëm nuk ka kontribuar në krijimin e këtyre pasurive, por sipas Kodit të Familjes, si një fëmijë i mitur dhe, më pas, i rritur ka qenë i detyruar të qëndrojë në një familje me prindërit. Subjekti ka depozituar edhe një kontratë për blerjen nga ana e prindërve të një njësie shërbimi (dyqan), që meqenëse nuk u përdor nga motra e tij është dhënë me qira. Pavarësisht se kontratat nuk kanë qenë të formalizuara dhe nuk është paguar tatimi, ky është një tregues se pasuritë e krijuara nga prindërit e subjektit nuk janë formuar si pasoje e ndonjë aktiviteti kriminal, nga ku, më pas, subjekti do të rezultonte përfitues i tërthortë, për shkak të pasurive të dhuruara nga familjarët. Prindërit nuk duhet të konsiderohen persona të lidhur dhe pasuritë e tyre nuk duhet të hetohen për sa kohë nuk janë në përbërjen e certifikatës familjare të subjektit, në momentin e plotësimit të deklaratës Vetting.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni për pasuritë e pasqyruara në pikat i, ii, iii.**

**Komisioni vlerëson të sqarojë se në analizën financiare, për periudhën 1994 – 17.11.2011, ka përfshirë edhe vlerën e një dyqani prej 34.000 USD, të prenotuar nga babai i subjektit në datën 25.2.2003, i paguar me këste deri në datën 15.6.2004, dokumentacioni i të cilit u vu në dispozicion të Komisionit nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, gjithashtu, duke marrë në konsideratë edhe pretendimin e subjektit për reduktimin e shpenzimeve të shkollimit të motrës, në Poloni.**

**Komisioni vlerëson të mos konkludojë në mënyrë të veçantë për secilën nga këto tri pasuri, por të pasqyrojë efektin e tyre financiar në analizimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë apartament me sip. 62.94 m<sup>2</sup> dhe të garazhit në datën 17.11.2011 (datë kur është paguar kësti i parë prej 25.000 euro), të deklaruara këto në deklaratën Vetting në emër të subjektit, me burim krijimit nga të ardhurat e prindërve, ndër vite, prej vitit 1994, analizë kjo, nga e cila subjekti dhe personat e lidhur, pas rishikimit të saj, kanë rezultuar me balancë financiare negative në vlerën 48.633.133 lekë.**

## **7. Në lidhje me kriterin e pasurisë pas riçeljes së hetimit**

7.1 Në datën 11.3.2021, pas zhvillimit të seancës dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Bevis Shehaj, është paraqitur denoncimi nr. \*\*\*, sipas të cilit babai i subjektit rezulton deri në maj të vitit 2021 pronar i vetëm i pasurisë e llojit “truall”, me nr. \*\*\*, me sip. 300 m<sup>2</sup> truall, nga të cilat 70 m<sup>2</sup> ndërtesë.

Bashkëngjitur këtij denoncimi gjendet edhe certifikata e pronësisë nr. \*\*\*, nga ku rezulton se babai i subjektit është pronar i pasurisë me nr. \*\*\*, ZK s’ka, \*\*\*, me sip. 300 m<sup>2</sup> truall, nga të cilat 70 m<sup>2</sup> ndërtesë.

<sup>42</sup>Shihni tabelën e analizës financiare në faqen 7 të rezultateve të hetimit.

7.2 Subjekti, në pyetësorin e datës 20.3.2022, ndër të tjera, ka shpjeguar se nuk ka deklaruar asnjë pasuri të prindërve të tij prej vitit 2015 e në vijim sepse ata nuk kanë qenë persona të lidhur me të, pasi nuk i kanë dhuruar asnjë pasuri nga momenti i ushtrimit të detyrës së gjyqtarit stazhier (nëntor 2015) apo gjyqtarit administrativ (viti 2017). Edhe nëse kjo pasuri do të duhej të deklarohet, në eventualitet ajo do të deklarohet nga babai i subjektit B. Sh., i cili mund të ishte person i lidhur me subjektin. Kjo është një pasuri e trashëguar nga paraardhësit për babain dhe gjithë vëllezërit e tij, pavarësisht se rezulton në emrin e babait të subjektit, i cili nuk ka kryer asnjë investim në këtë pasuri.

7.2.1 Subjekti ka bashkëngjitur vendimin nr. \*\*\*, datë 11.5.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për çështjen gjyqësore Xh. Sh. kundër B. Sh., me objekt padie “detyrim njohje pronar” dhe me objekt të kundërpadisë “detyrim i bashkëpronarit Xh.Sh. të lejojë bashkëpronarët e tjerë në posedimin e gëzimitin qetësisht të sendit në bashkëpronësi me sip. trualli 300 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 70 m<sup>2</sup>, me nr. Pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, \*\*\* ”.

Në faqen 6 të vendimi shtetasi T. Sh. ka parashtruar se e ka blerë pasurinë me sip. 300 m<sup>2</sup>, të cilën e ka në posedim, si dhe ka kryer investime të shumta. Ai ka pretenduar se kjo pasuri është regjistruar në emër të të paditurit B. Sh.

Në faqen 11 të vendimit, sipas aktekspertimit, konkludohet se: “*Në momentin e inspektimit u konstatua se posedimi ushtrohet nga ana e z. Xh. Sh.*”. Dëshmitarët e thirrur në proces kanë deklaruar se pasuria është në posedim të z. Xh. Sh.

7.2.2 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga subjekti konstatohet se pasuria objekt denoncimi ka qenë në posedim të xhaxhait të subjektit Xh. Sh. dhe babai i tij B. Sh. ka fituar gjyqin në cilësinë e bashkëpronarit të kësaj pasurie. Në këtë gjykim babai i subjektit është përfaqësuar nga avokati D. B.

Subjekti ka vijuar të ketë pretendime në lidhje me kriterin e pasurisë, për sa i përket të ardhurave të motrës së tij, për të cilat i është bërë me dije gjatë hetimit për mosmarrjen në konsideratë të tyre. Gjithashtu, subjekti ka ngritur pretendime në lidhje me llogaritjen e gabuar të të ardhurave dhe elementeve të tjera të analizës, të cilat do të shpjegohen në vijim në analizën financiare.

## **8. Analiza financiare**

Komisioni ka konstatuar se nga analiza e deklaratave të interesave pasurore private/vjetore dhe asaj *Vetting* për periudhën e hetimit 20.11.2015 – 2016 të kryer nga Komisioni, si dhe për periudhën 1994 – 20.11.2015, gjatë së cilës janë krijuar pasuritë e deklaruar në *Vetting*, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur/të tjerë të lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë në shumën 61.674.382 lekë.

Për konstatimin e mësipërm subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me kriterin e pasurisë, në prapësime, ndër të tjera, ka shpjeguar se nuk ka asnjë lidhje logjike dhe racionale midis subjektit dhe krijimit të këtyre pasurive, pasi nuk ka transaksione bankare apo edhe dyshime të vogla që ato janë krijuar prej tij, qoftë edhe pjesërisht. Për më tepër, këto pasuri, ose të paktën pjesa dërrmuese e tyre, janë krijuar përpara se subjekti, jo vetëm të emërohej si gjyqtar (shkurt 2017), por edhe të shpallej fitues si student magjistrat pranë Shkollës së Magjistraturës (shtator 2013).



Pas riçeljes së hetimit, në datat 11.4.2022 dhe 9.6.2022, subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet shtesë, ka parashtruar me shkrim disa pretendime të tjera për kriterin e pasurisë, përveç atyre të trajtuara në paragrafët e mësipërm.

Në shpjegimet e datës 11.4.2022 ka kërkuar që të hetohet edhe motra e tij dhe bashkëshorti i saj për burimet e ligjshme të pasurisë së prindërve të tij. Në këto përgjigje, subjekti ka parashtruar me shkrim argumente shtesë në lidhje me pasaktësitë e pretenduara në vlerat e llogaritura nga Komisioni për pasuritë e tij përpara fillimit të detyrës dhe pasuritë e personave të lidhur me të. Konkretisht, subjekti ka kundërshtuar përllogaritjen e kryer nga Komisioni për:

- të ardhurat nga punësimi në SHBA gjatë viteve akademike 2008 - 2009 dhe 2009 – 2010, ku sipas subjektit ato duhen përfshirë në analizën financiare në vlerën 17.000 – 18.000 USD (11.000 USD nga puna e parë + 6.000 USD nga puna e dytë) dhe jo 5.000 USD që Komisioni e ka marrë si diferencë midis shumave të mësipërme. Gjitashtu, subjekti pretendon se ka përfutur pagën *bruto*, pasi ai ka qenë i përjashtuar nga pagimi i taksave federale për shkak të programit studentor;
- të ardhurat si pedagog i brendshëm në Universitetin \*\*\* të Tiranës “\*\*\*\*” për periudhën shtator/tetor 2011 – korrik 2014 (32 muaj), pasi sipas subjektit ai është paguar me pagë *bruto* 30.000 lekë/muaj ose pagë *neto* 25.000 lekë/muaj, me një shumë totale prej 800.000 lekësh;
- të ardhurat e babait të tij si mjek gjinekolog në klinikën private deri në vitin 2014, ku sipas subjektit janë rreth 10.000.000 lekë dhe jo 0 (zero) lekë sipas Komisionit. Si provë për pretendimin e tij subjekti ka cituar shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.11.2022, të Bashkisë Vlorë;
- të ardhurat e babait si likuiditete në banka sepse, sipas tij, ato janë llogaritur disa herë pasi babai i ka konfirmuar sa disponon vetëm 6 - 7.000.000 lekë në bankat e nivelit të dytë;
- shpenzimet e shkollimit të motrës së tij gjatë viteve 2000 - 2005 në shumën 3.800.000 lekë sepse kjo shumë nuk është e mbështetur në asnjë provë konkrete dhe se shpenzimet vjetore kane qenë 2.000 - 2.500 USD, duke rezultuar me një shpenzim total prej 15.000 - 16.000 USD.

Në shpjegimet e datës 9.6.2022 subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se:

- Komisioni nuk ka aplikuar të njëjtin standard në përllogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasi në momentin e përllogaritjes së çmimit për blerjen e apartamentit në Tiranë, edhe pse e provuar me pagesa bankare, çmimi realisht i paguar prej 27.000 euro është llogaritur çmimi i kontratës prej 33.000 euro. Ndërkohë, në përllogaritjen e pagës si pedagog për periudhën tetor 2011 – korrik 2014, Komisioni nuk i referohet pagës së përcaktuar në kontratën e punës, por i referohet pagës realisht të paguar në sistemin bankar.
- Pyetja e dërguar nga Komisioni se përse nuk është deklaruar nga ana e tij pasuria e të atit e ndodhur në fshatin \*\*\*, është tendencioze sepse subjekti nuk është pyetur më parë për deklarimin e të gjitha pasurive të babait të tij, madje për njërin prej tyre (dyqanin), të cilin e ka deklaruar në seancë dëgjimore, përsëri nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni.
- Mospërfshirja e personit të lidhur/motrës I. Sh.-C. dhe bashkëshortit të saj në hetimin administrativ cenon parimin e kryerjes së një hetimi të plotë, me qëllim përcaktimin e gjendjes faktike, pasi ato janë pjesë e certifikatës familjare të vitit 2016 dhe të ardhurat e tyre mujore 15.000 euro/muaj zerojnë hendekun e analizës financiare të konstatuar padrejtësisht nga Komisioni.
- Tërheqja e Komisionit nga kërkesat e drejtuara shtetit polak për informacion pa dhënë ndonjë arsye të ligjshme, veprime hetimore këto që bien në kundërshtim me arsyen e dhënë

nga Komisioni se nga ana e subjektit nuk është parashtruar kërkesë në momentin e duhur procedural.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

8.1 Komisioni vlerëson se në lidhje me kërkesën e subjektit për të përfshirë në analizë edhe motrën dhe bashkëshortin e saj, për sa kohë nga ana e subjektit në deklaratën Vetting gjatë hetimit ku ka deklaruar se motra dhe bashkëshorti i saj nuk janë të përfshirë si persona të lidhur, si dhe në seancë dëgjimore nuk është pretenduar se të ardhurat e motrës dhe të bashkëshortit kanë shërbyer si burim, nuk do të zgjerojë hetimin për familjarët e tij.

Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për përlogaritjet e kryera në analizën financiare nga verifikimet e Komisionit, rezultoi si më poshtë vijon:

- Në lidhje me pretendimin për keqlllogaritjen e të ardhurave nga punësimi në SHBA, Komisioni vëren se shuma e marrë në analizën financiare është 6.409 USD (11.624 USD - 5.214 USD) dhe jo 5.000 USD sa shpjegon subjekti në pretendimet e tij. Kjo vlerë ka ardhur si diferencë midis të ardhurave *neto* (11.624 USD) me shpenzimet jetike (5.214 USD) dhe jo si diferencë midis të ardhurave nga puna e parë (11.000 USD) me të ardhurat nga puna e dytë (6.000 USD). Gjithashtu, pagat janë llogaritur për vlerën e tyre *neto*, pasi subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor se ka qenë i përjashtuar nga tatimet, kur ndërkohë gjatë hetimit ka pretenduar se tatimet e paguara i janë kthyer, edhe kjo e paprovuar me dokumentacion. Ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit, kur deklaroi vlerën e pretenduar prej tij, nuk merr në konsideratë elementin e shpenzimeve jetike.
- Në lidhje me pretendimin për keqlllogaritjen e të ardhurave nga puna e tij si pedagog i brendshëm pranë Universitetit \*\*\* të Tiranës “\*\*\*”, Komisioni vëren se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion ligjor me të cilin të provojë se për ardhurat në vlerën 800.000 lekë janë paguar tatime, përveç kontratës së lidhur me punëdhënësin. Komisioni, në vlerën e 343.891 lekë të llogaritur në analizën financiare, i është referuar vërtetimeve nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2021 dhe nr. \*\*\* prot., nga DRSSH-ja Tiranë, të cilat provojnë periudhën për të cilën janë bërë deklaratimet në organet tatimore dhe të ardhurat e përfituara.
- Në lidhje me pretendimin për mospërfshirjen në analizë të të ardhurave nga aktiviteti i babait të tij, Komisioni vëren se subjekti në përlogaritjen e tij i referohet shkresës së Bashkisë Vlorë, e cila konfirmon xhiron e vlerësuar, i cili nuk është tregues i fitimit të realizuar. Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë i konfirmon si subjektit, ashtu edhe Komisionit, se për periudhën 2010 – 2015 aktiviteti ka rezultuar me humbje, vlerë kjo e pasqyruar në analizën financiare të kryer nga Komisioni. Nga përgjigja e organit kompetent rezulton se vetëm në vitin 2016 ky aktivitet ka krijuar fitim në vlerën 859.434 lekë.
- Në lidhje me pretendimin se likuiditetet e babait të tij janë llogaritur disa herë nga Komisioni, ky pretendim nuk qëndron. Shpjegimi i detajuar në relacion i historikut dhe lëvizjeve bankare të prindërve të subjektit nuk do të thotë se këto vlera janë llogaritur sa herë që është shpjeguar kalimi i tyre nga njëra llogari në tjetrën. Komisioni, për vlerësimin e likuiditeteve, është mbështetur në informacionin e marrë nëpërmjet bankave të nivelit të dytë.
- Në lidhje me pretendimin për përlogaritje të gabuar dhe të pabazuar të shpenzimeve të shkollimit për motrën e subjektit, Komisioni, referuar kohës më të hershme të studimit të motrës (vitet 2000 - 2006), merr në konsideratë shpjegimet e subjektit dhe i përfshin shpenzimet e shkollimit në analizën financiare në shumën 2.250 euro/muaj, sipas vlerës mesatare të deklaruar prej tij.

- Në lidhje me pretendimin për mosaplikimin e të njëjtit standard në përlllogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve, vëren se ky pretendim nuk qëndron, pasi Komisioni nuk ka marrë në konsideratë në analizën financiare si çmim të blerjes së apartamentit vlerën 33.000 euro të pasqyruar në kontratë, por vlerën 27.000 euro që ka rezultuar nga pagesat bankare në harmoni edhe me deklaratimet dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit. Për sa i përket përlllogaritjes së pagave nga puna si pedagog, Komisioni i është referuar vërtetimeve nga institucionet përkatëse<sup>43</sup>, të cilat provojnë të ardhurat e ligjshme nga pagat (për të cilat është paguar tatim). Në lidhje me shënimin “sipas bankave”, e bërë nga Komisioni për të ardhurat nga pagat/bursa, është kryer me qëllimin e pasqyrimin të një vlere sa më të saktë të të ardhurave, pasi analiza financiare ka si kërkesë të saj fragmentarizimin e të ardhurave në një datë të caktuar (data e krijimit të pasurisë). Pra, në analizën financiare për të ardhurat nga pagat janë marrë në konsideratë të ardhurat sipas vërtetimeve të ISSH-së<sup>44</sup> (vetëm për to provohet pagesa e detyrimeve) dhe jo sipas pagesave bankare<sup>45</sup>, ndërsa për të ardhurat nga bursa, meqenëse përputhet informacioni sipas vërtetimit me atë bankar, shuma e përfituar deri në datën e krijimit të pasurisë është evidentuar nga bankat.
- Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë pasuritë e tjera të babait të tij, të cilat subjekti i deklaroi në seancë dëgjimore, Komisioni vlerëson se dyqanin e deklaruar dhe për të cilin ka pretenduar ekzistencën e marrëdhënies së qirasë, subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor përfitimin e të ardhurave të ligjshme nga qiraja dhe, për këtë arsye, nuk i ka marrë në konsideratë ato. Ndërkohë, kontrata e premtimshitjes së dyqanit, e datës 25.2.2003, në shumën 34.000 USD si pasuri e prindërve të subjektit, do të reduktonte akoma më shumë mundësinë financiare të prindërve të subjektit për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve. Në lidhje me pyetjen e ngritur për pasurinë e babait në fshatin \*\*\*, Komisioni sqaron se ajo është identifikuar pas një denoncimi të ardhur nga publiku dhe jo nga hetimi i Komisionit i kryer në ASHK për shkak të dokumentacionit specifik, formularit \*\*\*, me të cilin është përfituar, si dhe nuk është deklaruar as në seancë dëgjimore nga subjekti kur ka listuar të gjitha pasuritë e babait të tij.
- Në lidhje me mopërfshirjen e motrës së subjektit dhe bashkëshortit të saj, Komisioni vëren se qëndrimi i subjektit se këta persona nuk kanë lidhje me pasuritë e familjes së tij dhe se për këtë arsye ato nuk duhen përfshirë në hetim, ka qenë konsistent deri në datën 9.3.2022 kur vetë subjekti ka rishpjeguar se dyqani i prenotuar nga i ati për klinikë stomatologjie për të motrën nuk u përdor kurrë prej saj, pasi ajo nuk u kthye në Shqipëri. Ashtu si është shpjeguar edhe më lart, nuk rezultojnë as transaksione bankare midis motrës së subjektit dhe familjarëve të saj.
- Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni është tërhequr nga hetimi i nisur në shtetin polak, ky pretendim nuk është i vërtetë, pasi në korrespondencën e kryer nga Komisionit në lidhje me këtë subjekt nuk rezulton të ketë kërkim për informacion në shtetin polak.

Pas dërgimit të prapësimeve dhe seancës dëgjimore, Komisioni, për sa ka argumentuar më sipër, kreu analizën financiare të rishikuar, e cila rezultoi si më poshtë vijon:

<b>Përshkrimi</b>	<b>1994 – 20.11.2015</b>	<b>20.11.2015-31.12.2015</b>	<b>2016</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>12,917,205</b>	<b>382,999</b>	<b>3,006,573</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	0	29,345	963,529

<sup>43</sup>Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2021, dhe nr. \*\*\* prot., e DRSSH-së Tiranë.

<sup>44</sup>Të ardhurat e konfirmuara nga ISSH-ja janë në shumën 343.891 lekë.

<sup>45</sup>Pagesat bankare jane në shumën 337.395 lekë.

Të ardhura nga bursa	1,232,058	0	0
Të ardhura nga paga si pedagog	343,891	0	0
Të ardhura nga paga e babait	7,686,682	72,142	868,813
Të ardhura nga paga e nënës (asistencë/pension)	24,655	0	85,535
Të ardhura nga aktiviteti privat i babait	0	0	859,434
Të ardhura nga interesat bankare	2,345,754	281,512	229,262
Të ardhura nga punësimi në SHBA 2009 – 2010 (11,624 USD - 5,214 USD)	612,693	0	0
Të ardhura nga shitja e mjetit “Mercedes-Benz” me targa ***, datë 30.9.2014, (4,800 x 139,89)	671,472	0	0
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Shpenzime</b>	<b>21,270,777</b>	<b>210,176</b>	<b>1,229,901</b>
Shpenzime jetike	6,553,948	75,578	705,276
Shpenzime udhëtimi	2,846,705	0	524,625
Shpenzime mobilimi	500,000	0	0
Humbje nga aktiviteti privat i babait	1,539,788	134,598	0
Shpenzime shkollimi Poloni, motra e subjektit 2000 - 2006	1,730,565	0	0
Shpenzime shkollimi Poloni, subjekti 2006 - korrik 2011	3,876,900	0	0
Shuma e dhuruar I. M. C. datë 13.3.2015 (30.071 x 140.43)	4,222,871		
<b>Pasuri</b>	<b>55,190,509</b>	<b>-223,336</b>	<b>-772,832</b>
Kursime (shtesa/pakësime likuiditeti)	22,573,852	-223,336	-772,832
Likuiditete në fund të vitit	22,573,852	22,350,515	21,577,683
Shtëpi me sip. 62.94 m <sup>2</sup> +garazh, ***	3,799,380	0	0
Automjet “Ford Focus” me targa ***, datë 27.10.2014	1,830,743	0	0
Apartament ***, datë 30.9.2002, me çmim 40,590 USD	4,915,707	0	0
Dyqan te ***, datë 25.2.2003, me çmimin 34,000 USD	3,984,834		
Automjet me targa ***, ft. ***, datë 30.8.2013, me çmim 32,500 euro	4,549,350	0	0
Automjet “Mercedes-Benz” me targa ***, datë 12.2.2007, me çmim 12,600 euro	1,563,660	0	0
<b>Dosja e legalizimit 2016 datë ... për shtëpi në ***, sip. ndërtimi 286 m<sup>2</sup></b>			
Tokë 392 m <sup>2</sup> , *** (sipas kontratës kapar datë 13.12.2008, 500 m <sup>2</sup> x 60euro/m <sup>2</sup> ) 2008 - 2010	2,926,000	0	0
Tokë 392 m <sup>2</sup> pagesë e kështit të fundit, datë 25.9.2014	210,075	0	0
Ndërtesë 2kt+1,286 m <sup>2</sup> ***, ndërtuar në 2007-ën sipas vetëdeklarimit për legalizim datë 4.12.2014/kosto ndërtimi sipas EKB-së 2007	7,105,384	0	0
<b>Dosja e legalizimit ***, datë 21.3.2005, për klinikën, sip.ndërtimi 76 m<sup>2</sup></b>			
Ndërtesë 2kt, sip. 76 m <sup>2</sup> , Vlorë, sipas EKB-së 1996	1,147,372	0	0
Vlera e tarifës së shërbimit, pagesë datë 5.5.2009 për ALUIZNI Vlorë	4,000	0	0

Taksa e ndikimit në infrastrukturë datë 30.5.2009/ALUIZNI Vlorë	18,646	0	0
Parcelë ndërtimore (klinika private) datë 26.10.2012	550,000	0	0
Vlera e tarifës së shërbimit K ***, pagesë datë 5.4.2013/ALUIZNI Vlorë	4,000	0	0
Vlera e tarifës së shërbimit për dokumentacion, pagesë 5.4.2013/ALUIZNI Vlorë	6,000	0	0
Taksa e ndikimit në infrastrukturë 5.4.2013/ALUIZNI Vlorë	1,507	0	0
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>-63,544,081</b>	<b>396,159</b>	<b>2,549,504</b>

**Nga analiza e deklaratave të interesave pasurore private/vjetore dhe deklaratës *Vetting*, për periudhën e hetimit 20.11.2015 – 2016 të kryer nga Komisioni, si dhe për periudhën 1994 – 20.11.2015 gjatë së cilës janë krijuar pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë në shumën 63.544.081 lek**

Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues konkludon se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë të pasurive dhe burimeve të ligjshme të tyre në deklaratën e pasurisë *Vetting*, në përputhje me germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, në kuptim të parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia, në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Në këto rrethana, Komisioni, pasi mori në konsideratë edhe parimin e proporcionalitetit, në lidhje me faktin se pasuritë e deklaruara nga subjekti janë krijuar para detyrës me të ardhurat e prindërve të tij, në lidhje me faktin se pavarësisht kategorizimit të prindërve të subjektit qoftë si persona të lidhur, ashtu edhe si persona të tjerë të lidhur, përsëri balanca financiare mbetet në vlera negative të konsiderueshme (**-63.544.081 në analizën financiare për periudhën 1994 – 20.11.2015 dhe -48.633.133 për pagesën e kështit të parë për blerjen e apartamentit dhe garazhit, me burim të ardhurat nga prindërit si persona të lidhur, si dhe -6.905.990 në rast se do t’i konsiderojmë si persona të tjerë të lidhur**), duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në kushtet e cenimit të besimit të publikut tek drejtësia, të cilat, sipas parashikimeve të pikave 3 dhe 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

## B. VLERËSIMI I FIGURËS

**9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

9.1 Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar me vendim nr. \*\*\*, datë 27.10.2021, të KDZH-së.

9.1.1 Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Si konkluzion, DSIK-ja ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Bevis Shehaj*.

9.2 Pas zhvillimit të seancës dëgjimore të datës 10.3.2022, në datën 11.3.2022 pranë Komisionit u depozitua një denoncim, sipas të cilit *subjekti ka kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar, pasi xhaxhai i tij, z. M. T. Sh., është në proces gjyqësor për trafikim lëndësh narkotike*

9.3 Denoncuesi i ka bashkangjitur denoncimit një foto të subjektit të rivlerësimit me xhaxhain e tij dhe një personi të pidentifikuar dhe në foto ka një shënim “*gëzuar ditëlindjen zio*”.

9.4 Komisioni, pasi analizoi këtë denoncim, vendosi të riçelë hetimin administrativ për kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimin pasurisë.

9.5 Komisioni ka verifikuar sistemin *TIMS* të subjektit të rivlerësimit, ku ka rezultuar se subjekti ka udhëtuar për në Romë, Itali, në datat 14.6.2016, 7.4.2017 dhe 12.4.2018. Për këto

udhëtime, Komisioni, me pyetësin nr. 4, i ka kërkuar subjektit të shpjegojë në lidhje me personat që e kanë shoqëruar në këto udhëtime, njohjet që ka me ta, kohën e qëndrimit në Romë, vendi/vendet ku ai ka qëndruar, personat që e kanë pritur dhe shoqëruar në Romë me të dhëna të detajuara për ta, lidhjet shoqërore apo familjare që ai ka me këta persona dhe nëse këto lidhje janë të vazhdueshme.

9.6 Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “Në lidhje me pyetjen tuaj për tri udhëtimet e mia në Romë, Itali gjatë vitit 2016, 2017 dhe 2018 dhe për persona e lidhur me mua, të cilët më kanë shoqëruar në këto udhëtime, identitetin e tyre dhe nëse me ta ruaj një raport të qëndrueshëm e të vazhdueshëm, argumentoj si në vijim (Komisioni është fokusur vetëm tek çështja konkrete)... unë kam udhëtuar vetëm një herë drejt Romës dhe, konkretisht, më datat 7.4.2017 – 9.4.2017. Në këtë udhëtim kam qenë i shoqëruar me dy kushërinjtë e mi z. E. dhe z. M. Sh.... Adresa e vetqëndrimit ka qenë ‘\*\*\*’, me tre yje, me adresë ‘\*\*\*’ (vërtetimi i lëshuar nga ky hotel bashkëlidhur kësaj shkrese). Në aeroportin e Romës kam pajtuar një automjet me qira të llojit ‘\*\*\*’, me qira ditore 50 euro/dita. Gjatë qëndrimit tim kam vizituar ungjin tim z. M. Sh., djalin e tij, z. S. T. P., z. N. Sh. dhe z. E. Sh. Tre të fundit ndiqnin shkollën e mesme profesionale në qytetin e Romës, ndërsa ungji im jeton atje bashkë me bashkëshorten e tij znj. A. Sh. Arsyeja e kësaj vizite ishte vizita e tre kushërinjve të mi z. N., E. dhe T. Sh., të cilët ndiqnin shkollën e mesme, ndërsa ky i fundit kishte edhe ditëlindjen e tij. Gjatë kësaj vizite kam qëndruar në hotelin e sipëridentifikuar... Në këtë vizitë, kam vizituar edhe familjen e ungjit tim, z. M. Sh., së bashku me bashkëshorten e tij, znj. A. Sh., për një kafe mëngjesi.

... gjatë vitit 2018-2019 jam vendosur në dijeni se ungji im, z. M. Sh., është arrestuar nga autoritetet italiane (veprën penale për të cilën ai akuzohej, në atë moment nuk e kam ditur). Mbaj mend që ato ditë, me qëllim qëndrimin sa më afër të ungjit tim, kanë udhëtuar të gjithë të afërmit e mi drejt Italisë, përfshirë edhe denoncuesin, përveç atit tim dhe nënës sime. Këta të fundit, me qëllim të posaçëm dhe koshiencë të plotë, kanë refuzuar të shkojnë atje për shkak të veprës penale për të cilin ai akuzohej. Pasi kanë kaluar 2-3 muaj, di që i afërmi im është liruar nga ambientet e paraburgimit dhe tani është i lirë.

... pasi më erdhën pyetjet tuaja, me anë të familjarëve të mi, jam interesuar për veprën penale për të cilën akuzohej i afërmi im. Ai na ka dhënë dy argumente kryesore, të cilat mendoj se mund të vlejnjë t’i përmend përpara Jush. E para, që i akuzuari për bashkëpunëtor me të në kryerjen e veprës penale është shpallur i pafajshëm, me argumentin që nuk e ka kryer faktin penal (dispozitivi i vendimit të nënshkruar nga gjyqtari A. G. bashkëlidhur), sipas të afërmit tim, për aq kohë sa personit të lidhur në akuzën penale i është dhënë një vendim pafajësie, ai pret po të njëjtën gjë edhe ndaj tij (vendim pafajësie). E dyta, ndaj ungjit tim ende nuk është marrë një vendim dhe çështja po pret radhën për t’u gjykuar. Nga informacionet të dhëna nëpërmjet familjarëve të mi, rezulton se çështja e tij pritet të mbyllet së shpejti (janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare) dhe mbi Kodin e Procedurës Penale Italiane rëndon parimi për prezumimin e pafajësisë. Si rrjedhim, gjatë udhëtimit tim në prill të vitit 2017, në Romë, Itali, ka ndodhur kur i afërmi im nuk ka qenë i dënuar dhe madje as i arrestuar, si dhe ai akoma është i pafajshëm edhe në ditët aktuale në përputhje me parimin e prezumimit të pafajësisë.

... unë nuk mund të konsiderohem se kam kontakte të papërshtatshme. Kjo për arsyet se, në momentin e përpilimit të formularit të dekriminalizimit të hartuar prej meje në vitin 2015-2016 dhe të depozituar pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë apo edhe pranë DSIK-së, në përputhje me nenin 5 të ligjit numër nr. 138/2015 ‘Për garantimin e integritetit të personave të që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’, dhe nenit 35 të ligjit nr. 84/2016 ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, i afërmi im ka qenë i padënuar dhe madje as i proceduar penalisht.

*Si përfundim, vlerësoj se i afërmi im nuk mund të konsiderohet kontakt i papërshtatshëm me mua, për arsye se: (i) nuk ka qenë i dënuar në momentin e përpilimit të deklaratave nga ana ime sipas ligjit nr. 138/2015 dhe ligjit nr. 84/2016; (ii) i afërmi im nuk është dënuar ende për veprën penale të akuzuar me një vendim gjyqësor përfundimtar dhe aq më pak me një vendim gjyqësor të formës së prerë; (iii) në Kodin e Procedurës Penale Italiane rëndon parimi i prezumimit të pafajësisë dhe, si e tillë, i afërmi im duhet të konsiderohet i pafajshëm deri në momentin kur ai të deklarohet ndryshe me vendim gjyqësor të formës së prerë; (iv) bashkëpunëtori eventual në kryerjen e veprës penale, sipas organit akuzator është liruar nga akuza me arsyen se nuk e ka kryer faktin (non aver commesso il fatto), forma më e lartë e pafajësisë; si dhe (v) kur kam kryer udhëtimin në Romë gjatë prillit të 2017, unë im nuk kishte asnjë vendim penal të formës së prerë kundër tij apo nuk kishte procedim penal të deklasifikuar, ku të ishin zbatuar masat publike paraprake penale, sikundër mund të ishin masat e sigurimit, me anë të cilave unë të kisha idenë se, ndaj tij kishte procedim penal”.*

9.6.1 Subjekti ka depozituar dokumentacionin: (a) dokumentet shkollorë të të afërmeve të tij, N. Sh., E. Sh. dhe S. T. P.; (b) vërtetimin e lëshuar nga hoteli në lidhje me qëndrimin e tij në prill të vitit 2017.

9.7 Komisioni, në lidhje me xhaxhain e subjektit të rivlerësimit, z. M. Sh., ka kryer dhe hetimin përkatës, duke administruar përgjigjen e Ministrisë së Drejtësisë<sup>46</sup>, e cila ka përcjellë informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme Burgjeve<sup>47</sup>, duke vënë në dispozicion vërtetimin e gjendjes gjyqësore të shtetasit M. Sh., i cili rezultoi i “pa dënuar”.

9.8 Komisioni ka administruar edhe informacionin e referuar si “gjetje” nga vëzhguesi ndërkombëtar<sup>48</sup>, sipas të cilës: *Vëzhguesi ndërkombëtar paraqet këtë gjetje në lidhje me një vendim të gjyqarit të hetimit paraprak të Gjykatës së Zakonshme të Romës (Itali) të datës 22.5.2020, për përcaktimin e gjykimit. Ndër të tjera, vendimi parashikon se personi Sh. M., lindur më 18.7.1968, në Shqipëri, akuzohet për veprën penale, sipas nenit 110 të K. P. dhe 73 pika 4 e D.P.R n. 309/90, sepse në bashkëpunim me K. B, ky i fundit i proceduar veçmas, pa autorizim sipas nenit 17 të D.P.R së sipërcituar, i kanë dhënë T. H. dhe L. Sh. 980 gr. lëndë narkotike të tipit hashash, të fshehur në një qese me logon e “\*\*\*”, lëndë e sekuestruar nga operatorët në momentin e dorëzimit të substancës. Sipas aktit gjyqësor, bashkëngjitur kësaj gjetje, duke konsideruar se nuk ekzistojnë kushtet për marrjen e një vendimi mosfillimi procedimi, në bazë të nenit 425 të k.p.p është vendosur kalimi në seancë shqyrtimi për vlerësimin e burimit të provave. Ky informacion konsiderohet i rëndësishëm në kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit dhe duhet të jetë pjesë e dosjes së rivlerësimit.*

Bashkëlidhur kësaj gjetje janë dhe dokumentet: (i) shkresa nr. \*\*\* prot/B.SH., datë 13.5.2022, e MD dhe dokumentacioni bashkëngjitur (korrespondencë me e-mail duke përfshirë edhe me ONM); (ii) kopje e vendimit të gjyqarit për hetimin paraprak të Gjykatës së Zakonshme të Romës, vendimi për përcaktimin e gjykimit, datë 22.5.2020, në gjuhën italiane; (iii) kopje e vendimit të gjyqarit për hetimin paraprak të Gjykatës së Zakonshme të Romës, vendimi për përcaktimin e gjykimit, datë 22.5.2020, sipas përkthimit zyrtar në gjuhën shqipe.

9.9 Komisioni, bazuar në opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar, në shpjegimet e subjektit, nga ku rezultoi se ka qenë dijani i faktit se xhaxhai i tij ka qenë person i akuzuar për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike, e cila bazuar në pikën 8, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, klasifikohet si krim i organizuar, si dhe të fotos të depozituar nga denoncuesi, e cila i përket

<sup>46</sup>Përgjigjja e Ministrisë së Drejtësisë nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 28.4.2022.

<sup>47</sup>Përgjigjja e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nr. \*\*\* prot., datë 7.4.2022.

<sup>48</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2022, e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.



vitit 2021, konstaton se subjekti ka pasur në vijimësi kontakte me një person të përfshirë në krimin e organizuar, veprime të cilat duket se cenojnë besimin e publikut te drejtësia.

Për këtë konstatim, subjektit të rivlerësimit, iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

9.10 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se: *“Nga konstatimet tuaja në lidhje me figurën e ungjit im, z. M. Sh., rezulton se prokuroria pranë Gjykatës së Zakonshme të Romës, gjatë muajit maj të vitit 2020, ka vendosur të ngrerë akuzë penale ndaj tij për mbajtja e lëndëve narkotike, të kryer në bashkëpunim. Si rrjedhim, ju arrini në konkluzionin që ungji im është përfshirë në krimin e organizuar në formën e ‘trafikimit të lëndëve narkotike’, si rrjedhim, unë kam një kontakt të papërshtatshëm e, si e tillë, unë kam cenuar besimin te publiku. Nuk pajtohem aspak me këtë qëndrimin. Argumentet e mia për këto gjetje janë si në vijim.*

*Së pari, ungji im nuk po procedohet penalisht për ndonjë veprë penale, sikundër keni konstatuar ju pa të drejtë, si ‘trafikimi i lëndëve narkotike’. Ai është konstatuar në kryerjen e veprës penale të mbajtjes së lëndëve narkotike të kryer në bashkëpunim të thjeshtë. Nga të gjitha faktet e vendosura nga ju në dispozicion, nuk rezulton se ungji im të ketë kryer ndonjë veprë penale, ku të jetë përfshirë territori i ndonjë shteti të tretë përveç territorit të Republikës së Italisë. Vepra penale e trafikimit të lëndëve narkotike parashikohet për analogji në shtetin shqiptar në nenin 283/a të Kodit Penal. Sipas kësaj dispozite, kërkohet doemos kryerja e një veprë të tillë penale me anë të formës së importit, ekspertit, tranzimit apo të tregtimit të lëndëve narkotike midis dy shteteve. Çdo veprë tjetër penale në fushën e lëndëve narkotike, të cilat nuk përfshijnë të paktën territorin e dy vendeve, nuk mund të sanksionohet si veprë penale të ‘trafikimit të lëndëve narkotike’, por si ‘prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike’, të sanksionuar në nenin 283 të Kodit Penal Shqiptar.*

*Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjatë vitit 2011, janë investuar në dhënien e një vendimi unifikues, me qëllim bërjen e dallimit të kryerjes së veprës penale të me anë të trafikimit dhe shitjes së thjeshtë të lëndëve narkotike. Kështu, në Vendimin Unifikues nr. 3, datë 24.10.2011, ndër të tjera, shkruhet: ‘...sipas legjislacionit tonë penal, pavarësisht nga personat e llojet e mallrave që trafikohen dhe origjinën e tyre, në thelb, trafikimi nënkupton rastet kur veprimtaria e kundërligjshme, duke përfshirë Shqipërinë e territorin e saj, kryhet në më shumë se një shtet, kryhet në një shtet por është përgatitur, programuar, drejtuar e kontrolluar në një shtet tjetër, kryhet në një shtet por ka efekte e pasoja thelbësore në një shtet tjetër.*

*Prandaj, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin se, kriter bazë për kuptimin e zbatimin e drejtë të veprave penale të ‘trafikimit’, sipas Kodit Penal është parimi i territorit, i prekjes e përdorimit të tij, me qëllimin e realizimit në rrugë kriminale të përfitimeve, përmes hyrjes ose daljes së paligjshme të personave apo sendeve nga territori shqiptar ose kalimit të paligjshëm të tyre nëpërmjet territorit shqiptar..“ (faqe nr. 8 e vendimit). Në vijim, i njëjti qëndrim mbahet edhe në doktrinë. Kështu, autori I. E., në librin e tij me titull ‘E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme’, Tiranë 2009, në lidhje me veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike mban qëndrimin si në vijim: ... nga ana objektive, krimi kryhet me veprime të kundërligjshme, në mënyra të ndryshme si: (i) me anë të importimit të substancave narkotike dhe të farërave jashtë shtetit, p.sh., nga Venezuela e Kolumbia në Shqipëri, pa licencë e pa autorizim, në kundërshtim me ligjin e posaçëm për narkotikët; (ii) me anë të eksportimit të lëndëve narkotike...trafikantët ndërkombëtarë, lëndët e importuara i eksportonin në Evropë...në vitin 2005 u zbuluan organizata trafikantësh që eksportonin marijuanë nga Shqipëria në Itali e në shtete të tjerë; (iii) me anë të tranzitimit, damethënë zhvendosjes së objektit material në pika të ndryshme*

brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga fillimi i transportimit nga jashtë në kundërshtim me ligjin.. (faqe 516 e librit). Si rrjedhim, vepra penale mbi të cilën akuzohet ungi im nuk kualifikohet si “trafikimi i lëndëve narkotike“, por si ‘prodhim dhe shitje normale e lëndëve narkotike’, të sanksionuar për analogji nga neni 283/a dhe 283 të Kodit Penal Shqiptar.

Së dyti, neni 3§8 i ligjit nr. 84/2016 ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, shpjegon termin ‘krim i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni’. Sipas kësaj dispozite, një krim i tillë do të duhet të quhen veprat penale të sanksionuara si kompetencë e Gjykatës për Krimet e Rënda, sot Gjykata e kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (prej këtu e njohur si GjKKO) . Në vijim, neni 75/a i Kodit të Procedurave Penale sanksionon veprat penale, të cilat janë në kompetencën lëndore të GjKKO-së . Në këtë dispozitë nuk sanksionohet si kompetencë lëndore e kësaj gjykate të jetë as vepra penale e ‘trafikimit të lëndëve narkotike’ dhe as vepra e thjeshtë e ‘prodhim dhe shitje normale e lëndëve narkotike’. Madje, ky kod nuk sanksionon asnjë vepër penale si kompetencë lëndore e GjKKO-së, e cila lidhet me mbajtjen, shitjen, prodhimin etj., të lëndëve narkotike, duke e lënë atë si kompetencë të gjykatave të zakonshme. Kjo do të thotë që në kuptim të këtij ligji çdo vepër penale, e cila lidhet me kryerjen e shitjes, mbajtjes, transportimit, eksportimit, importimit, tranzimit etj., të lëndëve narkotike nuk mund të konsiderohet si krim i organizuar në kuptim të ligjit nr. 84/2016 ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, pasi shqyrtimi i këtyre çështjeve nuk është kompetencë lëndore e GjKKO-së.

Së treti, në lidhje me takimin tim me ungjin tim në muajin prill të vitit 2021, argumentoj si në vijim. Pikë së pari, e pranoj se është kryer ky takim me të. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e festimit të ditëlindjes të ungjit më të madh, z. N. Sh.. Ky i fundit është i datëlindjes 20.4.1961 dhe në datën 20.4.2022 ka festuar ditëlindjen e tij, konkretisht 60-vjetorin. Në atë ditëlindje, ai ka ftuar edhe prindërit e bashkëshortes sime të ardhshme, znj. L. Sh., për të pasur një takim njohës me ta. Në atë takim ka marrë pjesë edhe ungi tjetër, i cili kishte ardhur po atë ditë nga Italia ose maksimumi ditën paraardhëse. Unë nuk kam pasur asnjë dijeni për prezencën e tij në atë drekë, pasi unë jam paraqitur në atë drekë menjëherë pas pune. Me ungjin jam takuar si me çdo person tjetër në atë drekë-festë, duke mbajtur edhe një distancë, të cilën ma impononte detyra ime si gjyqtar. Unë për asnjë moment nuk jam shkëputur nga rrethi i personave të tjerë për të pasur një kontakt më të gjatë me të. Fotografia që ju administroni, nuk tregon asgjë më shumë se, ajo është shkrepur në një ambient festiv me shumë njerëz, familjarë me njëri-tjetrin. Kërkoj që kjo të merret parasysh si një rrethanë lehtësuese, bazuar në nenin 38§5, germa ‘ç’, të ligjit nr. 84/2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’ (takimi rastësor me një person të krimit të organizuar në prezencën e shumë njerëzve dhe ku magjistrati nuk ka patur dijeni për prezencën e tij në atë takim).

Së katërti, Komisioni në jurisprudencën e tij (çështja e subjektit të rivlerësimit S. H.) ka kërkuar që ky kontakt i papërshtatshëm me njerëz të krimit të organizuar të jetë i vazhdueshëm. Kjo nënkupton që takimet e zyrtarit me këta persona të jenë të provuar më shumë se, dy herë. Në rastin tim, Komisioni nuk disponon asnjë provë tjetër përveç takimit të prillit të vitit 2021, për një takim me ungjin tim. Jo vetëm Komisioni nuk disponon një provë të tillë, por edhe se është e vërtetë që një takim i tillë i dytë nuk ka ndodhur. Për të mos thënë që kontaktet telefonike apo dhuratat e transaksionet bankare janë tërësisht inekzistente. Në çdo rrethanë, unë kërkoj të merren tabulatet e numrave të mi të telefonit prej vitit 2011 (vit kur jam kthyer në Shqipëri) të dy numrave të mi të telefonit të përdorur prej meje, me qëllim verifikimin nëse kam qoftë edhe një kontakt të vetëm me ungjin tim, prej vitit 2019 (moment kur ndaj tij ka filluar procedimi penal) e në vijim. Numrat e mi të kontaktit prej atij viti kanë qenë: \*\*\* dhe \*\*\*. Këtë kërkesë e bazoj në neni 80§1 të Kodit të Procedurave Administrative .

*Së pesti, në lidhje me kontaktin e papërshtatshëm, subjekti ka bërë analogji me një qëndrim të mbajtur po nga ana e tij në një vendimmarrje në vitin 2019<sup>49</sup> duke argumentuar se: 'Sipas meje si gjyqtar në atë çështje, kur kontakti i papërshtatshëm është në rrethin e personave me lidhje gjaku, ai prezumohet se ekziston; në këtë moment, zyrtari duhet të tregohet i kujdesshëm në eliminimin e tyre sa më shumë deri mundësisht në zerimin e tyre. Ndërsa, te lidhja e krushqisë apo shoqërisë, kontakti i papërshtatshëm është 'një zgjedhje'. Kjo pasi zyrtari, me vullnet të plotë tregon interes për të krijuar një marrëdhënie me një person të kimit të organizuar dhe qëndruar bashkë me të, duke thyer kështu edhe normat ndaluuese të punës së tij. Në këndvështrimin tim, kjo e dyta është disafish më e rëndë se kontakti i papërshtatshëm midis lidhjes së gjakut. Kjo pasi, zyrtari publik nuk e zgjedh të afërmin e tij, i cili ka probleme me ligjin, por duhet t'i shmanget sa më shumë atij. Duke u rikthyer në çështjen konkrete, unë ungjin tim nuk e kam zgjedhur me vullnet të plotë për të patur kontakte me të, por e kam pranuar atë si një jo të mirë, të cilën duhet ta shmang me çdo mjet të arsyeshëm dhe që besoj që deri tani ia kam arritur.*

*Së gjashti, ndaj ungjit tim ende nuk është marrë një vendim gjyqësor përfundimtar për dënimin e tij penalisht apo jo dhe çështja po pret radhën për t'u gjykuar. Nga informacionet të dhëna nëpërmjet familjarëve të mi, rezulton se, çështja e tij pritet të mbyllet së shpejti (janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare) dhe mbi Kodin e Procedurës Penale Italiane rëndon parimi për prezumimin e pafajësisë. Kjo do të thotë, që pavarësisht shijes së keqe që lë procedimi penal i nisur ndaj tij dhe vepra penale për të cilën akuzohet, ai ende konsiderohet, sipas ligjit italian, por edhe atij shqiptar, si një person i pafajshëm. Për më tepër, nga informacioni që keni kërkuar me letërporosi si ndaj organeve italiane, ashtu edhe atyre shqiptare, rezulton se, ai është i padënuar ndonjëherë dhe as nuk ka indicie se është përfshirë në kryerjen e ndonjë krimi dhe aq më pak të kimit të organizuar (shkresat të hartuara nga Ministri i Drejtësisë Italiane, Ministri i Drejtësisë Shqiptare apo edhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve e vërtetojnë një gjë të tillë).*

*Së shtati, nga informacionet e marra nga familjarët e mi, rezulton se i akuzuari për bashkëpunëtor me të në kryerjen e veprës penale, shtetasi B. K. është shpallur i pafajshëm (dispozitivi i vendimit të nënshkruar nga gjyqtari A. G. bashkëlidhur), me arsyen se nuk e ka kryer faktin penal (non aver commesso il fatto), forma më e lartë e pafajësisë; sipas të afërmit tim, për aq kohë sa personit të lidhur në akuzën penal është dhënë një vendim pafajësie, ai pret po të njëjtën gjë edhe ndaj tij (vendim pafajësie).*

*Së teti, vlerësoj se unë nuk mund të konsiderohem se kam kontakte të papërshtatshme. Kjo për arsyet se në momentin e përpilimit të formularit të dekriminalizimit të hartuar prej meje në vitin 2015-2016 dhe të depozituar pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë apo edhe pranë DSIK-së, në përputhje me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015 'Për garantimin e integritetit të personave të që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike' dhe nenit 35 të ligjit nr. 84/2016, i afërmi im ka qenë i padënuar dhe madje as i proceduar penalisht dhe, si i tillë, vazhdon të jetë deri tani. Kjo do të thotë që unë i kam përpiluar këto shkresa me vërtetësi dhe ndershmëri, duke mos tentuar asnjëherë për të fshehur diçka të tillë. Për më tepër, unë ju kam njoftuar vetë i pari për procedimin penal të regjistruar nga autoritetet italiane, përpara se, ju të kishit ndonjë informacion konkret për procedimin penal të ungjit tim. Ftoj që kjo qasje ime ndershmërie ndaj KPK të vlerësohet pozitivisht në dhënien e vendimit përfundimtar.*

*Për sa parashtrova më sipër, vlerësoj se i afërmi im nuk mund të konsiderohet kontakt i papërshtatshëm me mua për arsye se: (i) nuk ka qenë i dënuar në momentin e përpilimit të deklaratave nga ana ime, sipas ligjit nr. 138/2015 dhe ligjit nr. 84/2016; (ii) i afërmi im nuk është dënuar ende për veprën penale të akuzuar me një vendim gjyqësor përfundimtar dhe aq*

<sup>49</sup>Shihni shpjegimet e dhëna nga subjekti në datën 9.6.2022.

*më pak me një vendim gjyqësor të formës së prerë; (iii) në Kodin e Procedurës Penale Italiane rëndon parimi i prezumimit të pafajësisë dhe si e tillë, i afërmi im duhet të konsiderohet i pafajshëm deri në momentin kur ai të deklarohet ndryshe me vendim gjyqësor të formës së prerë; (iv) bashkëpunëtori eventual në kryerjen e veprës penale sipas organit akuzator është liruar nga akuza me arsyen se nuk e ka kryer faktin (non aver commesso il fatto), forma më e lartë e pafajësisë, (v) vepra penale për të cilën ai akuzohet nuk është ‘trafikim i lëndëve narkotike’, por vepra e thjeshtë e kryerjes së veprës penale ‘prodhimit dhe shitjes së veprës penale’, pasi lënda e paligjshme e konstatuar nuk ka pasur destinacion eksportimin apo importimin e saj drejt një shteti tjetër përveç atij italian; si dhe (vi) kjo veprë penale, si ajo “prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike”, si ajo e “trafikimit të lëndëve narkotike” nuk parashikohet si krim i organizuar në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, i cili sanksionon kompetencën lëndore të GjKKO-së*

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

9.11 Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, për të kryer procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

9.12 Në lidhje me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për verifikimin e tabulateve telefonike, Komisioni, në seancën e datës 15.6.2022, i njoftoi subjektit se e vlerëson si të panevojshme kryerjen e këtij verifikimi.

9.13 Komisioni vlerëson se pavarësisht se xhaxhai i subjektit konsiderohet një person i përfshirë në krimin e organizuar, nën dritën e pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 84/2016, nenit 283 të Kodit Penal dhe pika 1/c, e nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, ka qenë i proceduar për kryerjen e veprës penale në vitin 2019 dhe, për rrjedhojë, nuk ekzistonin kushtet që subjekti ta kishte deklaruar këtë kontakt në deklaratën për kontrollin e figurës në vitin 2017.

Gjithashtu, Komisioni nuk arriti të provojë ekzistencën e kontakteve të subjektit me xhaxhain e tij, në vazhdimësi.

Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit arriti të provojë bindshëm se kontakti me xhaxhain e tij ka qenë thjesht rastësor dhe, për më tepër, në një event me njerëz të afërt, familjarë, çka e bën të pashmangshëm kontaktin apo edhe shkrepjen e një fotografie, këto në prani edhe të të afërmeve të tjerë.

**Në një vlerësim përfundimtar, në lidhje me kriterin e figurës, Komisioni arrin në përfundimin se prevalojnë rrethanat lehtësuese të parashikuara në pikën 5, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit Bevis Shehaj arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.**

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**10.** Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- a) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja;
- b) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- c) denoncimet e paraqitura në Komision.

### **C/1 Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

10.1 Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se Formulari i Vetëdeklarimit paraqitet i plotësuar sipas shtojcës së ligjit. Rubrikat janë plotësuar me saktësi, me shkrim të qartë e të lexueshëm. Formulari është nënshkruar rregullisht në çdo faqe.

### **C/2 Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

10.2 Subjekti i rivlerësimit ka depozituar tri dokumente ligjore, të llojit vendim gjyqësor. Të tri vendimet e përzgjedhura janë dhënë në vitin 2016. Këto vendime përshkruhen dhe analizohen më poshtë:

**Dokumenti 1.** Vendimi gjyqësor civil nr. \*\*\*, datë 29.6.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çështja civile me nr. regj. them. \*\*\*, datë 8.3.2016. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur “pranimin pjesërisht të padisë”. Në përmbajtje të vendimit nuk ka të dhëna, nëse ndaj tij është ushtruar ankim nga palët në gjykatat më të larta dhe, nëse po, si kanë vendosur ato.

**Dokumenti 2.** Vendimi gjyqësor civil nr. \*\*\*, datë 11.7.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çështja civile me nr. regj. them. \*\*\*. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 11.7.2016, ka vendosur “pranimin pjesërisht të padisë”. Në përmbajtje të vendimit të mësipërm nuk ka të dhëna, nëse ndaj tij është ushtruar ankim nga palët në gjykatat më të larta dhe, nëse po, si kanë vendosur ato.

**Dokumenti 3.** Vendimi gjyqësor civil nr. \*\*\*, datë 22.2.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çështja civile me nr. regj. them. \*\*\*, datë regjistrimi 27.1.2016. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur “pranimin e kërkesës me kërkuar B. B. dhe S. B.”. Rezultoi se vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët.

Të tri vendimet paraqiten të standardizuar në drejtim të organizimit formal dhe të strukturës.

**Komisioni vëren se, bazuar në raportin e KLGJ-së dhe pas analizimit të tri dokumenteve nga Komisioni, nuk konstatohen problematika në lidhje me kriterin profesional.**

### **C/3 Përshkrimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short**

10.3 Nga shortimi janë përzgjedhur pesë dosjet në vijim:

**Dosja 1.** Çështja penale nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 11.3.2016 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurës R. M., e akuzuar nga Prokuroria e Rrethit Tiranë për kryerjen e veprës penale “vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, e parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, çështje e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.4.2016.

Rezultoi se vendimi i mësipërm, ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga asnjëra palë.

**Dosja 2.** Çështja penale nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë regjistrimi 25.3.2016, në ngarkim të të pandehurit A. I., i akuzuar nga Prokuroria e Rrethit Tiranë për kryerjen e veprës penale

“vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, e parashikuar nga neni 137/1 i K.Penal, çështje e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.06.2016.

Rezultoi se vendimi i mësipërm është ankimuar nga i pandehuri në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke kërkuar “dënimin e tij me kohën e paraburgimit”. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.7.2017, ka vendosur: “lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 21.6.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

**Dosja 3.** Çështja civile nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 21.1.2016 regjistrimi. Kjo çështje është e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.2.2016. Në përfundim të gjykimit, subjekti ka vendosur: “pranimin e padisë.” Vendimi i mësipërm nuk është ankimuar nga palët dhe ka marrë formë të prerë.

**Dosja 4.** Çështja civile nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 1.2.2016 regjistrimi. Kjo çështje është përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.4.2016. Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtar i vetëm. Subjekti në përfundim të gjykimit ka vendosur “të miratojë aktmarrëveshjen e lidhur midis palëve për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me pajtim përpara noterit publik M. V. me nr. \*\*\*, datë 18.4.2016”.

Rezultoi se vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët.

**Dosja 5.** Kërkesa penale nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 17.5.2016 regjistrimi, që i përket kërkuarit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “të vleftësohet i ligjshëm arresti në flagrancë i shtetases V. D. A.. Vendosja e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues: “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, ndaj të arrestuarës V. D. A., e dyshuar për kryerje të veprës penale “veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, vepër e parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal. Kjo çështje është përfunduar me vendimin përfundimtar nr. \*\*\*, datë 18.5.2016.

Në përfundim të gjykimit, subjekti ka vendosur “pranimin e kërkesave të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetases V. D. A., e dyshuar për kryerjen e veprës penale ‘veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës’, të parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal. Caktimin e masës së sigurimit personal ‘detyrim paraqitje në policinë gjyqësore’ ndaj shtetases V. A., të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji”.

Rezultoi se vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët.

**Komisioni vëren se, bazuar në raportin e hartuar nga KLGJ-ja dhe pas analizimit të dokumentacionit nga Komisioni, në pesë dosjet e shortuara, nuk u konstatuan problematika referuar kriterit profesional.**

#### **C/4 Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së**

10.4 Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se z. Bevis Shehaj ka përfunduar studimet në degën “Drejtësi”, pranë Universitetit të \*\*\*, Poloni, në datën 20.4.2011 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, në vitin 2016.

Me dekretin nr. \*\*\*, datë 20.11.2015, të Presidentit të Republikës, është emëruar për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.2.2017, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është emëruar Gjyqtar në Gjykatën në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrijë detyrën.

Gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për subjektin nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e ish-KLD-së.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për subjektin përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton që ndaj tij të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

### **C/5 Analiza e gjetjeve sipas KLGJ-së.**

10.5 Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit:

- i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti;
- ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short;
- iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLGJ.

Subjekti i rivlerësimit ka marrë një vlerësim pozitiv nga ana e KLGJ-së, pas analizës profesionale të kryer për tri dosjet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe pesë dosjet e shortuara, në lidhje me:

**Aftësitë profesionale**, ku përfshihen dhe janë analizuar: (a) njohuritë ligjore; dhe (b) arsyetimi ligjor.

**Aftësitë organizative**, ku përfshihen dhe janë analizuar: (a) aftësia për të përballuar ngarkesën në punë; (b) aftësia për të kryer procedurat gjyqësore; dhe (c) aftësia për të administruar dosjet.

**Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**, ku përfshihen dhe janë analizuar: (a) etika në punë; (b) integriteti; dhe (c) paanësia.

**Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**, ku përfshihen dhe janë analizuar: (a) aftësitë e komunikimit; (b) aftësia për të bashkëpunuar; dhe (c) gatishmëria për t'u angazhuar.

### **C/6 Denoncimet/ankesat nga publiku**

Ndaj subjektit të rivlerësimit janë depozituar denoncime/ankesa nga publiku, si vijon:

#### **10.6 Denoncimi i avokat A. G.<sup>50</sup>**

Denoncuesi pretendon se:

- Subjekti duhej të kishte dhënë dorëheqje, sipas nenit 72/6 të Kodit të Procedurës Civile, pasi ka qenë në klasë me të paditurën E. B..
- E ka marrë njoftimin për mospranimin e padisë në datën 10.1.2019 dhe nuk kishte dijeni që do të gjykohej nga subjekti, pasi do të kishte bërë kërkesë për përjashtim.
- Subjekti nuk duhej të kishte vendosur gjobë ndaj tij, pasi pretendon se përcaktimi i bërë nga gjyqtarja në pikën 17 të pjesës arsyetuese të vendimit nr. \*\*\*, datë 30.10.2018, se përfaqësuesi *manifeston papërgjegjshmëri* është fyerje publike, pasi është marrë në telefon nga babai i klientes, i cili i ka thënë se është faji i tij që janë kthyer aktet, pasi ishte i papërgjegjshëm.
- Subjekti ka gabuar, ku ka thënë në vendim se ankimi nuk i pezullon veprimet për ekzekutimin e gjobës.

10.6.1 Komisioni, në lidhje me këtë denoncim, administroi dosjen gjyqësore<sup>51</sup> të vendimit nr. \*\*\*, datë 5.12.2018. Nga analizimi i dosjes gjyqësore rezultoi se:

**a.** Në datën 27.11.2018, av. A. G. ka paraqitur kërkesëpadi me të paditur: E. B., gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me palë të treta Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminim, etj., me objekt: dëmshpërblim dëmi për shkak të

<sup>50</sup>Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2019.

<sup>51</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2021, e Gjykatës Administrative të Apelit.

fyerjes së rëndë. Paditësi në padi pretendon se e paditura ka fyer dhe ka shpifur sikur ai ka manifestuar një papërgjegjshmëri në përgatitjen e kërkespadiës.

Nga verifikimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 30.10.2018, të gjyqtarës E. B., në pikën 17 të këtij vendimit shkruhet: “*Në rast se të metat e kërkesë padisë janë të një natyre tërësisht të dukshme dhe që manifestojnë një papërgjegjshmëri të përfaqësuesit të paditësit (avokatit të zgjedhur)...*”.

**b.** Subjekti e ka marrë në dorëzim dosjen gjyqësore në datën 5.12.2018. Në po të njëjtën datë, subjekti ka mbajtur procesverbal për dokumentimin e veprimeve përgatitore, duke vendosur mospranimin e padisë, pasi nuk evidentohet interesi legjitim për ngritjen e padisë, si dhe ka gjobitur paditësin me një gjobë prej 100.000 lekësh, si pasojë e ngritjes së një padie abuzive.

10.6.2 Për sa më sipër, nga Komisioni është konstatuar se subjekti nuk ka argumentuar se përse jemi përpara një padie abuzive, sipas parashikimeve të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile.

Për këtë konstatim, subjektin të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.6.3 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka shpjeguar se kjo padi është vlerësuar prej tij si abuzive, pasi pala paditëse ka ngritur padi ndaj gjyqtarës për vendime gjyqësore, vlefshmëria apo ligjshmëria e tyre nuk ishin shqyrtuar ende nga gjykatat e më të larta, sikundër mund të ishte Gjykata e Apelit Vlorë. Subjekti shpjegon se është dakord për paditë kundër gjyqtarëve apo prokurorëve, por vetëm atëherë, kur vendimet e tyre ndryshohen apo prishen nga gjykatat e më të larta. Subjekti i konsideron këto padi si abuzive, pasi ka qenë vetë subjekti i padive të tilla, ku zyra avokatie apo avokatë të ndryshëm, me qëllim përzgjedhjen e gjyqtarëve, qëndrimet e të cilëve përputhen më mirë me interesat e tyre, ngrenë padi fiktive apo kallëzime penale të rreme pranë prokurorive kundrejt gjyqtarëve dhe prokurorëve<sup>52</sup>.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.6.4 Komisioni vëren se subjekti e konsideron abuzive këtë padi, pasi vendimi nuk kishte marrë formë të prerë, si dhe ka qenë vetë subjekti i padive të tilla. Deklarimi i subjektit se ka qenë vetë subjekti i padive të tilla duket sikur ai ka paragjykuar çështjen e z. A. G.. Gjithashtu, fakti që vendimi nuk kishte marrë formë të prerë, nuk e bën padinë abuzive pasi z. A. G. në padinë e paraqitur prej tij ankohej për një shprehje të vendosur në vendim dhe jo për themelin e vendimit. Gjykatat më të larta gjykojnë themelin e çështjes dhe jo argumentin e saj.

Komisioni vlerëson se analiza ligjore e përdorur në vendimin e marrë prej subjektit, demonstroi dobësi të tij në drejtim të aspektit të njohurive mbi ligjin, si dhe në aspektin e arsytimit ligjor, në lidhje me cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, në kuptim të pikës 2, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016

**c.** Në lidhje me pretendimin e denoncuesit për heqjen dorë të subjektit për shkak të konfliktit të interesit, Komisioni konstaton se subjekti ka qenë në të njëjtën kurs me znj. E. B., në Shkollën e Magjistraturës, ku dhe janë diplomuar në vitin 2016.

Në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, parashikohet se: “*Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: 1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim; 2,3,4,5,6 në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie*”.

<sup>52</sup>Për detaje shihni prapësimet e subjektit të datës 28.2.2022.



10.6.5 Komisioni ka konstatuar se në kushtet, kur subjekti ka qenë në një klasë prej 11 vetash me të paditurën për një periudhë 3-vjeçare, duket sikur e ka marrë vendimin në kushtet e konfliktit të interesit.

Për këtë konstatim, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.6.6 Subjekti, në prapësimet e tij, ka shpjeguar se në lidhje me pyetjen se, përse subjekti nuk ka parashtruar dorëheqjen, ndër të tjera, argumenton se gjatë ushtrimit të profesionit, ka parashtruar dorëheqjen në të paktën 6 raste, ku palë kanë qenë shokët e tij të gjimnazit apo miq aktualë, me të cilët ka raporte miqësie jo shumë të ngushtë<sup>53</sup>. Subjekti depozitoi kërkesat për heqje dorë dhe, për të gjitha këto raste, kërkesa e tij për heqje dorë nga gjykimi nuk është pranuar (kërkesat bashkëlidhur). Ndosht përpara këtyre kushteve, subjekti ka vlerësuar se kjo kërkesë edhe nëse do të ishte paraqitur prej tij, nën hijen e qëndrimeve të mësipërme, do të rrëzohej.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.6.7 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.

**d.** Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se subjekti ka gabuar kur ka deklaruar në vendim se ankimi nuk e pezullon veprimet për ekzekutimin e gjobës.

Në pikën 3 të dispozitivit të vendimit, subjekti shprehet se dispozitivi numër dy i këtij vendimi (që është gjoba) të ekzekutohet drejtpërdrejt nga përmbartuesi gjyqësor privat ose shtetëror pa u pajisur më parë me urdhër ekzekutimi në përputhje me nenin 511/2 të Kodit të Procedurës Civile. Në pikën 4 të dispozitivit të vendimit, subjekti shprehet se ankimi kundër vendimit gjyqësor nuk pezullon veprimet përmbartimore për ekzekutimin e gjobës.

Komisioni konstaton se gjoba ndaj ankuesit është vënë në zbatim të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: *“1. Gjykata, në çdo shkallë të gjykimit, kur konstaton se palët ose përfaqësuesit e tyre me vetëdije paraqesin padi, ankime, kërkesa ose pretendime abuzive ose të përsëritura dhe me keqdashje ose kur kërkojnë qëllimisht të zvarrisin gjykimin, ose kur konstatohet se palët ose përfaqësuesit e tyre kanë fshehur ose shtrembëruar me keqbesim ose faj të rëndë, fakte dhe rrethana të rëndësishme që lidhen me çështjen, urdhëron me vendimin që jepet në përfundim të gjykimit, përveç kur në këtë Kod parashikohet ndryshe, gjobitjen e përgjegjësit në shumën nga 50.000 deri në 100.000 lekë. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas rregullave për vendimet përfundimtare ose jopërfundimtare, në varësi të llojit të vendimit që i jep fund gjykimit përkatës”.*

Në nenin 511, paragrafi 2, të Kodit të Procedurës Civile, parashikohet se: *“Nuk lëshohet urdhër ekzekutimi për vendimin e sigurimit të padisë dhe për gjobat e dhëna nga gjykata, vendimet për marrjen e detyrueshme të provës, vendimin në pjesën që urdhëron shpenzimet gjyqësore, si dhe vendimet civile të gjykatës, të dhëna për ekzekutim të përkohshëm, të cilat ekzekutohen drejtpërdrejt nga shërbimi përmbartimor, pas njoftimit të vendimit”.*

Në kreun IV të Kodit të Procedurës Civile me emërtim “gjobat”, në nenet 165-168 parashikohen rastet kur gjykata vendos gjoba, vendimi i cili bazuar në nenin 169 është i formës së prerë dhe nuk lejohet ankim.

<sup>53</sup>Për detaje shihni prapësimet e subjektit të datës 28.2.2022.

Në interpretim të dispozitave të mësipërme neni 511, paragrafi 2, aplikohet në rastet e parashikuara nga nenet 165-168 të Kodit të Procedurës Civile dhe jo në rastet e parashikuara nga neni 34 i këtij kodi.

10.6.8 Komisioni ka konstatuar se, për sa më sipër, duket se subjekti ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e neni 34 dhe 511/2 të Kodit të Procedurës Civile, duke vendosur që gjoba të ekzekutohet drejtpërdrejt nga përmbaruesi gjyqësor privat ose shtetëror pa u pajisur më parë me urdhër ekzekutimi në përputhje me nenin 511/2 të Kodit të Procedurës Civile.

Për këtë konstatim, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.6.9 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se arsyeja se përse kjo gjobë duhet të vendosej menjëherë në ekzekutim është e sanksionuar në neni 511/2 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas kësaj dispozite ligjore, gjobat e vendosur nga gjykata nuk kanë nevojë për të nxjerrë urdhër ekzekutimi dhe ekzekutohen menjëherë. Për aq kohë sa kjo gjobë është vendosur nga ai si gjyqtar, gjatë shqyrtimit të një çështje gjyqësore, ajo duhet të ekzekutohet menjëherë. Kjo dispozitë ligjore është e qartë dhe nuk ka nevojë për interpretim të mëtejshëm. Nga ana tjetër, gjykatat administrative, gjatë nxjerrjes së vendimeve të tyre, qoftë edhe përfundimtare, nuk nxjerrin urdhër ekzekutimi. Ato e përcaktojnë në dispozitivin e vendimit përfundimtar mënyrën dhe afatin e ekzekutimit. Ky është një sanksionim, i cili rrjedhë nga germa “b”, e neni 41/1, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.6.10 Shpjegimi i subjektit lidhet me bindjen e brendshme të tij dhe mënyra e arsyetimit dhe, për rrjedhojë, shpjegimet e tij janë bindëse, pasi Komisioni nuk mund të vlerësojë bindjen e subjektit dhe mënyrën e interpretimit të ligjit. Por, ky argumentim i subjektit do të konsiderohet nga Komisioni në vlerësimin e denoncimit të shtetasit S. M..

### **10.7 Denoncim i shtetasve A. S. dhe M. S.<sup>54</sup>**

Denoncuesit ankohen se:

- subjekti është treguar i njëanshëm dhe i paaftë për të shqyrtuar çështjen, duke pretenduar se në asnjë nga seancat nuk ka marrë pjesë avokatura e shtetit;
- subjekti nuk ka marrë në konsideratë provat dhe kërkesat e paraqitura nga ana e tyre;
- pretendojnë se kanë kërkuar ekspert, por subjekti nuk ka pranuar, si dhe e ka zbardhur vendimin tej afatit 15-ditor.

10.7.1 Komisioni, në lidhje me këtë denoncim, administroi dosjen gjyqësore<sup>55</sup> të vendimit nr. \*\*\*, datë 23.1.2019. Nga analizimi i dosjes gjyqësore rezultoi se:

i) Në datën 20.9.2018, paditësit A. S. dhe M. S. kanë paraqitur kërkesëpadi me objekt: dëmshpërblim pasuror dhe jo pasuror për shkatërrim prone për shkak të dhënies së lejes ndërtimore të jashtëligjshme.

Në këtë padi ato pretendojnë se leja e lëshuar nga Bashkia Vlorë është e pavlefshme, si dhe abuzive, pasi nuk është kërkuar një marrëveshje paraprake mes kufitarëve dhe nuk e kanë parë në vend objektin. Ato pretendojnë se leja e dhënë nga bashkia është leje për një punim të ri dhe jo leje për rikonstruksion dhe shtesë kati. Si pasojë e kësaj leje, për shkak të ndërtimeve të kryera, paditësve i është cenuar prona duke iu shkaktuar dëmtime.

<sup>54</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2019.

<sup>55</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2021, nga Gjykata Administrative e Apelit.

ii) Bazuar në procesverbalin e seancës së datës 13.11.2018, rezulton se subjekti ka vendosur të caktojë një ekspert të pavarur inxhinier ndërtimi, pasi çmon se për konstatimin dhe për sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim kërkohen njohuri të posaçme në fushat e inxhinierisë duke i caktuar atij edhe detyrat përkatëse.

Në datën 14.11.2018 paditësit kanë paraqitur me shkrim pyetjet për ekspertin.

iii) Bazuar në procesverbalin e datës 14.12.2018, rezulton se subjekti ka vendosur të revokojë vendimin për thirrjen e ekspertëve hartograf, psikolog dhe vlerësuar dëmsh në shëndet.

iv) Subjekti, në datën 23.10.2019, ka vendosur rrëzimin e padisë.

10.7.2 Komisioni, nga hetimi administrativ, ka konstatuar se:

- Është e paqartë se pse subjekti ka revokuar vendimin për thirrjen e ekspertit inxhinier ndërtimi, ndërkohë që në vendimin e datës 13.11.2018 subjekti ka caktuar këtë ekspert, pasi për konstatimin dhe për sqarimin e fakteve, që kanë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim kërkoheshin njohuri të posaçme në fushat e inxhinierisë.
- Është e paqartë se si ka marrë vendim subjekti, ku ndërkohë sipas vendimit të tij të datës 14.11.2018, për konstatimin dhe për sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen, në gjykim kërkohen njohuri të posaçme në fushat e inxhinierisë.
- Të gjithë procesverbalet e seancave nuk janë të nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit detyrim ligjor i parashikuar nga neni 118 i Kodit të Procedurës Civile.
- Komisioni kërkon që subjekti të depozitojë dokumentacion që e ka zbardhur në kohë vendimin nr. \*\*\*, datë 23.1.2019.

Për konstatimet e mësipërme, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegimet përkatëse.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.7.3 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *Së pari*, thirrja e ekspertëve të ndryshëm në gjykim është ekskluzivitet i disponimit të gjykatës, kur kjo e fundit konstaton se për sqarimin e fakteve, të cilat lidhen me mosmarrëveshjen në gjykim, kërkohen njohuri të posaçme në fushën e shkencës. Palët mund të propozojnë thirrjen e një eksperti, por kjo nuk është detyrueshmëri për gjykatën, e cila vetëm kur bindet për domosdoshmërinë e opinionit të tij, cakton një të tillë. Ky vendim merret nga gjyqtari, me anë të nxjerrjen së një vendimi të ndërmjetëm, bazuar në nenin 125 të Kodit të Procedurës Civile.

Duke u rikthyer tek çështja konkrete, subjekti vendosi t'i rrëzojë padinë palës paditëse, pasi ai më parë nuk kishte kërkuar paligjshmërinë apo pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ. Për aq kohë sa ky akt administrativ (*dhënie leje ndërtimi*) nuk kundërshtohet për ligjshmërinë e tij pranë organit më të lartë administrativ apo gjykatën kompetente, ai duhet të konsiderohet plotësisht i ligjshëm, në përputhje me parimin e ligjshmërisë së aktit administrativ, sanksionuar në nenet 4 dhe 107 të Kodit të Procedurës Administrative.

Për më shumë për këtë qëndrim, subjekti referon paragrafin 11-13 të vendimit gjyqësor (*vendimi gjyqësor bashkëlidhur*). Si rrjedhim, duke lexuar edhe njëherë pretendimet e subjekteve paditëse në kërkesëpadi, si dhe pasi ka marrë përgjigjen e tyre verbale për pyetjet që subjekti parashtrroi për këtë problematikë në proces, pasi ata nuk përfaqësoheshin me avokat në gjykim, vendosi të revokojë vendimin e caktimit të ekspertes inxhinier ndërtimi, pasi pala paditëse nuk kërkonte shfuqizimin apo pavlefshmërinë e lejes së ndërtimit, por vetëm dëmshpërblim (*kjo e konfirmuar nga vetë ata edhe pas pyetjes time gjatë shqyrtimit gjyqësor; procesverbal me regjistrim audio*). Dëmshpërblim për një akt administrativ ende në fuqi e i ligjshëm nuk mund të jepet dhe, si rrjedhim, padia duhej të rrëzohej.

*Së dyti*, në lidhje me pyetjen se, përse nuk është nënshkruar procesverbali, subjekti shpjegon se koncepti i procesverbalit gjyqësor rregullohet në nenin 118 dhe 118/1, të Kodit të Procedurës Civile. Sipas këtyre dispozitave ligjore, procesverbali gjyqësor ndahet në dy lloje: (i) procesverbali nëpërmjet regjistrimit *audio* apo *audioviziv*; dhe (ii) procesverbal me shtypshkrim apo dorëshkrim (procesverbali tradicional). Tek rasti i parë, mund të merret vetëm në transkript të seancës audio, por që në çdo rrethanë, ky transkript nuk duhet të barasvlerësohet me procesverbalin dhe jodetyrimisht duhet të jetë i detajuar, sikundër mund të ishte procesverbali i mbajtur në shtypshkrim apo dorëshkrim. Kjo pasi procesverbali është vetë regjistrimi *audio* apo *video*. Transkriptet që kryhen nga sekretaria gjyqësore të një procesverbalit *audio* nuk merr formën e procesverbalit, por vetëm të shënimeve, pasi procesverbali në vetvete është regjistrimi *audio* apo *video*. Kjo është arsyeja se, përse ky procesverbal nuk nënshkruhet nga subjekti si gjyqtar apo edhe prej shumicës dërmuese të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë<sup>56</sup>.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.7.4 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se në lidhje me mosnënshkrimin e procesverbalit të seancave nga subjekti, për sa kohë nga sqarimet e tij duket se ai të gjitha seancat i ka kryer me sistem *audio*, vlerëson se nuk ka qenë detyrim ligjor mbajtja e një procesverbalit në formë të shkruar dhe, për rrjedhojë, pavarësisht mangësisë që është konstatuar në procesverbal, ajo nuk mund t'i ngarkohet si mangësi profesionale subjektit.

10.7.5 Në lidhje me pjesën tjetër të rezultatit të hetimit, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse. Ka qenë vetë subjekti që ka vendosur thirrjen e ekspertit, pasi sipas subjektit për konstatimin dhe për sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim kërkoheshin njohuri të posaçme në fushat e inxhinierisë. Në këtë kushte për Komisionin ka mbetur e paqartë se ku është mbështetur subjekti në rrëzimin e padisë në mungesë të një akti për sqarimin e fakteve që kishin lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim për të cilat kërkoheshin njohuri të posaçme në fushat e inxhinierisë.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti, në këtë rast, ka shfaqur mangësi në kriterin e aftësive organizative, sipas nenin 74/3 të ligjit nr. 96/2016, pasi nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale, si dhe mangësi në kriterin e aspektit të arsyetimit ligjor, sipas nenit 72/3, pasi ka marrë një vendim pa u sqaruar faktet që kishin lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim, për të cilat kërkoheshin njohuri të posaçme në fushat e inxhinierisë.

### **10.8 Denoncim i studios ligjore “\*\*\*”<sup>57</sup>**

Në ankimin e saj pretendohet se subjekti, në padinë me palë paditëse z. P. B., ka quajtur të ligjshme akte që rezultojnë se janë bërë nga një person që ka ndërruar jetë.

10.8.1 Komisioni, në lidhje me këtë denoncim, administroi dosjen gjyqësore<sup>58</sup> të vendimit nr. \*\*\*, datë 14.5.2019. Nga analizimi i dosjes gjyqësore rezulton se:

Nga paditësi është ngritur padia me objekt:

- goditje për falsitet të akteve;
- konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve;
- rregullimin e pasojave të pavlefshmërisë.

Subjekti, me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.5.2009, ka vendosur rrëzimin e padisë duke argumentuar se *nuk jemi përpara pavlefshmërisë absolute dhe se paditësi për sa kohë pretendon se shkaku kryesor i pavlefshmërisë së regjistrimit pranë ZVRPP-së Vlorë është*

<sup>56</sup>Shihni prapësimet e subjektit, datë 28.2.2022.

<sup>57</sup>Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2019.

<sup>58</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2021, nga Gjykata Administrative e Apelit.

*titulli, ai duhet të ngrejë padi kundrejt subjektit të paditur në një gjykatë me juridiksion të përgjithshëm gjyqësor.*

10.8.2 Komisioni, gjatë hetimit, ka konstatuar se:

- Nga verifikimi i vendimit gjyqësor rezulton se subjekti nuk ka trajtuar dhe nuk është shprehur në vendim në lidhje me objektin e parë të kërkesëpadsisë, atë të goditjes për falsitet të akteve.
- Komisioni konstaton se të gjitha procesverbalet e seancave nuk janë të nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, detyrim ligjor i parashikuar nga neni 118 i Kodit të Procedurës Civile.

Për konstatimet e mësipërme subjektit iu kërkuan shpjegimet përkatëse.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.8.3 Subjekti i rivlerësimit në prapësime, ndër të tjera, ka shpjeguar se subjekti paditës, pavarësisht se në pjesën hyrëse të kërkesëpadsisë së hartuar prej tij ka parashtruar kërkimin për falsitet të dokumenteve të personave të tretë, të cilët kanë regjistruar pronën në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme, gjatë artikulumit të kërkimeve në pjesën arsyetuese të kërkesëpadsisë, nuk kanë kërkuar falsitetin e dokumenteve, por pavlefshmërinë absolute të tyre. Kjo është arsyeja që në kërkimin e tyre, pala paditëse, e cila përfaqësohej në gjykim nga një zyrë avokatie, nuk ka parashtruar kërkimin për thirrjen e një eksperti grafik apo kriminalistik për të provuar falsitetin e dokumenteve. Nga praktika e tij si gjyqtar, avokatët shpesh e ngatërrojnë konceptin e pavlefshmërisë absolute me atë të falsitetit, duke i bërë bashkë në një këto koncepte të pavarura juridike. Subjekti, në identifikimin e thelbit të padisë në rastin konkret, i është referuar metodologjisë së parashikuar në vendimin unifikues nr. 3, datë 29.3.2012, të Gjykatës së Lartë për identifikimin e objektit të padisë dhe shkakut ligjor të saj.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadija në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimit e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadsisë.

Subjekti shpjegon se mosmarrja në shqyrtim e kërkimit për falsitetin e dokumenteve nuk është një “harresë” e gjykatës, por një veprim i posaçëm i subjektit për të mos e arsyetuar si falsitet, për aq kohë që të gjitha pretendimet e subjektit paditës çonin në kërkimin për konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të aktit administrativ, regjistrim prone. Këtë qëndrim e përforcon qëndrimi i palës paditëse gjatë shqyrtimit gjyqësor, i cili nuk artikuloi asnjëherë të vetme prova apo mjete për kërkimin e provës, të cilat do ta lidhnin kërkimin e tij me falsitetin e dokumenteve (thirrja e ekspertëve, këqyrja, pohimi gjyqësor i palëve etj.) për të treguar se realisht kërkoni një gjë të tillë.

Sakaq, edhe nëse do të ishte një “harresë” nga ana subjektit në mosarsyetimin e këtij pretendimi të ngritur nga pala paditëse, GJEDNJ-ja (Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut), në më shumë se një herë, ka mbajtur qëndrimin se vërtetë detyra e gjyqtarit është të mirarsyetojë vendimet, por kjo nuk do të thotë që ai të shprehet me detaje ndaj çdo pretendimi të ngritur nga palët në gjykim.

Nën dritën e jurisprudencës së mësipërme subjekti ka vlerësuar se mosdhënia e argumenteve të posaçme për këtë pjesë të kërkimit, duke qenë se te vendimi i themelit ka parashtruar tri arsye serioze se përse duhet të rrëzohet padia (lexoni paragrafët 12.1-12.3) dhe arsyet ish-in të qarta se përse kërkesëpadija duhet të rrëzohej, qoftë edhe për ekonomi gjyqësore nuk ka vlerësuar të marrë në shqyrtim këtë kërkim<sup>59</sup>.

<sup>59</sup>Për detaje shihni prapësimet e subjektit të datës 28.2.2022.

Subjekti sqaron se në lidhje me mosnënshkrimin e shënimeve, të cilat Komisioni i konsideron si procesverbale, kur seancat janë mbajtur me procesverbal regjistrim audio, duhet të lexohet paragrafi i mësipërm, kur i është dhënë përgjigje të njëjtës pyetje për ankesën e shtetasve A. dhe M. S.

### Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

10.8.4 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se ato nuk janë bindëse. Subjekti kishte detyrimin ligjor që për sa kohë në objektin e padisë ishte edhe goditja për falsitet ai qoftë dhe formalisht duhej të shprehej në lidhje me këtë objekt të padisë.

Komisioni vlerëson se analiza ligjore e përdorur në vendimin e marrë prej subjektit demonstroi dobësi të tij në drejtim të aspektit të arsytimit ligjor, në kuptim të pikës 2, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, pasi nuk ka argumentuar rrëzimin e padisë në lidhje me goditjen për falsitet të akteve.

### 10.9 Denoncimi i shtetasit B. K.<sup>60</sup>

Denoncuesi pretendon për vendim të padrejtë të subjektit, duke deklaruar se i ka përgjysmuar dëmshpërblimin e kërkuar, nuk ka njohur kamatëvonesat, si dhe i ka thënë avokatit se ka kaluar afati.

Komisioni, në lidhje me këtë denoncim, administroi dosjen gjyqësore<sup>61</sup> të vendimit nr. \*\*\*, datë 7.11.2018. Nga analizimi i dosjes gjyqësore rezulton se:

- nga denoncuesi është ngritur padia me objekt dëmshpërblim dëmi, si dhe pagimi i kamatëvonesave mbi shumën e dëmshpërblimit;
- subjekti, në datën 7.11.2018, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë.

Në pjesën arsyetuese të vendimit subjekti argumenton se: *“Gjykata, bazuar dhe në nenin 493<sup>62</sup> të Kodit Civil, vendosi të mos i njohë fajësinë ekskluzive veprimeve të organit publik, Spitali Rajonal B.. Kjo pasi subjekti paditës vuante nga një sëmundje mendore, e llojit epilepsi, e cila së bashku me veprimet me faj në formën e neglizhencës të mjekëve të Spitalit Rajonal B. kanë pasjellë humbjen e jetës së të ndjerit. Si rrjedhim gjykata vlerëson se vlera e dëmshpërblimit duhet të jetë minimale”*.

Baza ligjore e përdorur nga subjekti në argumentimin e caktimit të vlerës minimale të dëmshpërblimit ka lidhje me mosekzekutimin e detyrimeve dhe efektit të tyre, ndërkohë padia e gjykuar nga subjekti është një padi që lidhet me detyrimet që lindin nga shkaktimi i dëmit. Pra, në rastin në fjalë, i ndjeri nuk ka qenë në cilësinë e kreditorit dhe Spitali Rajonal B., në cilësinë e debitorit për të qenë në kushtet e nenit 493 të Kodit Civil, pasi midis tyre nuk ka pasur një detyrim të lindur. Detyrimi ka lindur vetëm pas ndodhjes së faktit juridik të vdekjes së të ndjerit dhe si pasojë e mosveprimeve ose veprimeve të Spitalit Rajonal B., i cili ka shkaktuar dëmin.

10.9.1 Për sa më sipër, nga Komisioni, është konstatuar se:

- Subjekti është referuar në një dispozitë të Kodit Civil, që nuk lidhet me objektin e gjykimit.
- Subjekti nuk ka argumentuar ndikimin e sëmundjes mendore të epilepsisë së të ndjerit në shkaktimin e vdekjes së tij.

<sup>60</sup>Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 25.6.2021.

<sup>61</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2021, nga Gjykata Administrative e Apelit.

<sup>62</sup>Kur dëmi i ardhur nga mosekzekutimi i detyrimit është shkaktuar ose është shtuar edhe nga veprimet ose mosveprimet me faj të kreditorit, ose kur ky nuk ka treguar kujdesin e duhur për pakësimin e këtij dëmi, gjykata sipas rastit mund të pakësojë shumën e shpërblimit të dëmit ose të shkarkojë krejtësisht debitorin nga detyrimi për shpërblimin e tij.

- Subjekti nuk ka trajtuar në vendim objektin e padisë në lidhje me kamatëvonesat.
- Për rrjedhojë duket se subjekti nuk ka argumentuar vendimin nr. \*\*\*, datë 7.11.2018.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.9.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësime, ka shpjeguar se: *Së pari*, në lidhje me kërkimin e mësipërm, pala paditëse i është drejtuar disa herë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (në vijim ILD) dhe ky institucion ka marrë vendimin për arkivimin e çështjes, pasi ndaj saj është ushtruar ankimi në gjykatë dhe, si e tillë, këto pretendime mund të zgjidhen gjyqësisht. Sipas ILD-së, ky organ nuk mund të shqyrtojë në themel vendimet e gjykatave (vendimet e ILD-së bashkëlidhur).

*Së dyti*, në lidhje me konstatimin se subjekti, si gjyqtar, i është referuar një dispozite ligjore, e cila nuk duhet të gjejë aplikim, pasi e ka lexuar me vëmendje edhe njëherë vendimin, nuk ka konstatuar një gjë të tillë.

*Së treti*, në lidhje me pyetjen se përse nuk është trajtuar kërkimi për kamatat ligjore, subjekti shpjegon se mosdhënia e kamatave ligjore nuk vinte si rezultat i ndonjë harrese nga ana e tij, pasi në përputhje me nenin 493 të Kodit Civil e ka konsideruar viktimën si fenomen risku të lartë në ardhjen e dëmit. Këtë qëndrim e mban edhe duke iu referuar vendimit penal të formës së prerë dhe të aktekspertimit të bërë për llogari të asaj çështjeje. Sipas këtij vendimi dhe aktekspertimit, i ndjeri ishte prekur nga epilepsia që prej lindjes së tij, një sëmundje kjo e rëndë mendore dhe në ambientet e spitalit kishte ardhur në gjendje të rëndë shëndetësore. Si rrjedhim, subjekti ka dhënë si masë shpërblimi masën minimale të caktuar nga ekspertët (ka pasur raste të tjera në gjykim që edhe këtë vlerë e ka ulur kur ka konstatuar se viktimja ka ndikuar në ardhjen e dëmit), duke mos i njohur vlerën maksimale të dëmit sipas ekspertëve, si dhe kamatat ligjore. Këtë qëndrim e ka mbajtur edhe në raste të tjera (vendimet bashkëlidhur: R. S.; Spitali Rajonal B.; A. D. etj., Spitali Rajonal V. etj.).

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.9.3 Komisioni vëren se subjekti i referohet nenit 493<sup>63</sup> të Kodit Civil, i cili rregullon marrëdhëniet civile midis debitorit dhe kreditorit, ndërsa në rastin në fjalë kjo dispozitë nuk gjen zbatim, pasi i ndjeri nuk mund të konsiderohet si kreditor dhe aq më tepër të ngarkohet me përgjegjësi për vdekjen e tij. Ndërkohë, në lidhje me kamatat, subjekti kishte detyrimin ligjor për t'u shprehur në padi. Komisioni vlerëson se analiza ligjore e përdorur në vendimin e marrë prej subjektit, demonstroi dobësi të tij në drejtim të aspektit të njohurive mbi ligjin dhe të aspektit të arsytimit ligjor, në kuptim të pikave 2 dhe 3, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, pasi nuk ka argumentuar plotësisht vendimin, duke mostrajtuar objektin e padisë në lidhje me kamatëvonesat, si dhe i është referuar nenit 493 të Kodit Civil, i cili nuk gjen aplikim në rastin e padisë, e cila është një padi që lidhet me detyrimet që lindin nga shkaktimi i dëmit në bazë të nenit 625 të Kodit Civil.

---

<sup>63</sup>Kur dëmi i ardhur nga mosekzekutimi i detyrimit është shkaktuar ose është shtuar edhe nga veprimet ose mosveprimet me faj të kreditorit, ose kur ky nuk ka treguar kujdesin e duhur për pakësimin e këtij dëmi, gjykata sipas rastit mund të pakësojë shumën e shpërblimit të dëmit ose të shkarkojë krejtësisht debitorin nga detyrimi për shpërblimin e tij.

## 10.10 Denoncim i shtetasit A. H.<sup>64</sup>

Denoncuesi pretendon se subjekti ka dhënë vendim të padrejtë, duke pretenduar se: (a) gjykata shprehet në vendim se ai së bashku me personin e tretë në gjykim kanë aplikuar për leje ndërtimi në Bashkinë Lushnjë, por diçka e tillë është e pavërtetë; (b) gjykata analizon gabim termat pasuri *mëmë* dhe *bijë*. Pasuria *mëmë* nuk ka asnjë lidhje ligjore me ndërtimin në fazën e karabinasë. Ky term përdoret për kartelën e pasurisë që zyra e regjistrimit çel në momentin kur investitori depoziton pranë saj të gjithë dokumentacionin ligjor të kërkuar. Pasi ZVRPP-ja verifikon se cili është investitori dhe e kujt është leja e ndërtimit, çel kartelën e pasurisë *mëmë*. Pas aktit të kolaudimit krijohen kartelat e pasurisë për secilin apartament dhe me krijimin kartelave të pasurive *bija*, shkrihet kartela e pasurisë *mëmë*.

10.10.1 Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë dhe të depozitojë dokumentacionin përkatës lidhur me veprimtarinë procedurale të ndjekur prej tij, prej regjistrimit të kërkesëpadisë dhe deri në vendimmarrjen përkatëse, ku përfshihet edhe njoftimi i palëve.

### Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

10.10.2 Subjekti, në prapësime, ndër të tjera, ka shpjeguar se *së pari*, në lidhje me kërkimin e mësipërm, z. A. H. i është drejtuar ILD-së dhe ky institucion ka marrë vendimin për arkivimin e çështjes, pasi ndaj çështjes është ushtruar ankim në gjykatën e mëlartme dhe, si e tillë, këto pretendime mund të zgjidhen gjyqësisht (vendimet e ILD-së bashkëlidhur). Kundër këtij vendimi të ILD-së, z. A. H. ka ushtruar përsëri ankim në KLGJ dhe ky organ ka rrëzuar kërkesën e ankuesit, duke lënë në fuqi vendimin e ILD-së për arkivimin e çështjes.

*Së dyti*, subjekti deklaron se po bashkëlidh gjithë procesverbalin audio të transkriptuar (shënimet e sekretares) nga seanca e parë gjyqësore deri në seancën e fundit, kur ka shpallur vendimin përfundimtar. Të gjitha seancat gjyqësore janë zhvilluar në regjistrim audio. Të gjitha çështjet që prej datës kur është emëruar përfundimisht gjyqtar (shkurt 2017) janë zhvilluar të gjitha në seanca me regjistrim audio dhe për të qenë sa më transparente edhe ndaj publikut. Subjekti ka thirrur si person të tretë z. A. R., bazuar në nenet 125 dhe 193 të Kodit të Procedurës Civile, pasi ai ishte individi, i cili kishte realisht mosmarrëveshjen me subjektin paditës. E ka thirrur atë kryesisht si person i tretë, duke pasur në vëmendje jurisprudencën e gjykatave më të larta, të cilat prishnin dhe kthenin çështjet për rigjykim, kur për paditë kundër ish ZVRPP-ve nuk thirreshin në gjykim personat që kishin regjistruar pronën më parë në regjistrat e pasurive të paluajtshme apo prona e tyre krijonte mbivendosje me pronën e palës paditëse në gjykim. Për pjesën tjetër se përse e ka rrëzuar padinë, subjekti ka bashkëlidhur vendimin gjyqësor përfundimtar.

### Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

10.10.3 Komisioni vëren se subjekti ka paraqitur procesverbalet e seancave, si dhe vendimin përkatës nga ku rezulton se nga ana e subjektit nuk ka pasur shkelje procedurale.

## 10.11 Denoncim i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë<sup>65</sup>

Në ankimin e saj ministria pretendon se një avokat ka hedhur dy padi të ndryshme dy herë. Të dyja paditë i kanë rënë për shqyrtim subjektit të rivlerësimit dhe një subjekti tjetër duke krijuar konfuzion.

Komisioni, pasi analizoi pretendimin e ministrisë, konstaton se ai është i drejtë, por nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi subjekti i rivlerësimit, i cili nuk ka për detyrë funksionale organizimin dhe shortimin e padive.

<sup>64</sup>Denoncimi nr. \*\*\*, datë 25.6.2020.

<sup>65</sup>Denoncimi nr. \*\*\*, datë 18.5.2020.



## 10.12 Denoncim i Bashkisë Roskovec<sup>66</sup>

Denoncimi i Bashkisë Roskovec është në fakt një kërkesë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke kërkuar dhënien e formës së prerë të një vendimi të dhënë nga subjekti. Në këtë kërkesë ato pretendojnë se nuk janë marrë të gjitha masat për njoftimin e palës paditëse të vendimit të dhënë, duke u penguar vijimi i procedurave të mëtejshme.

Bazuar në nenin 128 të Kodit të Procedurës Civile: *“Gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues të çështjes kujdeset dhe kontrollon procesin e njoftimit, që kryhet nga punonjësit e gjykatës së caktuar për realizimin e tij”*.

10.12.1 Komisioni ka kërkuar nga subjekti që të shpjegojë dhe të depozitojë dokumentacionin përkatës lidhur me veprimtarinë procedurale të ndjekur prej tij për njoftimin e vendimit të palës paditëse.

### Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

10.12.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësime ndër të tjera, ka shpjeguar se arsyeja e mosdhënies së vendimit formë të prerë, edhe pse si kohë fizike palës ankuese mund t’i kishte kaluar afati 15-ditor për të ushtruar ankimin nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, është pandemia Covid-19 dhe aktet normative me fuqi të ligjit që kishte nxjerrë Këshilli i Ministrave me qëllim pezullimin e procedurave dhe afateve gjyqësore për shkak të parandalimit të përhapjes së virusit.

Duke u rikthyer te çështja konkrete, vendimi gjyqësor, nëpërmjet të cilit është rrëzuar kërkesëpatria e shtetasve B., është shpallur më 7.2.2020 dhe i është komunikuar palës paditëse më 14.5.2020 (sipas dëftesës së komunikimit me nr. \*\*\* akti, datë 11.3.2020). Ankimi kundrejt këtij vendimi është depozituar pranë kryesekretarisë së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, më 28.5.2020, duke u protokolluar me nr. \*\*\* prot. Nga momenti i shpalljes së vendimit deri sa është komunikuar i arsyetuar palëve në proces ka kaluar një afat rreth tri muaj, por në fuqi ka qenë akti normativ me fuqi të ligjit, nr. 9, datë 25.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, i cili ndalon çdo veprim e afat gjyqësor. Ky fakt tregon se afati 15-ditor nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar është respektuar<sup>67</sup>.

### Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

10.12.3 Komisioni vëren se nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti rezulton se ai ka vonuar zbardhjen e vendimit dhe njoftimin palëve, pasi vendimi është marrë në datën 7.2.2020 dhe njoftimi është bërë në datën 11.3.2020, pra, më shumë se një muaj me vonesë, por duke marrë në konsideratë situatën e krijuar nga pandemia Covid-19 vlerëson se kjo vonesë nuk afekton në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit.

## 10.13 Denoncim i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.<sup>68</sup>

Në denoncim kjo shoqëri pretendon se subjekti ka kryer shkelje të rënda procedurale duke dalë jashtë objektit të gjykimit, si dhe duke mos u shprehur për çdo kërkim të objektit të gjykimit. Gjithashtu është cenuar procesi i rregullt ligjor duke mos u zhvilluar një hetim i plotë dhe i gjithanshëm.

10.13.1 Nga verifikimi i dokumenteve bashkëlidhur denoncimit rezulton se:

1. Në datën 22.10.2019 Spitali Rajonal V. ka paraqitur ankim ndaj veprimeve përmbarimore të përmbaruesit gjyqësor privat I. D. duke kërkuar: *“Ndryshimin e Urdhrit për vendosjen e*

<sup>66</sup>Denoncimi nr. \*\*\*, datë 4.5.2020.

<sup>67</sup>Për detaje shihni prapësimet e subjektit të datës 28.2.2022.

<sup>68</sup>Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2020.

*masës së sekuestros konservative nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2019, për pjesën që i takon vendosjes së sekuestros konservative në llogarinë e thesarit të Spitalit Rajonal V. në masën 146.840 lekë, saktësimin e kësaj shume për SRV në masën 73.420 lekë dhe pezullimin e veprimeve përbarimore ... deri në akordimin e fondit nga ministria ...”.*

2. Në datën 18.11.2019, subjekti i rivlerësimit ka gjykuar këtë ankim duke vendosur pranimin e kërkesëpadisë duke vendosur të deklarojë të pavlefshëm juridikisht vendimin nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2019.

Ky vendim i subjektit nuk përputhet me ankesën e paraqitur nga Spitali Rajonal V., në të cilin nuk pretendohet për pavlefshmëri të vendimeve të përbaruesit, por kërkohet pezullimi i tyre deri në akordimin e fondit, si dhe saktësimi i shumës.

10.13.2 Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk është shprehur mbi atë që i është kërkuar nga ankimesi, por ai ka dalë jashtë objektit të ankesës duke vendosur deklarin e pavlefshëm të vendimit të përbaruesit pa iu kërkuar një gjë e tillë nga ankimesi.

Për konstatimet e mësipërme, subjekti të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.13.3 Subjekti i rivlerësimit, në prapësime, ndër të tjera, ka shpjeguar se në lidhje me pyetjet se subjekti ka dalë jashtë objektit të kërkesë/ankesës nuk rezultoi i tillë. Kjo pasi subjekti kërkuar në atë gjykim kërkonte të shfuqizonte veprimet përbarimore, pasi ato parashikonin një vlerë detyrimi sa dyfishi i debisë reale që kishte organi publik ndaj debitorës. Pasi bëri një punë kërkimore në aktet nënligjore, të cilat përcaktonin vlerën e tarifave të përbaruesve privatë, subjekti ka konstatuar se ato ishin disa herë më të larta. Si rrjedhim, i ka konsideruar si të paligjshme veprimet përbarimore. Nga ana tjetër, aplikimi i tarifave të larta nga përbaruesi nuk ishte i vetmi shkak për shfuqizimin e veprimeve përbarimore, por edhe se ato (veprimet përbarimore) ishin kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr. \*\*\*, datë 4.6.2014, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit” të Këshillit të Ministrave, sipas të cilit detyrimet e organeve publike duhet të shlyhen medoemos në vitin pasardhës (ky qëndrim i subjektit është marrë edhe në të paktën 5 vendime të tjera, ku nuk ishte ky përbarues gjyqësor palë dhe as Spitali Rajonal i V. – bashkëlidhur vendimi nr.\*\*\*, datë 6.10.2020, ASHK Lushnjë kundër përbaruesit privat z. B. M.; vendimi nr. \*\*\*, datë 9.9.2020, ASHK Berat kundër përbaruesit privat A. Z.; vendimi nr.\*\*\*, datë 14.7.2020, AKBPM Tiranë kundër përbaruesit privat z. Y. H.).

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.13.4 Komisioni vëren se subjekti nuk ka argumentuar se cila ka qenë arsyeja që nuk është shprehur për atë që është kërkuar në padi. Ai ka shpjeguar se për sa kohë tarifat përbarimore ishin më të larta sesa detyrimi i kërkuar për t’u paguar, i ka konsideruar të paligjshme veprimet përbarimore. Nga ana e ankuesit në ankim nuk është pretenduar paligjshmëria e veprimeve përbarimore si dhe nuk ka pasur ankim për tarifat për rrjedhojë subjekti nuk mund të dilte përtej asaj që i ishte kërkuar pasi duket sikur ka paragjykuar çështjen. Komisioni vlerëson se në këtë rast subjekti ka dalë jashtë objektit të kërkesë duke vepruar në kundërshtim me nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile ku parashikohet se: “Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”, për rrjedhojë ai ka treguar njohuri, aftësi dhe gjykim të dobët në drejtim të aspektit të njohurive ligjore si dhe të aspektit të arsyetimit ligjor, në kuptim të pikave 2 dhe 3, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, pasi ai ka dalë përtej objektit të padisë.

3. Subjekti, në pjesën argumentuese të vendimit, shprehet se:

- a. Në rastin konkret detyrimi është më i ulët se vlera 100.000 lekë dhe tarifa e aplikuar nga përmbauesi gjyqësor është pothuajse 5 herë më e madhe se ajo e përcaktuar në këtë akt nënligjor. Këto veprime të përmbauesit gjyqësor vijnë tërësisht në kundërshtim me ligjin. Këto veprime kaq flagrante në shkelje të ligjit mund të passjellin procedim disiplinor deri në heqjen e licencës nga Ministria e Drejtësisë për përmbauesin gjyqësor dhe nëse këto veprime janë të përsëritura mund të passjellin edhe përgjegjësi penale.
- b. Gjykata vlerëson se ky vendim gjyqësor i formës së prerë nuk mund të ekzekutohet brenda vitit, të cilit i është dhënë, pasi vinte në kundërshtim flagrant me Udhëzimin nr. \*\*\*, datë 4.6.2014, të Kryeministrit.

Ky argumentim i subjektit nuk përputhet me parashikimet e nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: *“Kundër veprimeve të përmbauesit gjyqësor, të kryera në kundërshtim me procedurat e parashikuara nga ky Kod dhe kundër refuzimit të përmbauesit gjyqësor për të kryer një veprim që ia ngarkon ligji, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin, brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së veprimit ose refuzimit, kur palët kanë qenë të pranishme në kryerjen e veprimit ose kanë qenë thirrur, dhe, në raste të tjera, nga dita që u është njoftuar ose kanë marrë dijeni për veprimin ose refuzimin”.*

10.13.5 Komisioni ka konstatuar se:

- i) Është e paqartë se pse subjekti ka trajtuar tarifën e përmbauesit gjyqësor ku në ankim nga ana e ankimesit nuk ngrihet një pretendim i tillë dhe nuk është as në objektin e kërimit të tij.
- ii) Subjekti, në vendimin e tij, nuk është referuar në asnjë dispozitë të Kodit të Procedurës Civile për të argumentuar se veprimet e përmbauesit ishin në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi, sikundër e kërkon neni 610.

Për konstatimet e mësipërme subjekti iu kërkuan shpjegime.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.13.6 Subjekti i rivlerësimit, në prapësime, ndër të tjera, ka shpjeguar se në lidhje me pyetjen e Komisionit se padia kundër veprimeve përmbaimore do të pranohet vetëm atëherë kur shkelet ndonjë dispozitë e Kodit të Procedurës Civile dhe jo akteve nënligjore, ndan të njëjtin mendim. Tarifat dhe shpenzimet gjyqësore sanksionohen në nenin 102 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas kësaj dispozite ligjore, vlera e këtyre tarifave rregullohen me ligj të veçantë. Ligji i veçantë, i cili normon llojin e tarifave dhe shpenzimeve të tjera përmbaimore private është ai me nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbaimator gjyqësor privat”. Sipas nenit 55 të këtij ligji sanksionohet se masa e tarifës përmbaimore private përcaktohet me udhëzim të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për financat. Sakaq, koncepti i tarifës përmbaimore, si një ndër llojet e tarifave gjyqësore, sanksionohet disa herë në Kodin e Procedurës Civile. Për sa më sipër, subjekti vlerëson se koncepti i tarifës përmbaimore është një koncept juridik i kudondodhur në Kodin e Procedurës Civile. Si rrjedhim, shkelja e vlerës së pagimit të tij nga përmbauesit, ndikon në ligjshmërinë e gjithë veprimeve përmbaimore, pasi kjo tarifë edhe pse mund të parapaguhet vullnetarisht nga kreditori, do të rëndojë mbi debitorin në momentin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Nga ana tjetër, edhe arsyeja e dytë se përse janë shfuqizuar veprimet përmbaimore, edhe pse subjekti posaçërisht i është referuar udhëzimit të Këshillit të Ministrave, po ashtu gjen mbështetje në Kodin e Procedurës Civile në nenin 589 e në vijim, me titull “Ekzekutimi i detyrimeve të holla ndaj institucioneve publike”. Në paragrafin e fundit të kësaj dispozite sanksionohet qartë se Këshilli i Ministrave nxjerr një udhëzim për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore. Si rrjedhim, shkelja e këtij udhëzimi dhe praktikave të vendosura në të, do të thotë shkelje e vetë dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, të cilat kanë deleguar rregullimin e një praktike/situatë të tillë akteve nënligjore.

## Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

Komisioni vëren se subjekti ka referuar nenin 589 të Kodit të Procedurës Civile, duke bërë edhe interpretimin e tij. Për sa kohë ka të bëjë me bindjen e subjektit dhe mënyrën e interpretimit të legjislacionit, Komisioni nuk mund të vlerësojë më tej në lidhje me konstatimet e mësipërme. Ndërsa për sa i përket trajtimit të tarifës përmbartimore, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, pasi nga pala kërkuese nuk është ngritur një pretendim i tillë.

Komisioni vlerëson se, në këtë rast, subjekti ka dalë jashtë objektit të kërkesës duke vepruar në kundërshtim me nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se *grykatar që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet*, për rrjedhojë, ai ka treguar njohuri, aftësi dhe gjykim të dobët në drejtim të aspektit të njohurive ligjore, si dhe të aspektit të arsytimit ligjor, në kuptim të pikave 2 dhe 3, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, pasi ka dalë përtej objektit të padisë.

**4.** Babai i subjektit të rivlerësimit është punonjës pranë këtij spitali me detyrë mjek obstetër gjinekolog.

10.13.7 Nga verifikimi në rrjetin social *Facebook* konstatohet se subjekti i rivlerësimit është shok “*friend*” me drejtoreshën e spitalit, znj. B. M., si dhe ka dhënë pëlqime “*like*” në disa postime të saj në këtë rrjet, duke treguar një marrëdhënie, në dukje shoqërore midis tij dhe saj.

Bazuar në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “*Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: 6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie*”.

10.13.8 Komisioni ka konstatuar se në kushtet ku subjekti ka pasur babain të punësuar pranë Spitalit Rajonal Vlorë, ka një marrëdhënie në dukje shoqërore me drejtoreshën e këtij spitali, si dhe ka marrë një vendim duke pranuar kërkesën ankimore të trajtuar më lart, duket se ai ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në gjykimin e çështjes.

Për konstatimin e mësipërm, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

## Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

10.13.9 Subjekti i rivlerësimit, në prapësime, ndër të tjera, ka shpjeguar se në lidhje me arsyet se përse subjekti si gjyqtar nuk ka parashtruar dorëheqjen nga shqyrtimi i kësaj mosmarrëveshjeje apo edhe mosmarrëveshjeve të tjera ku palë ishte Spitali Rajonal V., për shkak se në këtë spital punonte babai i tij si mjek gjinekolog dhe raportet e ngushta shoqërore që ka me drejtuesen e institucionit, vlerëson se duhet të rrëzohet për arsyet si në vijim.

Nuk është e vërtetë që babai i tij ka shoqëri të ngushtë me drejtuesen e Spitalit Rajonal V., znj. B. M.. Subjekti pranon faktin që kanë qenë ish-kolegë pune, por shoqëri të ngushtë apo edhe miq nuk kanë qenë.

Nuk e ka dhënë dorëheqjen për shkak se nuk është në asnjë nga rastet specifike të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile. Spitali Rajonal V. nuk ka qenë asnjëherë punëdhënësi i tij apo i bashkëshortes së tij (në kohën e nxjerrjes së këtij vendimi subjekti nuk ka qenë i martuar). Si rrjedhim, nuk ka asnjë lloj varësie ligjore apo qoftë edhe emocionale ndaj këtij institucioni në mënyrë të tillë që subjekti të jepte dorëheqjen.

Në dy vendimet e identifikuar si E. Ç. k. Spitali Rajonal V. apo A. D. k. Spitali Rajonal V., në mënyrë të përsëritur subjekti u është drejtuar palëve, duke u thënë se babai i tij është mjek pranë këtij spitali dhe për mundësinë e ndonjë kërkesë për përjashtimin e tij dhe ata të gjithë kanë kërkuar të vazhdohet gjykimi (procesverbal me regjistrim audio). Me qëllim provimin e këtyre pretendimeve, subjekti ka bashkëlidhur transkriptet e seancave gjyqësore.

Me qëllim provimin e argumenteve të tij, subjekti i është referuar dhe dy shkollave të tjera juridike, sikundër është ajo e Kosovës dhe e Polonisë. Si ligji nr. 03-L-006 “Për procedurën kontestimore”, ashtu edhe Kodeks Postepowanie Cywilnego (shqip Kodi i Procedurës Civile Polake) nuk sanksionojnë se gjyqtari duhet të japë dorëheqjen kur palë në gjykim është punëdhënësi i babait të gjyqtarit<sup>69</sup>.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.13.10 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se babai i tij nuk ka marrëdhënie shoqërore me drejtoreshën e spitalit dhe fakti që ai punon në spital nuk përbën konflikt interesi, duke sjellë dhe një vendim të një subjekti tjetër që nuk ka pranuar kërkesën për përjashtim të subjektit. Në lidhje me kërkesën për përjashtim, ajo është refuzuar pasi kërkuuesi nuk kishte paraqitur dokumentacion provues, ndërkohë në rastin konkret rezulton se subjekti ndiqet në rrjete sociale me drejtoreshën e spitalit dhe babai i tij punon pranë këtij spitali.

Subjekti ka depozituar audion e dy çështjeve gjyqësore, nga ku vërtetohet se ai në rastin e z. A. D. ka deklaruar se babai i tij punon në Spitalin Rajonal V., si dhe ka punuar me një nga mjekët e spitalit dhe mund të paraqitet kërkesa për përjashtim.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se ekziston një konflikt në dukje interesi, i cili do të mbahet në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

**5. Komisioni ka vijuar hetimin në lidhje me çështjet e shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit, ku si palë ka qenë edhe Spitali Rajonal V.**

10.13.11 Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.12.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë rezulton se subjekti ka gjykuar duke marrë edhe vendim për 8 çështje gjyqësore<sup>70</sup>, ku si palë në proces është Spitali Rajonal V., ndërkohë tri çështje janë duke u shqyrtuar aktualisht prej tij.

Nga analizimi i këtyre vendimeve Komisioni konstaton se:

Subjekti, në vendimin e datës 1.3.2021, ndër të tjera, ka vendosur:

- sanksionimin me gjobë të drejtueses juridike apo juristes së institucionit Spitali Rajonal V. me inicialet Xh. T., me vlerë 20% të pagës minimale për çdo ditë vonesë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- detyrimin e përmbaruesit gjyqësor për të identifikuar në mënyrë të qartë e të posaçme shtetasen e mësipërme;
- të paralajmërojë drejtuesen e institucionit, znj. B. M., në marrjen e masave për ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit.

Subjekti, në pjesën arsyetuese të vendimit, argumenton: *“Gjykata vlerëson se përmbaruesi duhet të ndërmarrë veprime aktive për identifikimin e drejtueses juridike, e cila identifikohet me inicialet Xh. T. dhe vetëm pasi të jetë identifikuar t’i vendosë gjobë 20% të pagës për çdo ditë vonesë në ekzekutim. Kjo juriste duhet të konsiderohet si përgjegjëse për keqdrejtimin dhe keqkëshillimin e institucionit publik për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor (ka përpiluar dhe konceptuar përgjigjet drejtuar përmbaruesit)”*.

10.13.12 Komisioni, nga analizimi i dispozitivit të mësipërm, ka konstatuar se:

---

<sup>69</sup>Për detaje shihni prapësimet e subjektit të rivlerësimit të datës 28.2.2022.

- Subjekti ka marrë një vendim që nuk përputhet me objektin e padisë, sipas të cilit kërkohet vendosja e sanksioneve për debitorin Spitalin Rajonal V. dhe ku si palë e tretë ishte thirrur drejtuesja e këtij spitali, znj. B. M..
- Subjekti ka marrë një vendim ndaj shtetases Xh. T., pa qenë palë në proces dhe pa i respektuar të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.
- Është e paqartë se në cilën bazë ligjore është bazuar subjekti për të ngarkuar me gjobë znj. Xh. T., ku ajo nuk ka qenë përfaqësuesja ligjore e Spitalit Rajonal V. dhe, për rrjedhojë, nuk ka pasur të drejtë firme, duke mos penguar ekzekutimin e vendimit.
- Është e paqartë se cilat kanë qenë arsyet që subjekti ka ngarkuar me përgjegjësi shtetasen Xh. T., ku përfaqësuese e spitalit (me të drejtë firme dhe vule) dhe, për rrjedhojë, përgjegjëse për çdo veprim apo mosveprim administrativ të tij është drejtoresha e tij, znj. B. M..
- Është e paqartë se ku është bazuar subjekti i rivlerësimit, duke detyruar përmbaruesin gjyqësor për të identifikuar shtetasen Xh. T., pa qenë objekt padie.

Për sa më sipër, bazuar në konstatimet e mësipërme rezulton se vendimi i marrë nga subjekti është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt gjyqësor, i zhvilluar në shkelje të rregullave procedurale duke cenuar edhe të drejtat e palëve.

Për konstatimet e mësipërme subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.13.13 Subjekti, në prapësime, ndër të tjera, ka shpjeguar se në lidhje me pyetjen përse gjykata ka marrë një vendim duke gjobitur personat e tretë, kur në fakt duhet të ishte organi publik, palë debitore Spitali Rajonal V., subjekti ka shpjeguar se ligji nr. 49/2012, rolin aktiv të gjyqarit administrativ e ndan në dy faza: së pari, gjyqtari administrativ, pasi është vendosur në dijeni nga subjektet procedurale të fazës së ekzekutimit, mund të urdhërojë marrjen e masave të ndryshme apo kryerjen e veprimeve të posaçme nga subjekti përgjegjës, i cili pamundëson ekzekutimin e vendimit (neni 66 i ligjit nr. 49/2012); së dyti, në rastet kur subjekti përgjegjës nuk ka përmbushur ekzekutimin e titullit ekzekutiv edhe pas paralajmërimeve të gjyqarit administrativ, ndaj përfaqësuesve të këtij organi mund të merren masa personale sikundër janë gjobat apo masat disiplinore (neni 68 i ligjit nr. 49/2012). Si rrjedhim, masat mund të merren edhe ndaj personave fizikë, punonjës pranë organit publik debitor dhe jo domosdoshmërisht ndaj organit publik, si entitet i pavarur juridik.

Në lidhje me pyetjen përse është marrë vendimi ndaj shtetases Xh. T., kur kjo e fundit nuk ka qenë e thirrur në proces, duke i cenuar kështu të drejtat kushtetuese të saj subjekti ka shpjeguar se thirrja e personave të tretë në gjykim është një praktikë ekskluzive e tij, pasi gjyqtarët e tjerë thërrasin në gjykim vetëm organin publik dhe jo persona të tretë sikundër mund të jenë titullarët e tyre edhe kur vendosin gjobë ndaj titullarit të institucionit (disa vendime bashkëlidhur). Një praktikë e tillë nuk është gjendur në kundërshtim me ligjin nga gjykatat më të larta. Kjo për arsyen se ndaj këtij vendimi lejohet ankimi dhe palët, edhe ata që nuk janë të thirrur në gjykim, kanë të drejtën e ankimit. Si rrjedhim, subjekti vlerëson se të drejtat kushtetuese të shtetases në fjalë nuk i janë cenuar në asnjë lloj mënyrë. Madje, prapësimet procedurale për këtë çështje i ka hartuar pikërisht kjo shtetase, e cila ka qenë edhe përfaqësuese e Spitalit Rajonal V. në gjykimin e themelit (jo në të gjitha seancat).

Në lidhje me pyetjen se përse është gjobitur znj. T., e cila nuk ka pasur cilësinë e përfaqësueses ligjore të organit publik, subjekti shpjegon se përpara se çështja të parashtrohej pranë gjykatës me kërkesë të përmbaruesit, midis tij dhe Spitalit Rajonal V. është mbajtur një korrespondencë,

sipas të cilit përmbaruesi gjyqësor, z. H., kërkonte ekzekutimin e vendimit, ndërsa znj. T. kthente përgjigje duke hartuar dhe përpiluar shkresat (subjekti referon shkresat, të cilat janë administruar në dosjen gjyqësore, ku në fund të shkresës lexohet “konceptoi dhe hartoi znj. Xh. T.”). Të njëjtin qëndrim për rrëzimin e kërkesës së përmbaruesit e ka mbajtur edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor. Duke qenë se debati ishte thellësisht juridik (a ekzekutohet klauzola e ekzekutimit të drejtpërdrejtë edhe pasi është bërë ankim apo jo) dhe drejtuesja e Spitalit Rajonal V. ishte me profesion mjeke, subjekti ka çmuar se me gjobë duhet të dënohej znj. T. dhe të paralajmërohej me gjobë drejtuesja e institucionit.

Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar më tej se në mosekzekutimin e vendimit të përmbaruesit u krijua bindja se mosekzekutimi vinte nga juristja, e cila kishte çuar në një këshillim të gabuar drejtuesen e institucionit të saj. Kjo përfshirje e znj. T. u vërtetua me anë të shkresave që i drejtonte përmbaruesit gjyqësor, ku në fund të shkresës lexohej “hartoi dhe konceptoi znj. Xh. T.”.

Në lidhje me pyetjen se përse subjekti ka detyruar përmbaruesin gjyqësor për të evidentuar gjeneralitetet e sakta të znj. T., subjekti shpjegon se përmbaruesi gjyqësor, pavarësisht se është një subjekt procedural gjyqësor, parashikuar si i tillë në Kodin e Procedurës Civile, mbetet një organ administrativ. Si i tillë, ai ka të gjitha mundësitë për të mbajtur një kontakt me zyrat e gjendjes civile për të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm, në përputhje me nenin 3§2, të ligjit nr. 10129/2009, “Për gjendjen civile”. Ky informacion i marrë prej tij do të ndihmonte përfundimin brenda një kohe sa më të shpejtë të procedurës përmbarimore, e cila udhëhiqet prej tij.

Në lidhje me arsyet e mosheqjes dorë nga gjykimi për shkak se babai i tij punonte në atë kohë si mjek pranë Spitalit Rajonal V., subjekti i referon Komisionit të lexojë argumentet e parashtruar tek ankimi i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k<sup>71</sup>.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.13.14 Komisioni vëren se subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me barrën e provës. Ai nuk është referuar në asnjë bazë ligjore për të justifikuar veprimet e tij procedurale, të cilat kanë cenuar të drejtat e një personi, i cili për më tepër nuk ka qenë palë në proces.

Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar njohuri, aftësi dhe gjykim të dobët në drejtim të aspektit të njohurive ligjore, si dhe të aspektit të arsytimit ligjor, në kuptim të pikave 2 dhe 3, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, pasi ka marrë një vendim tej objektit të padisë, si dhe ka cenuar të drejtat e znj. T. për një proces të rregullt duke e gjobitur pa qenë palë në proces.

Shmangia e gjobitjes së drejtueses së institucionit, sipas parashikimeve të nenit 68 të ligjit nr. 49/2012, marrë për bazë edhe faktin e njohjes me të në rrjetin social *Facebook*, si dhe për faktin se ajo është drejtuese e një institucioni, ku është i punësuar dhe, për rrjedhojë, shfaq marrëdhënie interesi, babai i subjektit, rrit peshën e të konsideruarit si konflikt interesi në dukje të pozitës së subjektit të rivlerësimit me këtë institucion dhe me këtë drejtuese, në proceset gjyqësore ku ai është në rolin e gjyqtarit.

Subjekti ka gjykuar:

- a. Pesë çështje me objekt shpërblim dëmi/shlyerje dëmi, ku si palë e paditur ka qenë Spitali Rajonal V., ku ka vendosur: për një çështje mospranimin për shqyrtim të kërkesëpadisë; për dy çështje pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, duke vendosur si masë dëmshpërblimi gjithmonë vlerën minimale; për një çështje rrëzimin e padisë; për një çështje pranimin e padisë.

---

<sup>71</sup>Për detaje shihni prapësimet e subjektit të rivlerësimit të datës 28.2.2022.

b. Një çështje me objekt kundërshtim urdhri, ku si palë e paditur ka qenë Spitali Rajonal V., duke vendosur kthimin e padisë.

10.13.15 Komisioni ka konstatuar se në kushtet kur subjekti ka pasur babain të punësuar pranë Spitalit Rajonal V., ka një marrëdhënie shoqërore në dukje me drejtoreshën e këtij spitali dhe ka marrë vendime, të cilat favorizojnë Spitalin Rajonal V., duket se subjekti i rivlerësimit ka vendosur në kushtet e konfliktit të interesit të parashikuar nga neni 72 i Kodit të Procedurës Civile.

Për konstatimin e mësipërm, subjektit iu kalua barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

10.13.16 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë pikë, ka dhënë shpjegimet e referuara më lart.

#### 10.14 Denoncim i shtetases A. Q.<sup>72</sup>

Denoncuesja ankohet për vendim të padrejtë të subjektit të rivlerësimit, duke listuar pretendimet e saj dhe bazën ligjore.

10.14.1 Nga verifikimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 18.7.2019, i subjektit të rivlerësimit, rezulton se ka vendosur mospranimin e padisë së paraqitur nga denoncuesja. Në arsyetimin e vendimit subjekti shprehet se: *“Subjekti paditës nuk provoi dot para gjykatës marrëdhënien juridike që i buronin të drejtat dhe interesat e ligjshme të shkelura nga qëndrimet e organit publik. Kjo pasi subjekti paditës dështoi të provonte përpara gjykatës lidhjen e tij juridike me pronën. Subjekti paditës pretendonte se titulli i pronësisë që tregonte lidhjen e tij me pronën, e cila kërkohej të mbrohej sipas tij ishte vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për vërtetimin e faktit juridik të pronës së tij...vendimet gjyqësore të vërtetimit të faktit juridik nuk kanë fuqi detyruese për personat e tretë, të cilët nuk kanë qenë të thirrur në atë proces ... si konkluzion kërkesëpadia drejtuar gjykatës ... duhet të mospranohet, pasi mungon interesi legjitim për ngritjen e padisë dhe pretendimi i kërkesëpadisë është parashkruar”.*

Komisioni nuk mund të analizojnë vendimin e subjektit pasi ai ka argumentuar dhe i përket gjykatave më të larta për të shqyrtuar themelin e çështjes në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e dispozitave ligjore.

10.14.2 Komisioni ka konstatuar se është e paqartë se pse subjekti deklaroi se pretendimi i paditësit është parashkruar ku ai në asnjë pjesë të vendimit nuk trajton parashkrimin.

Komisioni për këtë konstatim i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

#### Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

10.14.3 Subjekti i rivlerësimit, në prapësime dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se arsyeja e mospranimit për shqyrtim të kërkesëpadisë ishte se palës paditëse i mungonte interesi procedural në ngritjen e padisë. I gjithë arsyetimi i subjektit shkante në këtë linjë, përveç paragrafit të fundit të vendimit, ku gabimisht ka shkruar se padia është parashkruar. Ky është thjesht një gabim në shkrim jothelbësor, e cila sipas mendimit të tij nuk ka nevojë as të korrigjohet, sipas nenit 312 të Kodit të Procedurës Civile<sup>73</sup>.

#### Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë bindëse.

<sup>72</sup>Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 27.9.2019.

<sup>73</sup>Neni 312 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: *“Pas shpalljes së vendimit gjykata nuk mund ta anulojë ose ta ndryshojë atë. Ajo, me kërkesën e palëve ose kryesisht, mund të ndreqë në çdo kohë vetëm gabimet e bëra në shkrim ose në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të vendimit”.*



## 10.15 Denoncimi i shoqërisë “\*\*\*”<sup>74</sup>

Nga kjo shoqërie pretendohet se:

- Kërkesëpapia e palës paditëse Ll. Q. nuk rezulton t’i jetë komunikuar rregullisht të paditurit Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas denoncuesit, me shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2021, KKT-ja i ka bërë të ditur gjykatës faktin që është hera e parë që njoftohet për procesin dhe se nuk ka dijeni në lidhje me padinë dhe provat. Subjekti nuk i ka njoftuar as padinë dhe as provat për KKT-në, duke e lënë palën të panjohur për çështjen dhe pa mundësi mbrojtjeje.
- Subjekti nuk ka thirrur si palë të treta blerësit e ndryshëm të apartamenteve.
- Subjekti ka ndërruar vendimin për caktimin e masës së sigurimit. Fillimisht kishte rrëzuar kërkesën dhe, më pas, në përfundim të gjykimit ka vendosur pezullimin e lejes së ndërtimit si masë sigurimi. Nga ana e denoncuesit pretendohet se ky ndryshim i masës nuk është i argumentuar, pasi pala paditëse nuk ka sjellë asnjë provë shtesë.
- Vendimi i datës 3.12.2020 për refuzimin e kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit është zbardhur së bashku me vendimin përfundimtar dhe palëve i është komunikuar vetëm në datat 7 dhe 8 prill 2021 në një kohë që vendimi përfundimtar përfshirë edhe vendosjen e masës së sigurimit është marrë më 17.3.2021.
- Subjekti nuk ka kërkuar në asnjë seancë shpjegime mbi procedurën administrative vendimmarrëse të organit publik dhe as ka kërkuar kryesisht shpjegime nga organi publik mbi procedurën dhe përputhshmërinë e lejes së ndërtimit me kriteret ligjore substanciale dhe procedurale të lëshimit të lejes së ndërtimit.
- Ngrihen dyshime për afera në dhënien e vendimit.

Komisioni ka kërkuar nga subjekti që të shpjegojë dhe të depozitojë dokumentacionin përkatës lidhur me pretendimet e ankuesit dhe me veprimtarinë procedurale të ndjekur prej tij nga njoftimi i palëve deri te njoftimi i vendimeve të ndërmjetme dhe vendimit përfundimtar.

### Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

10.15.1 Subjekti i rivlerësimit, në prapësime, ka bashkëngjitur gjithë procesverbalin audio të transkriptuar (shënimet e sekretares) nga seanca e parë gjyqësore deri në seancën e fundit, kur ka shpallur vendimin përfundimtar.

Subjekti shpjegon se të gjitha seancat gjyqësore janë zhvilluar në regjistrim audio. Të gjitha çështjet e gjykuara prej tij, që prej datës kur është emëruar përfundimisht gjyqtar (shkurt 2017), janë zhvilluar në seanca me regjistrim audio. Subjekti thekson në këtë gjykim se bashkë me vendimin përfundimtar, duke pranuar padinë, ka vendosur të ndryshojë edhe masën e sigurimit të padisë, në përputhje me nenin 207 të Kodit të Procedurës Civile. Arsyet e një qëndrimi të tillë i ka parashtruar në paragrafin 19 të vendimit<sup>75</sup>. Një qëndrim i tillë nga subjekti është

<sup>74</sup>Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2021.

<sup>75</sup>Vendimi nr. \*\*\*, datë 27.3.2021, paragrafi 19: “Së fundi, gjykata vendosi të rindalet edhe tek kërkimi tjetër i kërkesëpadiës, e cila kishte të bënte me sigurimin e padisë, duke pezulluar fuqinë ligjore të aktit administrativ derisa çështja të shqyrtohet në themelin e saj. Gjykata, bazuar në nenin 28§3 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” e mori në shqyrtim këtë pretendim brenda 5 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesëpadiës dhe me vendimin nr. \*\*\* regjistri., datë 3.12.2020, vendosi ta rrëzojë atë. Argumenti kryesor i gjykatës për rrëzimin e një pretendimi të tillë ishte se, nga mossigurimi i padisë, palës paditëse nuk i vinte një dëm i madh dhe i pariparueshëm. Në rrethanat, kur çështja u shqyrtuar në themel nga gjykata dhe asaj iu vërtetua katërcipërisht se, organi publik kishte dhënë një leje ndërtimi në kundërshtim me vullnetin e gjithë bashkëpronarëve të sendit, bazuar në nenin 31 të ligjit nr. 49/2012, me kërkesën e palës paditëse vlerësoi që bashkë me pranimin e pretendimit për shfuqizimin e aktit administrativ, të vendoste që edhe padia të sigurohet, duke pezulluar efektet e vendimit të KKT-së Tiranë. Kjo për shkakun se nga pezullimi i këtij akti administrativ palës paditëse, por edhe personave të tretë (blerës potencial të apartamenteve dhe njësisve të shërbimit, të cilat pritet të ndërrohet së shpejti) mund t’i vijë një dëm i madh e i pariparueshëm, pasi shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., po kryente punime për ngritjen e objektit shumëkatësh dhe pasurit e tjera si apartamente apo njësi shërbimi mund të ishin shumë shpejtë në treg.

zbatuar edhe në vendime të tjera, kur ka vendosur pranimin e padisë, duke shfuqizuar një akt administrativ haptazi në kundërshtim me ligjin (vendimi nr. \*\*\*, datë 1.11.2018, me palë shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. k. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit etj.; vendimi nr. \*\*\*, datë 29.7.2021, me palë F. Ç. etj. k. Bashkia Vlorë – dy vendimet bashkëlidhur).

### Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

10.15.2 Komisioni vëren se subjekti nuk ka depozituar dokumentacionin përkatës, pasi:

- a. Kërkesëpapia e palës paditëse Ll. Q. nuk rezulton t’i jetë komunikuar rregullisht të paditurit Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas denoncuesit me shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2021, KKT-ja i ka bërë të ditur gjykatës faktin që është hera e parë që njoftohet për procesin dhe se nuk ka dijeni në lidhje me padinë dhe provat. Subjekti nuk i ka njoftuar as padinë dhe as provat për KKT-në, duke e lënë palën të panjohur për çështjen dhe pa mundësi mbrojtjeje.
- b. Vendimi i datës 3.12.2020 për refuzimin e kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit është zbardhur së bashku me vendimin përfundimtar dhe palëve i është komunikuar vetëm në datat 7 dhe 8 prill 2021 në një kohë që vendimi përfundimtar, përfshirë edhe vendosjen e masës së sigurimit, është marrë më 17.3.2021.

Nga verifikimi i vendimit të pranimit rezulton se vendimi është marrë në datën 17.3.2021, ndërkohë që i është komunikuar palës në datën 8.4.2021 (sipas dëftesës së komunikimit me nr. \*\*\* Akti, datë 2.4.2021).

Për sa më sipër, Komisioni nuk mund të bëjë një vlerësim të plotë në lidhje me këtë ankesë, pasi subjekti nuk është treguar bashkëpunues duke mos depozituar të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Nëse do t’i referohet pretendimeve të denoncuesit, në lidhje me dy pikat e mësipërme, konstatohet se subjekti mund të ketë cenuar të drejtat e palëve për një proces të rregullt, por që parë në një vlerësim tërësor në lidhje me kriterin profesional, nuk konsiderohet me aq peshë saqë ndaj subjektit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra,

### 10.16 Denoncim i av. B. T.<sup>76</sup>

Denoncuesi pretendon se vendimi i subjektit përmban shkelje të rënda të ligjit procedural dhe për shkak të këtyre shkeljeve është ndikuar edhe në dhënien e vendimit, duke e bërë atë të pavlefshëm. Denoncuesi pretendon se:

- vendimi i gjykatës në faqen 7 bën fjalë për Policinë e Shtetit dhe për gradat;
- subjekti shprehet për çështje që nuk janë në objektin e padisë;
- në pjesë arsyetuese nuk shprehet në lidhje me pikën 3 të kërkesëpadiës;
- gjykata arsyeton se denoncuesit i është komunikuar vendimi për sa kohë ka një kopje, por ky është një arsyetim i gabuar sepse barrën e provës për zbatimin e procedurës e ka pala e paditur, e cila nuk erdhi asnjëherë dhe gjykata nuk mori asnjë masë procedurale ndaj palës;
- gjykata, në faqen 8 të vendimit, arsyeton se ai si kundërvajtës ka refuzuar të firmosë, ndërkohë denoncuesi pretendon se nuk ka qenë fare prezent kur është mbajtur procesverbali;
- vendimi i dhënë nga Dogana Fier është tërësisht i pavlefshëm dhe i bërë në mënyrë abuzive, pasi ai nuk është njoftuar dhe nuk ka dijeni në lidhje me të. Atij nuk i është komunikuar zyrtarisht asnjë vendim deri më sot;
- procesverbali i kontrollit aposterior nuk i është komunikuar zyrtarisht;
- huaja është parashkuar pasi kanë kaluar më shumë se 3 vjet nga momenti i lindjes deri në momentin e ngritjes së padisë.

Në këto rrethana, blerësit potencial të këtyre sendeve do të kishin probleme ligjore me trashëgimtarët e të ndjerit J. Q., të cilët kërkojnë pronësinë e plotë mbi sendin.

<sup>76</sup>Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 7.3.2019.

Komisioni ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë dhe të depozitojë dokumentacionin përkatës lidhur me pretendimet e ankuesit dhe me veprimtarinë procedurale deri në njoftimin e vendimit përfundimtar palëve në gjykim.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.16.1 Subjekti ka bashkëlidhur gjithë procesverbalin audio të transkriptuar (shënimet e sekretares) nga seanca e parë gjyqësore deri në seancën e fundit, kur ka shpallur vendimin përfundimtar. Subjekti sqaron se vendimi përfundimtar ka qenë i formës së prerë, për shkak të vlerës së ulët të shumës monetare të parashikuar në aktin administrativ (nën njëzetfishin e pagës minimale). Baza ligjore për një disponim të tillë ishte neni 45 i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”<sup>77</sup> në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagës minimale”<sup>78</sup>, e cila në atë kohë ishte në vlerën 24.000 lekë.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.16.2 Komisioni vëren se nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti rezulton se nuk konstatohen shkelje në lidhje me këtë çështje.

### **10.17 Denoncim i shtetases Sh. T.<sup>79</sup>**

Denoncuesja pretendon se subjekti nuk ka marrë në konsideratë pronarët e ligjshëm të pronës në dhënien e vendimit, duke sjellë pasoja shumë të rënda.

Nga verifikimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 8.4.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë një interpretim të zgjeruar të kontratës së sipërmarrjes, të së drejtës së pronësisë mbi sendet e paluajtshme dhe të kontratës së huapërdorjes, duke nxjerrë konkluzionet e mëposhtme:

- i. Në faqen 27 të vendimit subjekti shprehet se pavarësisht se në regjistrat e ZVRPP-së Tiranë si pronar njihet ende shoqëria ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., pronar i vërtetë i sendit dhe në momentin e dorëzimit të tij duhet të njihet porositësi, i ndjeri Th. T. Pronësia e tij duhet të njihet në bazë të titullit të pronësisë, e cili në këtë rast është kontrata e sipërmarrjes e lidhur midis tij dhe shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k.
- ii. Subjekti vijon argumentimin duke deklaruar se veprimi juridik i dhënies në huapërdorje të sendit prej familjes së djalit, z. L. T., është kryer verbalisht. Ai shprehet: Gjykata çmon se në rastin konkret midis palëve të të ndjerit Th. T. dhe z. L. T. është lidhur kontratë huapërdorje sipas nenit 901 e vijues të Kodit Civil. Sipas kësaj kontrate, që nuk sanksionin formën shkresore si të domosdoshme në lidhjen e saj, huapërdorësi i jep huamarrësit pa kundërshtim një send me afat të caktuar ose pa afat.

10.17.1 Komisioni, në lidhje me këtë argumentim të subjektit, ka konstatuar se:

- Subjekti nuk mund të trajtonte në këtë vendim, që kishte për objekt zgjidhjen e martesës dhe pasojave të saj, të drejtën e pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme, e cila nuk ishte objekt gjykimi, si dhe cenonte të drejtat e pronarit legjitim të kësaj pasurie, shoqërisë “\*\*\*\*”

---

<sup>77</sup>Neni 45 i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”: “Nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt: a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi; b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi; c) kundërshtimin e aktit administrativ që ka refuzuar dhënien e detyrimit në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi; ç) mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi.”

<sup>78</sup> Botuar në Fletoren Zyrtare nr. \*\*\*, datë 5.5.2017.

<sup>79</sup> \*\*\* datë 20.3.2018.

sh.p.k. Kontrata e sipërmarrjes nuk përbën titull pronësie bazuar në Kodin Civil dhe nuk shërben si një dokument për kalimin e titullit të pronësisë pranë ASHK-së.

- Subjekti nuk mund të njihte pronësinë e z. Th. T. mbi një pasuri të paluajtshme, për sa kohë nuk ishte në objektin e padisë dhe, për më tepër, që i ndjeri kishte ndërruar jetë dhe, për rrjedhojë, të drejtat e kontratës së sipërmarrjes i kishin kaluar trashëgimtarëve të tij.
  - Është e paqartë se në çfarë provash është bazuar subjekti për të vërtetuar faktin se z. L.T. ka lidhur kontratë huapërdorje me z. Th.T..
  - Është e paqartë se ku është bazuar subjekti që pas vdekjes së z. Th. T. kjo kontratë ka vijuar dhe nga trashëgimtarët e tij.
  - Është e paqartë se ku është bazuar subjekti i rivlerësimit që trashëgimtarët e z. T. ia kanë lënë në përdorim apartamentin z. L. T., ndërkohë që denoncuesja është një nga pronarët e këtij apartamenti.
  - Me vendimin e tij duket se subjekti ka cenuar të drejtat e pronësisë së personave të tretë që nuk ishin palë në procesin gjyqësor.
- Për rrjedhojë duket sikur subjekti nuk ka argumentuar vendimin nr. \*\*\*, datë 8.4.2016.

Për konstatimet e mësipërme subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.17.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësime, ndër të tjera, ka shpjeguar se:

Së pari, ndaj vendimit përfundimtar nr. \*\*\*, datë 8.4.2016, nëpërmjet të cilit është vendosur pranimi pjesërisht i kërkesëpadisë dhe pranimi pjesërisht i kundërpadisë dhe kërkohej prej tij shpjegime, palët kanë ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo gjykatë, pasi e rishqyrtoi në themel edhe njëherë këtë çështje, vendosi të linte në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe çështja po pret radhën për t'u gjykuar nga kjo gjykatë. Duke qenë se ky vendim është kthyer në një vendim gjyqësor të formës së prerë, subjekti shpjegon se ndaj tij nuk mund të ngrihen më dyshime apo pretendime për cilësinë e tij, por të respektohet nga të gjithë, duke përfshirë edhe Komisionin, në përputhje me nenin 451/a të Kodit të Procedurës Civile.

Në rastin konkret, subjekti është shprehur vetëm për të drejtën reale të përdorimit, i cili mund të bashkëjetojë me të drejtën reale të pronësisë (pronar mund të jetë znj. Sh. T., por të drejtën e përdorimit për një kohë të caktuar e ka znj. E. T. dhe vajza e tyre e mitur A. T., për një periudhë të caktuar, kundrejt pagesës së qirasë) dhe në asnjë rresht të të gjithë vendimit subjekti nuk është shprehur për të drejtën e pronësisë dhe se kujt duhet t'i takojë ajo. Në lidhje me pyetjen se subjekti i ka njohur pronësinë të ndjerit Th. T., përsëri është e pasaktë. Subjekti deklaroi se nuk ka njohur të drejtën e pronësisë së askujt në atë vendim, por ka analizuar ecurinë e krijimit të pronësisë deri te dhënia e të drejtës së përdorimit të sendit të familja e re "L. dhe E. T.". Në lidhje me pyetjen se si e vërtetoi subjekti ekzistencën e kontratës së huapërdorjes dhe transferimit të saj te trashëgimtarët e të ndjerit Th. T., mban qëndrimin si në vijim. Ekzistenca e kontratës u provua në disa mënyra: (i) adresa zyrtare e familjes "T." derisa u ngrit padia për zgjidhje martesë; (ii) pohimi gjyqësor i palëve gjatë gjykimit, të cilët pranorin pranë Gjykatës se kishin banuar në atë shtëpi derisa kishte filluar dhuna në familje dhe znj. T. ishte larguar bashkë me vajzën e mitur për te prindërit e saj, në përputhje me nenin 281 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile; (iii) vendimet gjyqësore për dhënie urdhër mbrojtjeje, pas dhunës së ushtruar nga z. T.; (iv) mendimi i ekspertës psikologe, e thirrur në gjykim,

posaçërisht nga ana e tij si gjyqtar. Në lidhje me transferimin e detyrimeve dhe të drejtave të kontratës pas vdekjes së njërit prej palëve, vlerëson se ky është një parim bazë në të drejtën civile materiale, ku si parim, të drejtat dhe detyrimet kontraktore transferohen te trashëgimtarët, përveç atyre me natyrë krejtësisht personale. Baza ligjore është neni 692 i Kodit Civil. Në lidhje me pyetjen e Komisionit se “... nga vendimi del e paqartë se si i ndjeri Th. T. i kishte kaluar të drejtën e përdorimit të sendit dhe njëkohësisht znj. E. T. ishte bashkëpronare e sendit...”, subjekti është shprehur qartë në argumentet e mësipërme dhe asnjëherë nuk ka mbajtur qëndrim në vendimin gjyqësor për të drejtën e pronësisë, madje ka rrëzuar çdo pretendim të palëve, të cilat lidheshin me të drejtat e pronësisë (të lexohen nënparagrafët e mësipërm të ankimit të znj. T..

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.17.3 Komisioni, në përfundim, i vlerësoi të mjaftueshme shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se vendimi i subjektit është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, duke u vlerësuar kështu edhe hapat proceduralë të ndërmarrë nga subjekti, krahas analizës së fakteve, rrethanave dhe provave, nuk konstatoi problematika që do të mund të çonin në marrjen e ndonjë mase disiplinore për subjektin e rivlerësimit në lidhje me vlerësimin profesional.

### **❖ Në lidhje me denoncimet e bëra në mediat online**

#### **10.18 Denoncim i shtetasit A. M.<sup>80</sup>**

Shtetasi ka denoncuar publikisht subjektin duke pretenduar se subjekti e ka kërcënuar dhe ka ushtruar presion psikologjik duke e kërcënuar se do t’i vinte gjobë. Denoncuesi pretendon se subjekti ka marrë një vendim të padrejtë duke mos marrë në konsideratë vendimin civil të Gjykatës së Apelit, si dhe nuk ka marrë në konsideratë vendimin e Këshillit të Ministrave, duke e konsideruar kontratën e lidhur midis tij dhe ALUIZNI-t absolutisht të pavlefshme, por që me vendim përfundimtar nuk rezulton të ketë zgjidhur pasojat e pavlefshmërisë.

10.18.1 Komisioni, në lidhje me këtë denoncim, administroi dosjen gjyqësore<sup>81</sup> të vendimit nr.\*\*\*, datë 7.11.2019. Nga analizimi i dosjes gjyqësore rezulton se:

- Në datën 23.5.2011 është lidhur kontrata nr.\*\*\*<sup>82</sup> për kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore me pasurinë nr. \*\*\*, në lagjen “\*\*\*”, Fier, midis Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, qarku Fier dhe M. P. (nëna e shtetasit A. M.). Znj. P. ka paguar edhe shumën 11.270.000 lekë në llogarinë e ALUIZNI-t, në datën 20.5.2011.
- Në datën 10.7.2014 Gjykata Administrative e Shkallës së parë Vlorë, me vendimin nr. \*\*\* ka vendosur rrëzimin e padisë që shtetasja M. P. kishte ngritur kundër ALUIZNI-t me objekt shlyerjeje dëmi si rezultat i moszbatimit të kontratës së mësipërme. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Administrativ.
- Në datën 11.12.2017 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, ka dënuar disa punonjës të ALUIZNI-t për shpërdorim detyre, pasi gjykata ka vlerësuar se kontrata nr. \*\*\* është lidhur në kundërshtim me ligjin. Ky vendim është lënë në fuqi dhe nga Gjykata e Apelit me të vetmin ndryshim që janë shpallur të pafajshëm dy nga pesë të pandehurit.

<sup>80</sup>[https://\\*\\*\\*](https://***)

[https://www.youtube.com\\*\\*\\*](https://www.youtube.com***)

<sup>81</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2021, nga Gjykata Administrative e Apelit.

<sup>82</sup>Në zbatim të VKM-së nr. \*\*\*, datë 17.2.2011.

- Në datën 10.5.2018, me vendimin nr. \*\*\*, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur pranimin e padisë së znj. M. P. për shfuqizimin e aktit administrativ nr. \*\*\*, datë 12.2.2018, urdhër nr. \*\*\*, datë 12.2.2018, “Për prishje objekti”.
- Në datën 7.11.2019, me vendimin nr. \*\*\*, Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur pranimin e padisë së ASHK-së Drejtoria Vendore Fier me objekt deklarimin absolutisht të pavlefshëm të kontratës nr. \*\*\*, datë 23.5.2011. Kjo çështje është shqyrtuar nga tre gjyqtarë, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e kryesuesit (relatorit). Në vendimin e saj gjykata argumenton se për sa kohë ka një vendim penal të formës së prerë, ai është i mjaftueshëm për të provuar që kontrata nr. \*\*\* është absolutisht e pavlefshme.

#### 10.18.2 Komisioni ka konstatuar se:

Vendimi i gjykatës nuk është në përputhje me vendimin unifikues nr. 5, datë 30.10.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku përcaktohet se nuk mund të paraqitet si padi më vete konstatimi i pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik, nëse ky kërkim nuk shoqëron gjykimin e një çështjeje në themel dhe/ose nuk shoqërohet me zgjidhjen e pasojave. Sipas Kolegjeve të Bashkuara në rastin kur padia ka për objekt vetëm deklarimin e pavlefshmërisë absolute ajo nuk mund të ngrihet.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.18.3 Subjekti, në prapësime, ndër të tjera, ka shpjeguar se është e vërtetë që vendimi unifikues me nr. 5, datë 30.12.2012, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë unifikon praktikën gjyqësore, sipas të cilit nuk mund të kërkohej vetëm pavlefshmëria absolute e një veprimi juridik, nëse ai nuk shoqërohet me kërkimin për zgjidhjen e pasojave.

Por, në rastin konkret, gjenden përpara një kontrate administrative dhe jo kontrate civile, sikundër unifikon praktikën Gjykata e Lartë. Ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, germën “c” të nenit 17§1, me titull dispozite “Objekti i padisë”, sanksionon qartë dhe prerë se paditë për konstatimin, absolutisht, të aktit administrativ mund të ngrihen edhe të mëvetësuar, pra të pashoqëruara, detyrimisht, me zgjidhjen e pasojave. Ankesa e z. A. M. duhet të rrëzohet, pasi nuk gjen bazë faktike dhe ligjore<sup>83</sup>.

#### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.18.4 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit pretendon se ligji nr. 49/2012 parashikon ngritjen e padisë për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ. Në çështjen në fjalë nuk kishin të bënin me një akt administrativ, por me një kontratë civile pavarësisht faktit që njëra palë ishte organ shtetëror, për rrjedhojë vendimi unifikues nr. 5, datë 30.12.2012, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjen zbatim. Subjekti pretendon se vendimi unifikues ka dalë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012, si dhe rregullon një marrëdhënie civile. Këto pretendime të subjektit nuk qëndrojnë, pasi vendimi unifikues është i datës 30.10.2012, ndërkohë ligji nr. 49/2012 është miratuar në datën 3.5.2012. Në lidhje me objektin e padisë në rastin e vendimit unifikues, është si më poshtë:

Konstatim i pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes datë 9.12.2003 dhe kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 10.12.2003, lidhur midis palës së paditur Komuna \*\*\* dhe H. Ç..

<sup>83</sup>Për detaje shihni prapësimet e subjektit të rivlerësimit të datës 28.2.2022.

Ndërsa në vendimin objekt vlerësimi është si vijon: deklarimi absolutisht i pavlefshëm i kontratës së shitjes së parcelës ndërtimore (shitje me rezervë e pronës) me nr. \*\*\*, datë 23.5.2011, lidhur midis ish Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit, Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Drejtoria Vendore Fier, në cilësinë e palës shitëse dhe znj. M. P., në cilësinë e palës blerëse; baza ligjore është Kodi Civil. Subjekti e trajton kontratën e shitblerjes si kontratë publike, por ky trajtim i subjektit nuk përputhet me parashikimet e nenit 151 të Kodit të Procedurave Administrative: “Kuptimi i kontratave administrative 1. Kontrata administrative është një marrëveshje nëpërmjet së cilës krijohet, modifikohet apo shuhet një marrëdhënie juridike e së drejtës publike. 2. Kontratat e mëposhtme konsiderohen administrative: (a) sipërmarrjet e punëve publike; (b) prokurimi i punëve publike; (c) prokurimi i shërbimeve publike; (ç) licencimi i lojërave të fatit; (d) kontratat e furnizimit të vazhdueshëm; (dh) kontraktimi i shërbimeve të subjekteve private në rastet e fatkeqësive natyrore.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka zbatuar vendimin unifikues dhe dispozitat përkatëse ligjore që rregullojnë marrëdhënien e pronësisë duke i konfunduar ato me dispozitat ligjore në fushën e kontratave administrative, për rrjedhojë, ai ka treguar njohuri, aftësi dhe gjykim të dobët në drejtim të aspektit të njohurive ligjore dhe të aspektit të arsyetimit ligjor, në kuptim të pikave 2 dhe 3, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, si dhe ka cenuar të drejtat e pronësisë së palëve në proces.

#### 10.19 Në lidhje me masën e sigurimit të dosjes civile nr. \*\*\*, datë 3.12.2018<sup>84</sup>

Në një artikull në median e shkruar pretendohej se banorët e një pallati, pasi kanë hasur në vështirësi për të lëvizur dhe për të hyrë në apartamentet e tyre, i janë drejtuar Gjykatës Administrative Vlorë me katër kërkesëpadi për pezullimin e lejes së ndërtimit. Dy nga këto padi i kanë rënë subjektit, ndërsa dy të tjera subjekteve të tjera. Subjekti ka bërë bashkimin e të katër padive në një të vetme, por nuk kishte njoftuar gjyqtarët e tjerë. Më pas, subjekti ka marrë një vendim kundër banorëve, pa pasur dosjet përpara. 12 minuta më pas, një subjekt tjetër rivlerësimi, i cili nuk ishte njoftuar për këtë vendimmarrje, ka marrë në shqyrtim dosjen që i kishte rënë në short dhe ka vendosur ndryshe nga subjekti.

10.19.1 Komisioni administroi vendimet<sup>85</sup> përkatëse, si dhe dosjen e plotë<sup>86</sup> nga ku rezulton se:

1. Subjekti i rivlerësimit, në datën 4.12.2018, ka vendosur të bashkojë çështjet me nr. \*\*\* akti, \*\*\* akti dhe \*\*\* akti datë regjistrimi 3.12.2018, nën shqyrtimin e gjyqtarëve Bevis Shehaj, G. Xh. dhe K. Dh. në një çështje të vetme, duke iu bashkëlidhur çështjes me nr. \*\*\*. Në dispozitiv deklarohet që ky vendim iu komunikohet gjyqtarëve çështja e të cilëve do të bashkohet me çështjen konkrete.

Subjekti i rivlerësimit, në datën 4.12.2018, menjëherë, pasi ka vendosur bashkimin e çështjeve pa njoftuar gjyqtarët e tjerë, ka marrë për shqyrtim kërkesën për sigurimin e padisë duke vendosur rrëzimin e saj.

Në pjesën arsyetuese të vendimit subjekti shprehet se: *“Gjykata mori në shqyrtim të gjitha aktet shkresore provuese, të cilat ndodhen në dosjen gjyqësore me nr. \*\*\*, regjistri themeltar datë 3.12.2018”.*

*Si përfundim, gjykata çmon se në rastin konkret nuk ndodhemi përpara kushteve të sigurimit të padisë, pasi gjykatës nuk iu vërtetua ekzistenca e një dëmi të madh e të riparueshëm”.*

<sup>84</sup><https://top-channel.tv/> \*\*\*

<sup>85</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.11.2021, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

<sup>86</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.1.2022, e Gjykatës së Lartë.

Subjekti vijon duke argumentuar: “Gjykata vendosi të ndalet edhe te masat që duhet të ndërmerren ndaj subjektit përgjegjës për ngritjen e një padie të tillë abuzive ... Gjykata vlerëson se jemi përpara një padie abuzive, pasi subjektet kërkuese kanë ngritur në të njëjtën ditë 4 kërkesëpadi të hartuara nga i njëjti avokat me objekt dhe shkak të njëjtë me subjekte kërkuese të ndryshme. Gjykata e konsideroi këtë fakt si një kërkesë abuzive, e cila synon përjashtimin e shortimit elektronik në përzgjedhjen e gjyqtarëve, të cilët do të zgjidhnin mosmarrëveshjen. Duke marrë parasysh se pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ushtrojnë detyrën vetëm 4 gjyqtarë ngritja e katër kërkesave, të cilat janë identike ..., ndërsa subjektet kërkuese qëndrojnë në marrëdhënie të posaçme gjinie me njëri-tjetrin bindën gjykatën për paligjshmërinë e kësaj kërkesë me qëllim shmangien e shortimit elektronik ... Vlera e gjobës duhet të jetë ... në vlerën 100.000 lekë”.

2. Bazuar në procesverbalin për zhvillimin e seancës gjyqësore të datës 4.12.2018 subjekti:
  - a. fillimisht ka vendosur bashkimin e padive dhe më pas pa ia njoftuar këtë vendim gjyqtarëve të tjerë ka vijuar me administrimin e provave shkresore, ku deklaroi se aktet e dosjes nr. \*\*\*, me datë regjistrimi 3.12.2018, nuk administrohen për shkak se ndodhen pranë gjyqtarit K. Dh. ndërsa ka administruar gjithë aktet e dosjes nr. \*\*\*, të cilat i kishin rënë për short subjektit G. Xh.;
  - b. më pas, pa ndërprerë seancën, ka vijuar shqyrtimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur rrëzimin e saj.

Ora e përfundimit të seancës në dhomë këshillimi është 09:58.

3. Në datën 4.12.2018, në orën 10:00, subjekti i rivlerësimit K. Dh. ka marrë në shqyrtim çështjen civile me nr. \*\*\*, datë 3.12.2018, për sa i përket kërkesës për sigurimin e objektit të padisë, duke pranuar këtë kërkesë.

4. Në datën 6.12.2018 subjekti G. Xh. që kishte çështjen me nr. \*\*\* akti ka vendosur kalimin e dosjes te subjekti i rivlerësimit, duke mos marrë në shqyrtim kërkesën për sigurimin e padisë.

10.19.2 Komisioni, për sa më sipër, ka konstatuar se:

- Subjekti nuk ka njoftuar në kohë gjyqtarët e tjerë, të cilëve i ishin caktuar me short dy paditë e tjera për të cilat ai kishte vendosur bashkimin e padive.
- Subjekti nuk ka ndërprerë gjykimin për të vijuar me komunikimin e vendimit të bashkimit të këtyre çështjeve nëpërmjet sekretarisë gjyqësore dy gjyqtarëve të tjerë.
- Subjekti ka vijuar me vendimmarrjen pa administruar të gjitha provat, si dhe pa iu njoftuar vendimin e bashkimit subjekteve të tjera të rivlerësimit.

Bazuar në konstatimet e mësipërme rezulton se vendimi i marrë nga subjekti është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt gjyqësor, i zhvilluar në shkelje të rregullave procedurale, duke cenuar edhe të drejtat e palëve pasi ka lejuar shqyrtimin e të njëjtës çështje nga e njëjta gjykatë pas dhënies së vendimit të tij.

Komisioni, për konstatimet e mësipërme, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.19.3 Subjekti i rivlerësimit, në prapësime ndër të tjera, ka shpjeguar se në lidhje me ankimin e z. E. V. etj., të vitit 2018, familjarët e këtij shtetasi i janë drejtuar gjykatës me 4 kërkesa të posaçme “sigurim padie”, brenda të njëjtës ditë. Çështjet janë regjistruar të pavarura nga njëra-tjetra dhe kanë marrë: nr. \*\*\* Akti, datë 3.12.2018 (H. V. dhe L. H.); nr. \*\*\*, datë 3.12.2018 (V. D. dhe P. H.); nr. \*\*\*, datë 3.12.2018 (B. V. dhe E. H.); dhe \*\*\* Akti, datë 3.12.2018 (R.



D. dhe E. V.). Dy çështjet e para (\*\*\*) dhe (\*\*\*) akti) i kanë rënë për shqyrtim gjyqtarit Bevis Shehaj, çështja e tretë për nga radha, me nr. \*\*\* Akti, i ka rënë për shqyrtim gjyqtarës G. Xh. dhe çështja e katërt me nr. \*\*\* Akti i ka rënë për shqyrtim gjyqtarit K. Dh..

Për këtë fakt, gjyqtarët janë njoftuar me shkresë zyrtare nga kryesekretarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2018 (shkresa bashkëlidhur), me lëndë “Vënie në dijeni”.

Instituti i bashkimit dhe veçimit të kërkesëpadive rregullohet në nenin 23 të ligjit nr. 49/2012 dhe në nenin 57 të Kodit të Procedurës Civile. Kështu, nëse disa padi lidhen për nga shkaku apo objekti, ato mund të bashkohen duke u shqyrtuar në një çështje të vetme. Këtë vendim, duhet ta marrë vetëm gjyqtari, çështja e të cilit është regjistruar më parë në kohë. Subjekti thekson se është i pavërtetë fakti që subjekti nuk ka komunikuar me z. K. Dh.. Sekretarja e tij gjyqësore në atë kohë ka qenë znj. N. M., e cila i ka shkuar në zyrë z. K. Dh. dhe znj. G. Xh., duke i thënë se subjekti, si gjyqtari më vjetër i çështjes, ka vendosur të bashkojë kërkesat në një të vetme. Një kërkesë e tillë nuk është pranuar nga gjyqtari K. Dh. për arsye që subjekti nuk i kuptoi. Të njëjtin fakt ia parashtrori edhe atij dhe gjyqtarës tjetër znj. Xh., e cila sapo u njoh me qëndrimin e subjektit, bazuar edhe në shkresën e kryesekretarës, vendosi të dorëzojë dosjen duke e bashkëlidhur me dosjen e subjektit.

Me qëllim provimin e këtyre fakteve, subjekti bashkëlidh shkresën e kryesekretarës, znj. M., vendimin e bashkimit të protokolluar pranë gjykatës dhe nëse ka ende dyshime për sqarimin e këtij fakti, subjekti kërkon të thirret si dëshmitare, nëse Komisioni e çmon të domosdoshme, sekretaret gjyqësore, znj. N. M., e cila asistonte në atë periudhë subjektin si gjyqtar dhe znj. K. P., e cila asistonte gjyqtarin K. Dh. në atë periudhë.

Gjithashtu, kërkon të thirren në cilësinë e dëshmitarit dy gjyqtarët e tjerë, z. K. Dh. dhe znj. G. Xh.. Baza ligjore për një kërkim të tillë nga ana e tij është germa “a”, e nenit 80§1, të Kodit të Procedurave Administrative<sup>87</sup>. Për sa më sipër, vlerëson se ankesa e z. E. V. etj. duhet të rrëzohet, pasi nuk gjen bazë faktike dhe ligjore.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

Komisioni vëren se subjekti pretendon se sekretarja e tij gjyqësore ka njoftuar dy gjyqtarët e tjerë në lidhje me bashkimin e padive. Ky pretendim i subjektit është në nivel deklarativ dhe, për më tepër, nuk është në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe solemnitetin e seancës. Subjekti nuk vuri në dispozicion të Komisionit asnjë dokument për të provuar njoftimin e palëve sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile. Në lidhje me kërkesën e tij për thirrjen si dëshmitarë të dy subjekteve të tjera, Komisioni vlerëson se bazuar në germën “a”, të nenit 49/6, të ligjit nr. 84/2016, marrja e kësaj prove është e panevojshme, pasi fakti që kërkohet të provohet rezulton i provuar me dokumentacionin e administruar gjatë procesit administrativ. Në përfundim, në lidhje me këtë çështje gjyqësore, Komisioni konstaton se vendimi i marrë nga subjekti është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt gjyqësor, i zhvilluar në shkelje të rregullave procedurale, duke cenuar edhe të drejtat e palëve pasi ka lejuar shqyrtimin e të njëjtës çështje nga e njëjta gjykatë pas dhënies së vendimit të tij.

Për sa më sipër, subjekti ka treguar njohuri, aftësi dhe gjykim të dobët në drejtim të aspektit të njohurive ligjore si të aspektit të arsytimit ligjor, në kuptim të pikave 2 dhe 3, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016 dhe në drejtim të aspektit organizativ në kuptim të pikave 1 dhe 3, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, si dhe ka cenuar të drejtat e palëve për një proces të rregullt gjyqësor.

---

<sup>87</sup>Neni 80§1 germa “a” e Kodit të Procedurave Administrative parashikon: “1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik mund: a) të mbledhë deklaratat nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët”.

## **10.20 Komisioni, si pjesë të hetimit, ka administruar kallëzimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë<sup>88</sup>.**

10.20.1 Nga analizimi i kallëzimeve, Komisioni është ndaluar vetëm në ato të dërguara nga subjekti për shkak të vendimeve të marra prej tij si vijon:

- i. Subjekti, në datën 9.6.2020, i ka dërguar shkresë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke deklaruar se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtar Bevis Shehaj shqyrtoi në seancë publike çështjen ... me paditës D. S., i paditur IKMT-ja Tiranë.

Gjykata, pasi përfundoi hetimin gjyqësor, me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.1.2020, ka vendosur të rrëzojë padinë, pasi konstatoi prezencë punimesh që kërkojnë detyrimisht marrjen e një lejeje ndërtimi.

Gjykata vlerëson se një fakt i tillë mund të passjellë përgjegjësi penale për subjektin paditës, por edhe për inspektorët e IVMT-së në Bashkinë Vlorë, të cilët kanë lejuar një ndërtim të tillë për një periudhë të gjatë kohe dhe në mënyrë të përsëritur.

Prokuroria, pasi ka shqyrtuar këtë material, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

- ii. Subjekti, në datën 30.12.2020, i ka dërguar shkresë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke deklaruar se: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me trup gjykues të përbërë nga gjyqtar Bevis Shehaj shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen me kërkues IVMT pranë Bashkisë Vlorë me objekt lëshimin e urdhrin të ekzekutimi, ndaj subjektit fizik A. V..

Kjo ishte shkelje e përsëritur dhe organi publik e ka dënuar administrativisht të paktën 2 herë këtë subjekt dhe ky i fundit nuk merr asnjë masë rregulluese. Nga ana tjetër, inspektorët e IVMT-së e kanë konsideruar këtë ndërtim, i cili është haptazi një ndërtim pa leje, si një lloj punimi pa deklaratë paraprake punimesh, duke e dënuar vetëm me 50.000 €, kur duhet të konsiderohej ndërtim pa leje dhe të dënohej të paktën 500.000 lekë, si dhe duke vendosur prishjen e ndërtimit pa leje.

Për sa më sipër, gjykata vlerëson paraprakisht se mund të ndodhet në rrethanat e kryerjes së një vepre penale, sikurse mund të jetë kryerja e një vepre penale, duke ndërtuar në mënyrë të paligjshme ... apo “shpërdorim detyre” ...

Prokuroria, pasi ka shqyrtuar këtë material, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

10.20.2 Komisioni ka kërkuar nga subjekti që të japë shpjegime në lidhje me këto shkresa dërguar prokurorisë, si dhe të provojë që për çdo çështje të së njëjtës natyrë ka vijuar me të njëjtën praktikë duke i dërguar shkresa prokurorisë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.20.3 Subjekti depozitoi në Komision kallëzime ku vërtetohet e njëjta praktikë si më lart.

**Komisioni vëren se nuk konstaton problematika në lidhje me praktikën e kallëzimeve të bëra nga subjekti pranë organit të prokurorisë.**

### **10.21 Në lidhje me ankimin e shtetasit F. M.**

1. Komisioni ka administruar shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2012, nga KLGJ-ja ku gjendet ankimi i shtetasit F. M., i cili pretendon se:

---

<sup>88</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2021.

Ka paraqitur kërkesëpadi kundër Bashkisë Vlorë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Me shkresën datë 20.3.2020, i është kërkuar nga gjykata të plotësojë të metat e padisë, duke i lënë vetëm dy ditë pune deri më 24.3.2020. Me aktet normative nr. \*\*\*, datë 15.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19” dhe nr. \*\*\*, datë 16.3.2020, është kufizuar lëvizja e lirë, kurse me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.3.2020, të KLGJ-së është vendosur pezullimi i veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.3.2020, të KLGJ-së është urdhëruar vijimi i pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit.

Ankuesi pretendon se i është kërkuar pagesa e taksës së padisë, ndërkohë që sportelet e shërbimit të gjykatës kanë qenë të mbyllura që në datën 10.3.2020.

Në datën 4.5.2020, me vendimin nr. \*\*\*, gjykata ka vendosur kthimin e padisë dhe i është caktuar gjobë në shumën 100.000 lekë për ngritjen e një padie abuzive.

Ankuesi, në lidhje me këtë vendim, pretendon se është dhënë në një kohë që ishte vendosur pezullimi i veprimtarisë gjyqësore. Sipas tij, gjykata, nga njëra anë pretendon se nuk mund të bëhen veprime procedurale bazuar në aktin normativ nr. \*\*\*, ndërkohë nga ana tjetër vendimi i saj konfirmon se janë kryer veprime të tilla, pasi është marrë vendimi për kthimin me të meta në datën 4.5.2020 dhe është kryer njoftimi i dytë për plotësimin e të metave në datën 24.3.2020. Kthimi i padisë me të meta nuk përbën shkak dënimi me gjobë. Dënimin me gjobë gjyqtari e ka mbështetur në nenin 34 të Kodit të Procedurës Civile dhe e ka konsideruar padinë të përsëritur dhe abuzive me arsyetimin se në gjykatë, në rastin e padive që kanë lidhje me leje ndërtimi, paraqiten disa padi me qëllim përzgjedhjen e gjyqtarit, ndërkohë ai pretendon se ka paraqitur vetëm një padi.

Denoncuesi pretendon se subjekti ka vendosur që ankimi kundër vendimit të kthimit të padisë me të meta nuk pezullon veprimet përmbarimore të ekzekutimit të gjobës, duke i cenuar të drejtat e tij.

Pas vendimit për kthimin e padisë ka bërë ankimin ku sërish me shkresën nr. 27.05.2020 i është kërkuar të plotësojë të meta brenda datës 8.6.2020, ndërkohë që shkresa i është komunikuar në datën 9.6.2020. Në këtë shkresë i kërkohej të paguhej tarifa gjyqësore 3.000 lekë për padinë, ndërkohë që atij i ishte kthyer padia.

Në datën 10.6.2020 ka paguar tarifën, por ende nuk i është njoftuar vendimi për pranimin e ankimit.

2. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga ankimuesi konstatohet se:

Në datën 4.5.2020, subjekti, me vendim nr. \*\*\*, ka vendosur kthimin e padisë të ankuesit F. M., duke arsyetuar se: *“Në datën 9.3.2020 Gjykata në Dhomë Këshillimi, pa praninë e palëve mori në shqyrtim paraprak aktet e dosjes gjyqësore dhe konstatoi se padia kishte të meta. Me anë të fletëthirrjes së posaçme dhe shkresës sqaruese bashkëlidhur të datës 9.3.2020 i komunikoi palës paditëse ekzistencën e këtyre të metave, duke i lënë një afat për rregullimin e tyre deri më 24.3.2020. Gjykata u mblodh përsëri në dhomë këshillimi në datë 24.3.2020, por duke marrë parasysh situatën e krijuar nga pandemia botërore Covid-19, gjykata vendosi t’i lërë një afat shtesë të pacaktuar subjektit për të ndrequr të metën e padisë. Në datën 4.5.2020, Gjykata e mbledhur përsëri në Dhomën e Këshillimit, pa praninë e palëve konstatoi se pala paditëse kishte marrë dijeni të rregullt për të metën e padisë dhe nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim procedural për ta korrigjuar atë. Gjykata e konsideron këtë qëndrim të palës paditëse në përputhje me nenin 154/a të Kodit të Procedurës Civile për të kthyer padinë me të meta. Gjykata vendosi të ndalet edhe te hyrja në fuqi e aktit normativ me fuqi të ligjit nr. 9, datë*

25.3.2020. Ky akt normativ ka hyrë në fuqi në datën 25.3.2020. Në rrethana normale çdo afat gjyqësor do të ishte pezulluar prej datës së hyrjes në fuqi të tij, por në rrethana të çështjes konkrete afati për plotësimin e të metës ka përfunduar më 24.3.2020, pra rreth një ditë para se të hynte në fuqi akti normativ. Gjykata vlerëson se gjoba duhet të vendoset ndaj subjektit paditës për ngritjen e një padie abuzive. Abuziviteti me të drejtën për të ngritur padi kristalizohet pasi subjekti paditës nuk ka parapaguar tarifën për regjistrimin e padisë si dhe nuk ka depozituar versionin origjinal ose të njësuar me origjinalin aktin administrativ të kundërshtuar. Vlera e gjobës, duke marrë parasysh veprimet në tërësi të subjektit paditës, duhet të jetë në vlerën 100.000 lekë. Kjo gjobë duhet të jetë në vlerën maksimale të parashikuar në ligj, pasi gjatë viteve të fundit vihet re një përdorim masiv i padive për nxjerrjen e lejes së ndërtimit, pavarësisht se nuk plotësohen kriteret e ligjit. Këto çështje, në pjesën dërmuese të tyre, zgjidhen në shkallë të parë pasi Bashkia Vlorë dhe kryetari i saj nuk i ankimojnë këto vendime duke bërë që leja e ndërtimit të nxirret menjëherë. Duke marrë parasysh se në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ushtrojnë punën e gjyqtarit katër gjyqtarë, tanimë vetëm tre, palët zgjedhin mënyrën për ngritjen e shumë padive, njëkohësisht, me palë shkak ligjor e objekt padie krejt të njëjtë me qëllim përzgjedhjen e gjyqtarit, qëndrimi i të cilit përputhet më mirë me interesin e tyre. Të gjitha këto bindën gjykatën se ndodhemi përpara një padie abuzive”.

10.21.1 Komisioni ka konstatuar se:

- Është e paqartë se në çfarë baze ligjore është mbështetur subjekti kur ka vendosur t'i lërë një afat shtesë të pacaktuar paditësit për të ndrequr të metën e padisë.
- Është e paqartë se cila ka qenë arsyeja që subjekti, në datën 4.5.2020, është mbledhur sërish në Dhomë Këshillimi kur i kishte lënë paditësit një afat të pacaktuar.
- Është e paqartë se pse subjekti i referohet datës 24.3.2020 si datë përfundimtare për plotësimin e të metave, ku ai vetë në këtë datë ka vendosur një afat shtesë për plotësimin e të metave, afat i cili ka qenë i pezulluar në datën 4.5.2020.
- Subjekti ka vendosur kthimin e padisë, ndërkohë që afati për plotësimin e të metave nuk kishte përfunduar, pasi subjekti kishte lënë një afat të pacaktuar dhe së dyti afati në datën 4.5.2020 ka qenë i pezulluar.
- Subjekti nuk ka marrë masa për njoftimin e vendimit të datës 24.3.2020, ku ai kishte caktuar një afat të pacaktuar shtesë për palën paditëse.
- Subjekti nuk rezulton të ketë revokuar vendimin për caktimin e një afati shtesë të pacaktuar për plotësimin e të metave të padisë.
- Subjekti i ka vendosur gjobë palës paditëse duke argumentuar në mënyrë të përgjithshme, pa verifikuar shkaqet se pse paditësi nuk kishte plotësuar të metat e padisë.
- Subjekti argumenton në caktimin e gjobës së paditësit se ka depozituar më shumë se një padi ndërkohë, që paditësi pretendon se nuk ka depozituar padi të tjera përveç asaj të gjykuar nga subjekti.
- Subjekti nuk e ka vendosur gjobën në përputhje me parashikimin e nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile, pasi në këtë rast, për sa kohë padia është kthyer për mosplotësim të të metave të saj, bazuar në nenin 154/a<sup>89</sup> të Kodit të Procedurës Civile quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera.

<sup>89</sup>Kur paditësi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, kërkesëpadia quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera.

- Subjekti ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e neneve 34 dhe 511/2 të Kodit të Procedurës Civile, duke vendosur që gjoba të ekzekutohet drejtpërdrejt nga përmbaruesi gjyqësor privat ose shtetëror, pa u pajisur më parë me urdhër ekzekutimi në përputhje me nenin 511/2 të Kodit të Procedurës Civile.
- Subjekti nuk ka verifikuar se kur paditësit i është njoftuar vendimi i tij për plotësimin e të metave të padisë, si dhe ka cenuar të drejtën kushtetuese të paditësit për t'u ankuar kundër një vendimi gjyqësor, parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- Është e paqartë se pse është kërkuar pagesa e tarifës së padisë, ndërkohë që padia është kthyer për shkak të mosplotësimit të të metave të saj, e cila bazuar në nenin 154/a të Kodit të Procedurës Civile quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.21.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësime ndër të tjera, ka shpjeguar se:

*Së pari*, është e vërtetë që nuk ka një bazë ligjore konkrete se përse subjekti ka zgjatur afatin e kthimit të padisë me të meta, por këtë qëndrim e ka pasur jo vetëm për këtë çështje, por edhe për çdo çështje, të cilat ka shqyrtuar për të qenë sa më i drejtë me palët në gjykim, duke marrë parasysh se pala paditëse po bënte të gjitha përpjekjet për ta përjashtuar subjektin nga kjo çështje, duke parashtruar kallëzime penale fiktive kundër personit të tij, duke marrë parasysh gjendjen e pandemisë globale, e cila ekzistonte në vendin tonë, i ka lënë një afat shtesë të papërcaktuar në kohë me qëllim rregullimin e të metës së padisë. I ka lënë një afat të tillë, që pala paditëse të paraqitej atëherë kur do të gjente një kohë të përshtatshme për shkak të kufizimeve, të paraqitej në ambientet e sekretarisë apo ta dërgonte me postë të plotësuar të metën e konstatuar prej subjektit. Pra, e ka bërë këtë për të qenë sa më korrekt me palët e asaj padie dhe për të mosparagjykuar çështjen. Këshilli i Ministrave me aktin nr. \*\*\*, datë 25.3.2020, ka vendosur të pezullojë veprimtarinë gjyqësore, por duke lënë “një dritare” për zhvillimin e proceseve me karakter të ngutshëm apo edhe ato që vlerëson gjyqtari se mund të shqyrtohen. Akti normativ me fuqi të ligjit përdor termin “seanca gjyqësore” dhe jo çdo veprim tjetër i gjykatës. Në çështjen konkrete nuk është bërë asnjë seancë gjyqësore, por vetëm janë kryer veprime paraprake përgatitore në dhomë këshillimi e pa praninë e palëve, në kuptim të nenit 158 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile. Sakaq, germa “b” e nenit 3§3 e të njëjtit akt normativ me fuqi të ligjit sanksionon se mund të zhvillohen edhe çështjet e tjera gjyqësore civile, të cilat gjykata vlerëson se mund të zhvillohen. Subjekti shpjegon se në dijeninë e tij (pasi nuk i ka aktet e dosjes, pasi çështja ndodhet në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë), pala paditëse në atë gjykim është njoftuar me një shkresë të dytë, ku i është bërë i qartë afati shtesë me qëllim për t'u paraqitur pranë kryesekretarisë së gjykatës apo për të dërguar me shërbim postar plotësimet e ankimit. Nga praktika e deritanishme, subjekti shpjegon se nuk njofton asnjë vendim të ndërmjetëm për plotësim të metash, por një shkresë të posaçme, ku i parashtron palës arsyet e konstatimit të padisë me të meta. Ky qëndrim i tij përputhet me nenin 154/a të Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon që e meta duhet të njoftohet me shkresë. Madje, njofton me shkresë edhe kur e meta konstatohet prej tij në seancë publike dhe pala paditëse është prezent dhe dëgjon relatimin tim verbal për të metën.

Në lidhje me pyetjen se përse gjykata nuk ka marrë një vendim revokimi për njoftimin e vendimit të datës 24.3.2020, kur palës paditëse i është lënë një afat shtesë, subjekti shpjegon

se në vlerësimin e tij vendimi i ndërmjetëm mund të revokohet sipas nenit 315 të Kodit të Procedurës Civile vetëm atëherë kur duhet ta revokosh tërësisht atë, për të mos krijuar më efekte gjatë procesit. Në rastin konkret nuk e ka revokuar vendimin e ndërmjetëm të kthimit të padisë me të meta, por vetëm ka zgatur afatin e plotësimit të ankimit. Pra, konstatimi se padia është me të meta vazhdon të ishte në fuqi dhe nuk ishte e nevojshme ta revokonte këtë vendim.

Në lidhje me pyetjen se përse gjykata ka vendosur gjobë për padi abuzive, pa verifikuar shkaqet se përse e meta nuk ishte plotësuar, subjekti shpjegon se konstatimi i padisë me të meta dhe shkaqet që kanë çuar drejt saj dhe konstatimi i padisë si abuzive, në përputhje me nenin 34 të Kodit të Procedurës Civile, kanë shkaqe tërësisht të ndryshme. Në vlerësimin e tij, nuk e përcakton shkaku i mbarimit të procesit gjyqësor me vendim përfundimtar apo jopërfundimtar faktin nëse padia është abuzive apo jo. Një përcaktim se padia është abuzive janë pretendimet abuzive të ngritura në të, sjellja e papërgjegjshme e palës paditëse gjatë procesit, kërkimet e përsëritura, kërkimet haptazi në kundërshtim me ligjin etj. Si rrjedhim, nuk ka asnjë lidhje midis hetimit për shkakun e kthimit të padisë me të meta me ato të cilësimit se kur një padi është abuzive.

Në lidhje me pyetjen se përse pala paditëse dënohet me gjobë për ngritjen e padive të përsëritura, kur një padi e tillë e depozituar nga z. M. është e vetme, subjekti shpjegon se neni 34 i Kodit të Procedurës Civile sanksionon dy raste se kur një padi është abuzive, në kuptim të këtij neni. Ato janë: kur pretendimet e palëve janë abuzive dhe kur janë të përsëritura (faktikisht kjo dispozitë liston edhe disa arsye të tjera, por këto mund të konsiderohen si dy grupe kryesore se kur gjykata mund të vendosë gjobë). Në rastin konkret, z. M. është cilësuar se ka ngritur një kërkesëpadi abuzive dhe jo të përsëritur. Abuziviteti me të drejtën për të ngritur padi iu kristalizua gjykatës, pasi subjekti paditës nuk ka parapaguar tarifën për regjistrimin e padisë, si dhe nuk ka depozituar në versionin origjinal ose të njëjësuar me origjinalin të aktit administrativ të kundërshtuar. Ky ka qenë shkaku se përse është konsideruar padi abuzive dhe jo e përsëritur.

Në lidhje me pyetjen se përse i është vendosur gjobë në bazë të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile, kur në rastet e kthimit të padisë me të meta, ajo konsiderohet si e padepozituar ndonjëherë, pasi kthehet bashkë me aktet shoqëruese, subjekti shpjegon se koncepti i padisë ndahet në atë procedural dhe atë material. Koncepti procedural lidhet me vënien në lëvizje të gjykatës dhe aksesin e palëve në gjykatë, si një e drejtë kushtetuese për t'u dëgjuar e gjykuar nga një gjyqtar i pavarur dhe i paanshëm. Gjithashtu, padia ka një kuptim material dhe lidhet me pasojat në të drejtën materiale civile apo administrative, të cilat kërkon të ndreqësh apo fiksosh me ngritjen e kësaj padie. Nën këtë interpretim, subjekti ka vlerësuar se koncepti “padia konsiderohet si e padepozituar në momentin kur kthehet me të meta”, lidhet me konceptin e parashkrimit dhe rrjedhja e afateve të tij të parashikuar në të drejtën civile materiale, sanksionuar në nenin 135§2 të Kodit Civil. Pikërisht, në këtë dispozitë ligjore sanksionohet togfjalëshi “padia me të meta konsiderohet se nuk është parashtruar asnjëherë”. Si rrjedhim, padia duhet të konsiderohet si e mosdepozituar ndonjëherë në kuptimin material dhe jo atë procedural, pasi në atë procedural pala paditëse iu drejtua gjykatës me padi, aksesin në gjykatë iu garantua dhe pretendimet e saj, qoftë edhe paraprakisht, iu lexuan nga një gjyqtar i paanshëm etj. Por cilësia e këtyre pretendimeve dhe sjellja e tij me gjykatën, e cila edhe pse e njoftoi disa herë për rregullimin e të metave të padisë, e cila ishte paraqitur prej atij vetë, mund të cilësohen si abuzive<sup>90</sup>.

---

<sup>90</sup>Për detaje shihni prapësimet e subjektit të rivlerësimit të datës 28.2.2022.

## Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

10.21.3 Komisioni vëren se subjekti pranon që nuk ka bazë ligjore për caktimin e një afati shtesë të pacaktuar duke argumentuar me kohën e pandemisë caktimin e një afati të tillë. Subjekti, në lidhje me kthimin e padisë në datën 4.5.2020, ndërkohë që afatet ishin pezulluar, deklaroi se akti normativ përdor termin seancë gjyqësore, ndërkohë që ai ka gjykuar në dhomë këshillimi. Ky shpjegim i subjektit nuk justifikon faktin që për sa kohë afatet ishin pezulluar paditësi ka pasur kohë për të plotësuar padinë me të meta, për rrjedhojë, ai nuk mund t'i kthente padinë dhe t'i vinte gjobë paditësit. Subjekti deklaroi se paditësi është njoftuar për plotësimin e padisë, por nuk rezultoi që të ketë depozituar dokumentacion provues në lidhje me këtë pretendim, për rrjedhojë, ai ngelet në nivel deklarativ. Në lidhje me vendosjen e gjobës, subjekti deklaroi se nuk ka një lidhje midis hetimit për shkakun e kthimit të padisë me të meta me cilësimin e saj si padi abuzive. Subjekti deklaroi se gjopa është vendosur për padi abuzive jo të përsëritur. Ndërkohë, në vendim subjekti shprehet si vijon: *“Kjo gjobë duhet të jetë në vlerën maksimale të parashikuar në ligj, pasi gjatë viteve të fundit vihet re një përdorim masiv i padive për nxjerrjen e lejes së ndërtimit, pavarësisht se nuk plotësohen kriteret e ligjit nr. 107/2014, ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’ pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Këto çështje, në pjesën dërmuese të tyre zgjidhen në shkallë të parë, pasi Bashkia Vlorë dhe kryetari i saj nuk i ankimojnë këto vendime, duke bërë që leja e ndërtimit të nxirret menjëherë. Duke marrë parasysh se në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ushtrojnë punën e gjyqtarit katër gjyqtarë, tanimë vetëm tre, palët zgjedhin mënyrën për ngritjen e shumë padive njëkohësisht, me palë, shkak ligjor e objekt padie krejtësisht të njëjtë me qëllim përzgjedhjen e gjyqtarit, qëndrimi i të cilit përputhet më mirë me interesin e tyre (nxjerrjen e lejes së ndërtimit). Me ngritjen e kaq shumë padive, probabiliteti për përzgjedhjen e gjyqtarit, i cili pranon këto padi janë tepër të larta, duke cenuar kështu interesat e palës tjetër, por edhe interesat publikë”*.

Në përfundim konstatohet se subjekti: (i) ka vendosur të lërë një afat shtesë për plotësimin e padisë, pa u bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile; (ii) ka vendosur kthimin e padisë, ndërkohë që afatet ishin të pezulluara; (iii) nuk ka marrë masa për njoftimin e vendimeve të tij në lidhje me shtyrjen e afatit për plotësimin e padisë; (iv) i ka vendosur gjobë palës paditëse pa verifikuar shkaqet se pse paditësi nuk kishte plotësuar të metat e padisë, si dhe duke argumentuar caktimin e gjobës së paditësit me pretendimin se ka depozituar më shumë se një padi, ndërkohë që nuk rezultoi një fakt i tillë i pranuar dhe nga subjekti; (v) nuk e ka vendosur gjobën në përputhje me parashikimin e nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile, pasi në këtë rast për sa kohë padia është kthyer për mosplotësim të të metave të saj, bazuar në nenin 154/a<sup>91</sup> të Kodit të Procedurës Civile quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera.

Për sa më sipër, subjekti ka treguar njohuri, aftësi dhe gjykim të dobët në drejtim të aspektit të njohurive ligjore dhe të aspektit të arsytimit ligjor, në kuptim të pikave 2 dhe 3, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, si dhe ka cenuar të drejtat e ankuesit për një proces të rregullt gjyqësor.

**3.** Në pikën 3 të dispozitivit të vendimit subjekti shprehet se dispozitivi numër dy i këtij vendimi (që është gjopa) të ekzekutohet drejtpërdrejt nga përmbartuesi gjyqësor privat ose shtetëror pa u pajisur më parë me urdhër ekzekutimi në përputhje me nenin 511/2 të Kodit të Procedurës Civile. Në pikën 4 të dispozitivit të vendimit subjekti shprehet se Ankimi kundër vendimit gjyqësor nuk pezullon veprimet përmbartimore për ekzekutimin e gjobës.

---

<sup>91</sup>Kur paditësi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, kërkesëpadija quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera.

Komisioni konstaton se gjoba ndaj ankuesit është vënë në zbatim të nenit 34 të Kodit Procedurës Civile ku parashikohet se: *“Gjykata, në çdo shkallë të gjykimit, kur konstaton se palët ose përfaqësuesit e tyre me vetëdije paraqesin padi, ankime, kërkesa ose pretendime abuzive, ose të përsëritura dhe me keqdashje, ose kur kërkojnë qëllimisht të zvarrisin gjykimin, ose kur konstatohet se palët ose përfaqësuesit e tyre kanë fshehur ose shtrembëruar me keqbesim ose faj të rëndë, fakte dhe rrethana të rëndësishme që lidhen me çështjen, urdhëron me vendimin që jepet në përfundim të gjykimit, përveç kur në këtë Kod parashikohet ndryshe, gjobitjen e përgjegjësit në shumën nga 50.000 deri në 100.000 lekë. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas rregullave për vendimet përfundimtare ose jopërfundimtare, në varësi të llojit të vendimit që i jep fund gjykimit përkatës”.*

Në nenin 511 paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: *“Nuk lëshohet urdhër ekzekutimi për vendimin e sigurimit të padisë dhe për gjobat e dhëna nga gjykata, vendimet për marrjen e detyrueshme të provës, vendimin në pjesën që urdhëron shpenzimet gjyqësore, si dhe vendimet civile të gjykatës, të dhëna për ekzekutim të përkohshëm, të cilat ekzekutohen drejtpërdrejt nga shërbimi përmbarimor, pas njoftimit të vendimit”.*

Në kreun IV të Kodit të Procedurës Civile me emërtim Gjobat në nenet 165-168 parashikohen rastet kur gjykata vendos gjoba, vendimi i cili bazuar në nenin 169 është i formës së prerë dhe nuk lejohet ankim

Në interpretim të dispozitave të mësipërme, neni 511, paragrafi 2, aplikohet në rastet e parashikuara nga nenet 165-168 të Kodit të Procedurës Civile dhe jo në rastet e parashikuara nga neni 34 i këtij kodi.

10.21.4 Komisioni ka konstatuar se subjekti ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e neneve 34 dhe 511/2 të Kodit të Procedurës Civile, duke vendosur që gjoba të ekzekutohet drejtpërdrejt nga përmbaruesi gjyqësor privat ose shtetëror pa u pajisur më parë me urdhër ekzekutimi, në përputhje me nenin 511/2 të Kodit të Procedurës Civile.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.21.5 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka shpjeguar se e sanksionon neni 511§2 i Kodit të Procedurës Civile. Sipas kësaj dispozite ligjore, gjobat e vendosur nga gjykata nuk kanë nevojë për të nxjerrë urdhërekzekutimi dhe ekzekutohen menjëherë. Për aq kohë sa kjo gjobë është vendosur prej tij si gjyqtar, gjatë shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore duhet të ekzekutohet menjëherë. Nga ana tjetër, gjykatat administrative, gjatë nxjerrjes së vendimeve të tyre, qoftë edhe përfundimtare, nuk nxjerrin urdhërekzekutimi. Ato e përcaktojnë në dispozitivin e vendimit përfundimtar mënyrën dhe afatin e ekzekutimit. Ky është një sanksionim, i cili rrjedh nga germa “b”, e nenit 41§1, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.21.6 Shpjegimi i subjektit lidhet me bindjen e brendshme të tij dhe mënyrën e arsytimit, për rrjedhojë, shpjegimet e tij janë bindëse, pasi Komisioni nuk mund të vlerësojë bindjen e subjektit dhe mënyrën e interpretimit të ligjit. Por ky argumentim i subjektit do të konsiderohet nga Komisioni në vlerësimin e denoncimit të shtetasit S. M..

4. Në datën 27.5.2020, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë i ka kërkuar ankuesit plotësimin e të metave të kërkesës për ankim, pasi nuk është paguar tarifa e padisë dhe se ankimi nuk është paraqitur në aq kopje sa janë subjekte në gjykim. Për plotësimin e të metave i ka lënë afat deri më 8.6.2020.



Subjekti, në datën 8.6.2020, ka vendosur mospranimin e ankimit të ankuesit duke argumentuar se subjekti është njoftuar për të metat e ankimit me shkresë të postaçme më 27.5.2020, duke iu lënë afat deri më 8.6.2020, duke qenë se të metat nuk ishin plotësuar deri më 8.6.2020 subjekti këtë veprim e ka konsideruar si ekuivalent i tërheqjes së ankimit.

Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2020, të Postës Shqiptare rezulton se njoftimi për plotësimin e të metave i është dorëzuar paditësi në datën 9.6.2020.

10.21.7 Komisioni, nga sa më sipër, ka konstatuar se:

- Për sa më sipër rezulton se subjekti nuk ka verifikuar se kur paditësit i është njoftuar vendimi i tij për plotësimin e të metave të padisë, si dhe ka cenuar të drejtën kushtetuese të paditësit për t'u ankuar kundër një vendimi gjyqësor, parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- Është e paqartë se pse është kërkuar pagesa e tarifës së padisë, ndërkohë që padia është kthyer për shkak të mosplotësimit të të metave të saj, e cila bazuar në nenin 154/a<sup>92</sup> të Kodit të Procedurës Civile quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera.

Për konstatimet e mësipërme subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.21.8 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në lidhje me pyetjen se përse gjykata nuk ka verifikuar shkaqet e ankimit dhe nuk e ka pranuar ankimin, duke i cenuar subjektit të drejtën kushtetuese për ankim ndaj një vendimi gjyqësor, ka shpjeguar se nuk është detyra e tij të hetojë shkaqet se përse subjekti kërkues nuk ka parashtruar ankim. Siç ka shpjeguar më lart subjekti, shkaqet e kthimit të padisë me të meta apo mospranimin të ankimit janë tërësisht të ndryshme nga ato të padisë abuzive, e cila parashikohet në nenin 34 të Kodit të Procedurës Civile.

Në lidhje me pyetjen se është e paqartë se përse është kërkuar pagesa e tarifës së padisë dhe kur ajo është kthyer me të meta, subjekti shpjegon se në rastet kur kundërshtohet një vendim për kthim me të meta, ku e meta ishte mosparapagimi i tarifës gjyqësore bashkë me pagimin e tarifës së regjistrimit të ankimit, duhet të paguhet detyrimisht edhe pagesa për regjistrimin e padisë. Kjo pasi tarifat gjyqësore duhet të parapagohen nga pala që ka vendosur në lëvizje procesin. Baza ligjore dhe nënligjore për këtë veprim ishte neni 102 e në vijim i Kodit të Procedurës Civile, ligji nr. 98/2017, "Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë", si dhe Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave me nr. \*\*\*, datë 29.12.2014, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore".

Sipas këtij kuadri ligjor dhe nënligjor, tarifat, si rregull, parapagohen nga pala paditëse në gjykim, ndryshe procesi nuk mund të zhvillohet. Duke qenë se si gjyqtar i shkallës së parë ka vlerësuar vetëm anën formale të ankimit në përputhje me nenin 44 e në vijim të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", duke konsideruar se edhe ky kusht, pra parapagimi i tarifës së regjistrimit të padisë dhe ankimit duhet të plotësohet, ndryshe ishte ankim i papranueshëm nga pikëpamja formale.

---

<sup>92</sup>Kur paditësi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, kërkesëpadia quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera.

## **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.21.9 Komisioni vëren se subjekti deklaron se nuk është detyrë e gjykatës të hetojë shkaqet se pse subjekti kërkues nuk ka paraqitur ankim dhe se ka vlerësuar që duhej të paguhej tarifa e padisë, pasi si rregull në gjykim parapaguhen. Gjykata, me të vërtetë, nuk heton shkaqet pse nuk ka paraqitur ankim ankuesi, por ka për detyrë të verifikojë nëse ankuesit i është njoftuar vendimi, si dhe të llogarisë afatet e ankimit nga momenti i njoftimit të vendimit. Në rastin në fjalë, subjekti nuk ka verifikuar se kur i është njoftuar ankimi kërkuesit, por ka llogaritur afatet me datën e nxjerrjes së njoftimit, duke vendosur mospranimin e ankimit. Në lidhje me detyrimin për pagimin e tarifës së padisë, për sa kohë padia është kthyer me të meta nuk ka padi, për rrjedhojë, edhe detyrimi për të paguar tarifën e saj nuk qëndron. Subjekti, në këtë rast, i ka cenuar të drejtat kushtetuese ankuesit për t'u ankuar.

Për sa më sipër, subjekti ka treguar njohuri, aftësi dhe gjykim të dobët në drejtim të aspektit të njohurive ligjore dhe të aspektit të arsyetimit ligjor, në kuptim të pikave 2 dhe 3, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, të aspektit të aftësive organizative në kuptim të pikës 3, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, si dhe ka cenuar të drejtën kushtetuese të ankuesit për t'u ankuar.

## **10.22 Në lidhje me hetimin disiplinor të iniciuar nga ILD-ja**

Në datën 28.7.2021, ILD-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., ka marrë vendim “Për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj subjektit të rivlerësimit”.

Ky hetim ka filluar pasi zv/kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë i është drejtuar ILD-së me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2021, me të cilën informon se subjekti me arsyetimin se ka ngarkesë në punë ka refuzuar në mënyrë të vazhdueshme marrjen në shqyrtim të ankimeve/kundër ankimeve dhe rekurseve/kundër rekurseve për vendimet e dhëna nga një ish-subjekt rivlerësimi. Ky refuzim ka sjellë anomali në punën e gjykatës për shkak se dosjet kanë mbetur pa verifikime të mëtejshme.

Bazuar në procesverbalin nr. \*\*\*, datë 23.6.2021, rezulton se në datën 9.6.2021 është vendosur që ankimet e një ish-subjekti rivlerësimi të ndaheshin midis gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Nga shortimi i 14 ankimeve dhe një kërkese për heqje dorë nga ankimi subjektit i kanë rënë 5 ankime, të cilat ai nuk ka pranuar t'i marrë në shqyrtim.

10.22.1 Komisioni ka administruar dosjen e plotë<sup>93</sup> të këtij hetimi, nga ku rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pranuar të shqyrtojë ankimet e mësipërme, pasi mungonte baza ligjore, si dhe sipas praktikës së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ato shqyrtoheshin nga zv/kryetari. Subjekti ka mbajtur këtë qëndrim edhe pas largimit të zëvendëskryetarit, duke i shqyrtuar vetë të gjitha ankimet për vendimet e dhëna nga gjyqtarët, të cilët ishin shkarkuar nga Komisioni.

Për sa më sipër nuk grihen dyshime për veprime në kundërshtim me procedurën e subjektit të rivlerësimit.

## **Denoncime të depozituara pas riçeljes së hetimit**

### **10.23 Denoncim i shtetas M. A. A.<sup>94</sup>**

Denoncuesja pretendon se në çështjen gjyqësore të gjykuar nga subjekti, me palë të paditur denoncuesen, janë paraqitur dokumente fotokopje dhe subjekti ka vendosur duke marrë në konsideratë dokumentacionin e fotokopjuar dhe jo të paraqitur në formën e kërkuar nga ligji.

10.23.1 Komisioni ka dërguar shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2022, të Gjykatës së Apelit Administrativ, duke verifikuar dokumentacionin e dosjes, nga ku rezultoi se ai ishte paraqitur

<sup>93</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje ILD \*\*\*, datë 7.1.2022.

<sup>94</sup>Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 17.3.2022.

nga pala e paditur në kopje të njehsuar me origjinalin ose në origjinal, për rrjedhojë, pretendimi i ankueses nuk qëndron.

#### 10.24 Denoncim i shtetasit A. M.<sup>95</sup>

Trajtuar në rezultatet e hetimit administrativ, dërguar subjektit në faqen 61 të vendimit.

#### 10.25 Denoncim i shtetasit S. M.<sup>96</sup>

Denoncuesi pretendon se: (a) subjekti e ka gjobitur dy herë nga 100.000 lekë në seancën përgatitore për masën e sigurimit dhe për herë të dytë kur ka vendosur kthimin e akteve; (b) denoncuesi pretendon se ligji nuk e lejon vendosjen e gjobës në seancë përgatitore, duke pretenduar se subjekti në një rast të ngjashëm që i përket paditësit D. B. ka pezulluar ekzekutimin e vendimit me gjobë.

10.25.1 Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e depozituar nga ankuesi, konstaton se:

1. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.9.2019, subjekti ka vendosur kthimin e padisë ankuesit duke argumentuar se:

a. Subjekti paditës nuk ka dhënë një adresë të saktë për të bërë kontaktimin e tij, si dhe padia është ngritur ndaj një personi të vdekur sikundër është e ndjera L. A..

Më tej, subjekti ka vendosur të aplikojë gjobë në vlerën 100.000 lekë për padi abuzive dhe të përsëritur. Abuziviteti sipas subjektit është mosdhënia e një adrese të saktë, ngritja e një padie ndaj një personi të vdekur, si dhe ngritja e të njëjtës padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në datën 17.7.2019 (kjo gjykatë me anë të vendimit nr. \*\*\* regjistri, datë 22.7.2019, ka vendosur të rrëzojë pretendimin për sigurimin e padisë).

Nga analizimi i vendimit të subjektit është e paqartë se si subjekti kishte dijeni që znj. L. A. kishte ndërruar jetë. Në lidhje me adresën nga verifikimi i vendimit të subjektit konstatohet se paditësi ka një adresë të plotë, si dhe një numër telefoni, për rrjedhojë të dhënat e paraqitura prej tij janë të plota sipas Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu, e njëjta adresë është vendosur edhe në vendimin nr. \*\*\*, datë 26.12.2019, me një ndryshim që në këtë vendim është shtuar vetëm një shprehje “te zona e njohur ndryshe tregu”.

10.25.2 Komisioni ka konstatuar se:

- Arsyet e paraqitura nga subjekti nuk përputhen me provat e administruara, pasi adresa e paraqitur nga paditësi është e plotë e shoqëruar dhe me numër telefoni, si dhe padia nuk i është drejtuar vetëm të ndjerës, por edhe 7 paditurve të tjerë.
- Subjekti argumenton në caktimin e gjobës se paditësi ka depozituar më shumë se një padi, ndërkohë që nuk rezulton se ankuesi të ketë paraqitur padi të tjera me këtë objekt në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Për rrjedhojë duket se subjekti nuk ka argumentuar vendosjen e gjobës ndaj ankuesit.
- Subjekti nuk e ka vendosur gjobën në përputhje me parashikimet e nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile, pasi në këtë rast, për sa kohë padia është kthyer për mosplotësim të të metave të saj, bazuar në nenin 154/a<sup>97</sup> të Kodit të Procedurës Civile, quhet se ajo nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera.

<sup>95</sup>Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 23.3.2022.

<sup>96</sup>Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 17.3.2022.

<sup>97</sup>Kur paditësi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, kërkesëpadija quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera.

- Është e paqartë dijenia e subjektit që znj. L. A. kishte ndërruar jetë.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.25.3 Subjekti, në prapësime dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se:

Së pari, në lidhje me pyetjen se “pala paditëse ka dhënë një adresë të saktë, e shoqëruar kjo edhe me një numër telefoni, si rrjedhim, padia nuk duhej të kthehej me të meta”, subjekti bashkëlidhi gjithë procesverbalin në lidhje me këtë çështje, nga momenti i parë procedural deri në momentin e fundit. Është konstatuar se pala paditëse nuk ka dhënë një adresë të saktë, pasi kthimi me të meta nuk mund të njoftohet me anë të telefonit, por vetëm me shkresë, ashtu sikundër përcakton neni 154/a§3 i Kodit të Procedurës Civile. Sakaq, pala paditëse nuk mund të vijonte më tej procesin, pasi ajo ishte ngritur ndaj një personi të vdekur dhe çmoj se kalimi procedural, i sanksionuar në nenin 199 të Kodit të Procedurës Civile nuk mund të aplikohet për palët, të cilët kanë vdekur përpara ngritjes së padisë, por vetëm për ata gjatë procesit gjyqësor. Këtë qëndrim ka mbajtur subjekti duke iu referuar edhe disa vendimeve të Gjykatës së Lartë. Si rrjedhim, kthimi me të meta i padisë ishte e vetmja mundësi ndodhur përpara këtyre kushteve.

Së dyti, në lidhje me pyetjen se “është vendosur kthimi me të meta, kur është ngritur ndaj një personi të vdekur, kur në fakt padia i kundërdrejtohet edhe 6 subjekteve të paditura të tjerë dhe është e paqartë dijenia mbi vdekjen e znj. L. A.”, subjekti shpjegon se në seancën përgatitore të datës 13.9.2019 (procesverbal me regjistrim audio - procesverbali bashkëlidhur), subjekti i paditur Sh. B. ka qenë i përfaqësuar nga av. S. K.. Ajo ngriti prapësimin se subjekti i paditur L. A. kishte vdekur, duke depozituar si provë certifikatën e vdekjes. Si rrjedhim, subjekti sqaron se iu provua përtej çdo dyshimi që ky person, subjekt i paditur, kishte vdekur dhe, si rrjedhim, padia duhej të kthehej me të meta. Gjithashtu, e njëjta avokate parashtroi prapësimin se e njëjta çështje po gjykohej pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (pranë gjyqtarës H. Ç.), duke depozituar si provë shkresën përkatëse.

Së treti, në lidhje me pyetjen se “nuk rezulton se janë ngritur disa padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë” shpjegon se mund të jetë e vërtetë që pala paditëse nuk ka ngritur një padi tjetër pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, por ai kishte ngritur të njëjtën padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kjo gjykatë ishte në shqyrtim e sipër dhe me anë të vendimit nr. \*\*\* regjistri, datë 22.7.2019, ka vendosur të rrëzojë pretendimin për sigurimin e padisë dhe duke vijuar shqyrtimin e mëtejshëm të procesit gjyqësor. Si rrjedhim u vërtetua që pala paditëse i ishte drejtuar sistemit gjyqësor shqiptar me padi të përsëritura, si e tillë, ai ishte në kushte të dënimit me gjobë për padi të përsëritura, në përputhje me nenin 34§1 të Kodit të Procedurës Civile.

Së katërti, në lidhje me pyetjen se “përse është vendosur gjobë kur vendimi është për kthim me të meta, kur dihet që kur padia kthehet me të meta, ajo konsiderohet si e paparashtuar”, parashtroj si në vijim. Koncepti i padisë ndahet në atë procedural dhe atë material. Koncepti procedural lidhet me vënien në lëvizje të gjykatës dhe aksesin e palëve në gjykatë, si një e drejtë kushtetuese, për t’u dëgjuar e gjykuar nga një gjyqtar i pavarur dhe i paanshëm. Gjithashtu, padia ka një kuptim material dhe lidhet me pasojat në të drejtën materiale civile apo administrative, të cilat kërkon të ndreqësh apo fiksosh me ngritjen e kësaj padie. Nën këtë interpretim, subjekti vlerëson se koncepti “padia konsiderohet si e padepozituar në momentin kur kthehet me të meta” lidhet me konceptin e parashkrimit dhe rrjedhja e afateve të tij, të parashikuar në të drejtën civile materiale, sanksionuar në nenin 135§2 të Kodit Civil. Pikërisht, në këtë dispozitë ligjore sanksionohet togfjalëshi “padia me të meta konsiderohet se nuk është

parashtruar asnjëherë”. Si rrjedhim, padia duhet të konsiderohet si e mosdepozituar ndonjëherë në kuptimin material (rrjedhja e afateve të parashkrimit të padisë, gjë që ligja jonë e ka rregulluar në të drejtën civile materiale) dhe jo atë procedural, pasi në atë procedural pala paditëse i është drejtuar gjykatës me padi, aksesit në gjykatë iu garantua, pretendimet e saj, qoftë edhe paraprakisht, iu lexuan nga një gjyqtar i paanshëm etj. Por cilësia e këtyre pretendimeve dhe sjellja e tij me gjykatën (mosdhënia e një adrese të saktë apo edhe ngritja e padisë ndaj një personi të vdekur) mund të cilësohen si abuzive.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.25.4 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti, vëren se pretendimi i subjektit nuk qëndron, pasi adresa rezulton të ketë qenë e saktë dhe njoftimi i palëve bëhet nga ftuesi, i cili nuk kishte arsye se pse të mos kontaktonte në telefon palën. Në lidhje me kalimin procedural, në këtë rast, padia nuk është me të meta, pasi është e drejtë e palëve për të përcaktuar vetëdërgjyqësinë dhe gjykata shprehet me vendim.

Në këtë rast, subjekti nuk kishte pse të shprehej se padia ishte me të meta, pasi paditësi kishte plotësuar të gjitha kërkesat e parashikuara nga neni 154. Gjithashtu, nga procesverbali i seancës datës 12.11.2019 konstatohet se bazuar në vetëdeklarimet e subjektit pala paditëse kishte dijeni, pra adresa ka qenë e saktë. Gjithashtu, subjekti ka kryer katër seanca përgatitore dhe në seancën e dytë, bazuar në procesverbalin e datës 26.7.2019 subjekti është shprehur se padia është paraqitur pa të meta dhe është hartuar sipas nenit 21 të ligjit nr. 49/2012. Në lidhje me sa parashtron subjekti, për sa kohë rezulton që e njëjta padi po shqyrtohej nga dy gjykata të ndryshme, atëherë subjekti nuk duhej të kishte kthyer padinë për të meta, por duhej të kishte pushuar çështjen bazuar në nenin 58 të Kodit të Procedurës Civile.

Për sa më sipër, subjekti ka treguar njohuri, aftësi dhe gjykim të dobët në drejtim të aspektit të njohurive ligjore dhe të aspektit të arsyetimit ligjor, në kuptim të pikave 2 dhe 3, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, si dhe ka cenuar të drejtat e ankuesit.

**b.** Në pikën 4 të dispozitivit të vendimit, subjekti shprehet se dispozitivi nr. 3 i këtij vendimi (që është gjoba) të ekzekutohet drejtpërdrejt nga përmbartuesi gjyqësor privat ose shtetëror pa u pajisur më parë me urdhër ekzekutimi në përputhje me nenin 511/2 të Kodit të Procedurës Civile. Në pikën 5 të dispozitivit të vendimit subjekti shprehet se ankimi kundër vendimit gjyqësor nuk pezullon veprimet përmbartimore për ekzekutimin e gjobës.

Komisioni konstaton se gjoba ndaj ankuesit është vënë në zbatim të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: *“1. Gjykata, në çdo shkallë të gjykimit, kur konstaton se palët ose përfaqësuesit e tyre me vetëdije paraqesin padi, ankime, kërkesa ose pretendime abuzive, ose të përsëritura dhe me keqdashje, ose kur kërkojnë qëllimisht të zvarrisin gjykimin, ose kur konstatohet se palët ose përfaqësuesit e tyre kanë fshehur ose shtrembëruar me keqbesim ose faj të rëndë, fakte dhe rrethana të rëndësishme që lidhen me çështjen, urdhëron me vendimin që jepet në përfundim të gjykimit, përveç kur në këtë Kod parashikohet ndryshe, gjoritjen e përgjegjësit në shumën nga 50.000 deri në 100.000 lekë. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas rregullave për vendimet përfundimtare ose jopërfundimtare, në varësi të llojit të vendimit që i jep fund gjykimit përkatës”.*

Në nenin 511, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: *“Nuk lëshohet urdhër ekzekutimi për vendimin e sigurimit të padisë dhe për gjobat e dhëna nga gjykata, vendimet për marrjen e detyrueshme të provës, vendimin në pjesën që urdhëron shpenzimet gjyqësore, si dhe vendimet civile të gjykatës, të dhëna për ekzekutim të përkohshëm, të cilat ekzekutohen drejtpërdrejt nga shërbimi përmbartimor, pas njoftimit të vendimit”.*

Në kreun IV të Kodit të Procedurës Civile me emërtim “gjobat” në nenet 165-168 parashikohen rastet kur gjykata vendos gjoba, vendim, i cili bazuar në nenin 169, është i formës së prerë dhe nuk lejohet ankimi.

Në interpretim të dispozitave të mësipërme, neni 511, paragrafi 2, aplikohet në rastet e parashikuara nga nenet 165-168 të Kodit të Procedurës Civile dhe jo në rastet e parashikuara nga neni 34 i këtij Kodi.

10.25.5 Komisioni ka konstatuar se subjekti ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e neneve 34 dhe 511/2 të Kodit të Procedurës Civile, duke vendosur që gjoba të ekzekutohet drejtpërdrejt nga përmbartuesi gjyqësor privat ose shtetëror pa u pajisur më parë me urdhër ekzekutimi në përputhje me nenin 511/2 të Kodit të Procedurës Civile.

Për konstatimet e mësipërme subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.25.6 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore ka shpjeguar:

*“Në lidhje me pyetjen se ‘përse gjykata ka vendosur që gjoba të ekzekutohet drejtpërdrejt pa u pajisur më parë me një urdhër ekzekutimi’, shpjegon se arsyeja se përse kjo gjobë duhet të vendosej menjëherë në ekzekutim e sanksionon neni 511§2 i Kodit të Procedurës Civile. Sipas kësaj dispozite ligjore, gjobat e vendosur nga gjykata nuk kanë nevojë për të nxjerrë urdhër ekzekutimi dhe ekzekutohen menjëherë. Për aq kohë sa kjo gjobë është vendosur nga unë si gjyqtar, gjatë shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore, besoj se ajo duhet të ekzekutohet menjëherë. Nga ana tjetër, gjykatat administrative, gjatë nxjerrjes së vendimeve të tyre, qoftë edhe përfundimtare, nuk nxjerrin urdhër ekzekutimi. Ato e përcaktojnë në dispozitivin e vendimit përfundimtar mënyrën dhe afatin e ekzekutimit. Ky është një sanksionim, i cili rrjedh nga neni 41§1, germa ‘b’ e ligjit nr. 49/2012, ‘Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’. Sakaq, nga një interpretim sistematikor (lidhmëria e normave me njëra-tjetrën brenda të njëjtit ligj), logjik dhe gjuhësor të neneve 34§1 dhe 34§2 të Kodit të Procedurës Civile, arrihet në përfundimin se gjobat e vendosura nga gjykata për paditë e përsëritura apo abuzive janë si çdo gjobë tjetër, të cilat duhet të ekzekutohen në mënyrë të menjëhershme në përputhje me nenin 511§2 të Kodit të Procedurës Civile, ndërsa gjoba, si pasojë e mbrojtjes me keqbesim apo faj të rëndë (paragrafi i dytë i nenit 34), lejohet të ankimohet bashkë me vendimin përfundimtar. Pikërisht, bërja e një dallimi të tillë midis të dy rasteve, brenda të njëjtës dispozite ligjore, më bindin që rastet e para të nenit 34 ekzekutohen drejtpërdrejt, pa nxjerrë më parë një urdhër ekzekutimi, në përputhje me nenin 511§2 të Kodit të Procedurës Civile”.*

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.25.7 Shpjegimi i subjektit lidhet me bindjen e brendshme të tij dhe mënyra e arsytimit, për rrjedhojë shpjegimet e tij janë bindëse, pasi Komisioni nuk mund të vlerësojë bindjen e subjektit dhe mënyrën e interpretimit të ligjit. Por, ky argumentim i subjektit do të konsiderohet nga Komisioni në vlerësimin e pjesës tjetër të ankimit të denoncuesit.

2. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.12.2019, subjekti ka vendosur pushimin e gjykimit me palë paditëse ankuesin, pasi nga ana e paditësit ishte paraqitur përpara tri ditëve një padi e njëjtë, e cila i kishte kaluar për shqyrtim një gjyqtari tjetër. Subjekti argumenton se për sa kohë çështja është regjistruar te një gjyqtar tjetër vendosi të pushojë gjykimin, pasi duhet të pushohet për llogari të çështjes më të vjetër në regjistrim në përputhje me nenin 58 të Kodit të Procedurës Civile.

Subjekti ka vendosur të gjobisë paditësin në vlerën 100.000 lekë, pasi ka ngritur shumë padi të njëjta dhe abuzive duke vështirësuar punën e sistemit gjyqësor.

Komisioni konstaton se subjekti, duke argumentuar se ka të bëjë me padi abuzive, ka paragjykuar çështjen gjyqësore pasi ajo i përket për shqyrtim një gjyqtari tjetër.

Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimi të japë shpjegime.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.25.8 Subjekti, në prapësime dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se: *“Në lidhje me pyetjen se “përse kur është pushuar gjykimi i çështjes të regjistruar më vonë në kohë, keni vendosur gjobë, pasi këtë duhet ta bëjë gjyqtari i mëparshëm, duke cenuar kështu punën e tij”, shpjegon se Instituti i ‘Litispendencës’, ose i njohur ndryshe si ngritja e shumë padive njëkohësisht, sanksionohet në nenin 58 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas kësaj dispozite ligjore, gjyqtari i çështjes së dytë, të regjistruar më vonë në kohë, ka për detyrë të pushojë çështjen. Si rrjedhim, ishte detyra ime për të marrë vendimin e pushimit të kësaj çështjeje, si dhe të aplikoj çdo sanksion të parashikuar në Kodin e Procedurës Civile për ngritjen e padive abuzive. Ndryshe do të ishte situata sikur të merrej vendimi i bashkimit të gjyqtarit të mëparshëm, bazuar në nenin 57 të Kodit të Procedurës Civile. Në këtë moment, dosja e subjektit, e regjistruar më pas në kohë, bëhej një me atë të gjyqtarit, dosja e të cilit ishte regjistruar më parë në kohë dhe, si rrjedhim, ai, pra gjyqtari më i vjetër, kishte autoritetin absolut për marrjen e masave ndaj palës, e cila kishte ngritur padi. Deri sa të merrej ky vendim eventual, padia duhet të vijohet e të shqyrtohet nga subjekti si gjyqtari i kësaj çështjeje, duke disponuar lirisht me vendime të ndërmjetme dhe/ose jopërfundimtare”.*

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.25.9 Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit kanë lidhje me bindjen e tij të brendshme, për rrjedhojë, duhet të merren në konsideratë.

3. Me vendimin datë 3.4.2019, subjekti ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë së kërkuarit D. B., duke pezulluar veprimet përmbarimore për ekzekutimin e gjobës, e cila rrjedh nga vendimi i ndërmjetëm i gjykatës.

Në këtë vendim, subjekti shprehet si vijon:

Së bashku me disponimin për kthimin e padisë me të meta, gjykata ka vendosur të gjobisë me gjobë përfaqësuesin ligjor D. B. për shkak të ngritjes së një padie abuzive, vendim për zbatimin e të cilit kanë filluar edhe procedurat përmbarimore.

Ekzistenca e këtyre akteve në dosjen gjyqësore vërteton se të drejtat pasurore të subjektit paditës kërcënohen nga ekzekutimi i gjobës dhe, si i tillë, mund të kërkojë mbrojtjen ligjore sikundër parashikon jurisprudenca e Gjykatës së Lartë.

Gjykata vlerëson se, në rastin konkret, mund të jetë përpara krijimit të një dëmi të pariparueshëm. Kjo pasi ekzekutimi i një gjobe me një vlerë relativisht të lartë prej 100.000 lekësh, në kushtet kur pretendohet paligjshmëria e kësaj gjobe, mund t'i shkaktojë atij një dëm të madh dhe të pariparueshëm.

10.25.10 Komisioni ka konstatuar se:

- Argumentimi dhe vendimi i subjektit në lidhje me pezullimin e veprimeve përmbarimore nuk është në harmoni me të gjitha vendimet e tij për caktimin e gjobës, ku shprehet se: *“Ankimi kundër vendimit gjyqësor nuk pezullon veprimet përmbarimore për ekzekutimin e gjobës”.*

Për rrjedhojë, duket sikur subjekti nuk ka argumentuar të gjitha vendimet në të cilat ka vendosur në dispozitiv se: *“Ankimi kundër vendimit gjyqësor nuk pezullon veprimet përmbartimore për ekzekutimin e gjobës”*.

- Duke qenë se z. D. B. ka përfaqësuar babain e subjektit në gjyqin me palë paditëse Xh. Sh. duket se ai ka njohje me subjektin, për rrjedhojë, duket se subjekti ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit në marrjen e vendimit të pezullimit të gjobës ndaj z. B.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.25.11 Subjekti i rivlerësimit, në prapësime, ka shpjeguar se në lidhje me pyetjen se “përse nga subjekti mbahet ky qëndrim se këto gjoba nuk i nënshtrohen pezullimit kur ka marrë vendimin ndaj denoncuesit, kur në një çështje të ngjashme, ku palë ka qenë z. D. B., ka marrë vendim pezullimi veprimesh përmbartimore”, shpjegon se arsyeja e mospranimit të pezullimit të veprimeve përmbartimore, në rastin konkret, vënin si pasojë e ndalimit shprehimisht sipas nenit 3§6 të Aktit Normativ nr. \*\*\*, datë 1.3.2012, të Këshilli të Ministrave, “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuar”, i cili është miratuar me anë të ligjit nr. 82/2012, datë 13.9.2012, “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar”. Kjo do të thotë që subjekti nuk kishte asnjë diskrecion për të vlerësuar ndryshe, për shkak të ndalimit shprehimisht në ligj. Ndërsa rasti i z. D. B. ishte ndryshe, pasi ai ndodhej në kushtet e përgjithshme të sanksionuar në nenin 28 e në vijim të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (detyrimi ndaj tij, pra, z. D. B. ishte monetar dhe jo lirim si qiramarrës i pronave karshi pronarëve të tyre, të shtetëzuara pas vitit 1944, sikundër ishte rasti i denoncuesit S. M.).

Në lidhje me pyetjen se “përse subjekti kishte gjykuar çështjen e z. D. B. kur ai ka qenë përfaqësues ligjor i babait të tij në një çështje gjyqësore, së pari duke qenë kështu në një konflikt interesi”, subjekti ka shpjeguar se ai e ka parashtruar dorëheqjen nga kjo çështje, por nuk i është pranuar nga Kryetari i Gjykatës, z. A. Sh. (kërkesa për heqje dorë bashkëlidhur). Së dyti, çështja e z. D. B. është regjistruar pranë gjykatës në datën 29.3.2019, duke marrë numër regjistri themeltar \*\*\*, ndërsa çështja civile ku babai i tij është palë e paditur, kundërpaditëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është regjistruar në maj të vitit 2020, ndërsa ai është legjitimuar si përfaqësues ligjor i babait të tij në periudhën shtator - tetor të 2020, pra rreth një vit e gjashtë muaj më vonë. Së treti, subjekti ka rrëzuar padinë e z. D. B., duke rikonfirmuar plotësisht të ligjshme veprimet përmbartimore, të cilat kishin filluar të ekzekutohen menjëherë dhe pa u pajisur me një urdhër ekzekutimi. Ky qëndrim është mbajtur nga subjekti në vendimin nr. \*\*\*, datë 15.4.2019 (vendimi bashkëlidhur). Së katërti, gjatë vitit 2021 subjekti ka pajtuar një avokat për ngritjen e padive për shkak të sulmeve që ndërmori drejtuesi i atëhershëm i televizionit \*\*\*, z. B. B., sikundër ishte av. S. K.

Bashkëlidhur, subjekti ka depozituar heqje dorë nga gjykimi i çështjeve ku është përfaqësues ligjor ky avokat dhe nuk është pranuar nga ish-nënkryetarja e gjykatës, znj. G. Xh.. Madje në atë vendim, ish-nënkryetarja e gjykatës, në mënyrë të shprehur, ndalon hartimin e kërkesave të tjera të ngjashme me të njëjtin objekt (heqje dorë për shkak të pajtimit të av. S. K.). Vendimi i ish-nënkryetares G. Xh., datë 12.4.2021, dhe kërkesa e subjektit bashkëlidhur<sup>98</sup>.

---

<sup>98</sup>Për detaje shihni prapësimet e subjektit të datës 9.6.2022.



## Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

10.25.12 Komisioni vëren se subjekti ka depozituar dokumentacion provues, ku ai ka paraqitur kërkesën për dorëheqjen në lidhje me av. D. B., si dhe nga ana e tij është vendosur me vendim përfundimtar rrëzimi i padisë.

10.25.13 Shpjegimet e subjektit në lidhje me vendimin për pezullimin e gjobës nuk janë bindëse, pasi ai në të gjitha rastet e tjera në vendimet e tij shprehet se ankimi kundër vendimit të gjobës nuk pezullon veprimet përmbarimore për pezullimin e gjobës. Komisioni konstaton se nga subjekti, ndryshe nga sa është argumentuar me lart është marrë një vendim, që bie ndesh me vetë argumentimet e depozituara prej tij, të cilat janë vlerësuar nga Komisioni dhe nuk janë konsideruar si shkak për vlerësimin profesional, për sa kohë kanë lidhje me bindjen e brendshme të tij.

10.25.14 Në përfundim, Komisioni konstaton se ky vendim i subjektit bie ndesh me argumentet dhe vendimet e tjera të subjektit, duke aplikuar kështu standarde të dyfishta për çështje të ngjashme dhe, për rrjedhojë, subjekti ka treguar njohuri, aftësi dhe gjykim të dobët në drejtim të aspektit të njohurive ligjore dhe të aspektit të arsytimit ligjor, në kuptim të pikave 2 dhe 3, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016.

### 10.26 Denoncimi i shtetasit E. V.<sup>99</sup>

1. Denoncuesi pretendon se ka pasur njohje shoqërore me subjektin, pasi kanë kryer shkollën e mesme bashkë, gjithashtu, në kohën kur kanë qenë student në shtetet respektive, në T. denoncuesi dhe në Poloni subjekti, janë takuar si miq të mirë gjatë periudhës së pushimeve verore.

Ata janë takuar edhe kur subjekti ka qenë gjyqtar. Faktin e njohjes e vërteton edhe me mesazhin e urimit në aplikacionin *facebook*, ku më 24.8.2017 e ka uruar për ditëlindje. Në datën 19.5.2017 në kohën që ka kryer detyrën e drejtorit të ALUIZNI-t Vlorë, i ka ardhur një mesazh nga babai i subjektit B. Sh., i cili ka kërkuar ta takojë për dosjen e legalizimit të banesës në \*\*\*. Ai deklaron se babai i subjektit i ka dërguar mesazhe të vazhdueshme gjatë kohës që dosja ka qenë duke u trajtuar nga institucioni që drejtonte. Denoncuesi deklaron se duke parë mesazhet e z. B. Sh. ka parë dhe numrin e subjektit dhe i ka shkruar. Subjekti i ka shkruar në lidhje me çështjet gjyqësore të ngritura prej atij që ishin duke u zhvilluar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke i thënë se kishte shkelur rëndë ligjin. Nga ana e tij ai i ka thënë se mesazhi ishte thjesht për ta përshëndetur. Ndërkohë që sipas tij, subjekti e ka kërcënuar që do t'i vinte gjobë dhe se mesazhet e tij do t'i bënte *screen shot* dhe do t'ia niste Kryeministrit. Denoncuesi vijon të deklarojë se në vazhdim ishte vënë në dijeni me vendimmarrjet të cilat i ishin komunikuar nëpërmjet bisedave telefonike me subjektin. Më tej, vijon të parashtrojë situatën gjyqësore, e cila është trajtuar në rezultatet e hetimit në pikën 2 të pjesës me emërtim “në lidhje me denoncimet e bërë në mediat *online*”.

Në përfundim, denoncuesi pretendon se subjekti duhej të kishte dhënë dorëheqjen për shkak të rrethanave të ngushta miqësore dhe për shkak të komunikimeve të tij paraprake në lidhje me këto çështje.

Z. E. V. është një nga paditësit për të cilët subjekti ka marrë masën e vendosjes së gjobës dhe rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë me vendim e datës 4.12.2018, trajtuar në rezultatet e hetimit në pikën 2 të pjesës me emërtim “në lidhje me denoncimet e bërë në mediat *online*”

Denoncuesi ka vënë në dispozicion mesazhet që ka shkëmbyer me subjektin<sup>100</sup>.

<sup>99</sup>Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2022.

<sup>100</sup>Shihni provat që shoqërojnë denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2022.

Bazuar në komunikimin e mësipërm, duket sikur subjekti ka pasur njohje dhe miqësi me z. E. V., si dhe është shprehur në lidhje me vendimmarrjen për një çështje gjyqësore që ka pasur në shqyrtim. Gjithashtu, duket se subjekti ka përdorur një gjuhë dhe komunikim që nuk përputhet me etikën e magistratit.

Në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: 4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njëjës apo tjetrës palë; 6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”.

10.26.1 Për sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se:

- Subjekti ka marrë vendimin në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka pasur njohje me paditësin, si dhe ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim fakte të cilat provohen nga komunikimi telefonik.
- Komunikimi i subjektit me një palë në proces, si dhe gjuha e përdorur prej tij përbëjnë sjellje dhe aktet të papërshtatshme që nuk përputhen me detyrën e magistratit. Për rrjedhojë, duket se subjekti ka cenuar besimin e publikut të drejtësia.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.26.1.1 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, ndër të tjera, ka shpjeguar se *së pari* shtetasi E. V., prej vitit 2019 rezulton të jetë i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë për shpërdorim të detyrës të parashikuar si vepër penale e posaçme në nenin 248 të Kodit Penal. Subjekti vë në dijeni Komisionin për këtë fakt, për të treguar se cili është ky person, besueshmërinë e tij dhe vërtetësinë e mundshme të deklaratave të tij.

*Së dyti*, komunikimi i kryer ndërmjet subjektit dhe tij nuk ekziston dhe janë totalisht krijim i tij. Ky individ i ka shkruar në telefonin e tij pak ditë pas rrëzimit të kërkesës së tij për sigurimin e padisë, duke e shantazhuar se kishte legalizuar pronën e babai të subjektit B. Sh., gjatë kohës kur ushtronte detyrën e ish-drejtorit të ALUIZNI-t Vlorë. Si rrjedhim, subjekti duke mos i pranuar kërkesën e tij, kishte treguar mosmirënjohje ndaj tij. I vetmi mesazh i subjektit ka qenë jo më shumë se dy rreshta apo maksimumi tre, ku me sa mban mend ishte: “*Guxim të madh ke që shantazhon një gjyqtar. Çështjen tënde do t’ia kalojë organeve kompetente*”. Ky ishte i vetmi mesazh që subjekti i ka shkruar.

*Së treti*, gjithë komunikimi i depozituar pranë Komisionit në formën *screenshot* është tërësisht i stisur dhe i manipuluar. Subjekti kujton se një komunikim i tillë mund të bëhet lehtësisht fare, mjafton që të merren dy numra telefoni, të vendoset fotografia në të dhe të shënohet emri B. Sh. dhe komunikimi rezulton se është kryer nga subjekti.

*Së katërti*, në lidhje me shoqërinë dhe njohjen me ankuesin, subjekti shpjegon se ajo nuk është asgjë më shumë se njohja e pak më shumë midis dy të panjohurve. Me të është njohur në rrjetet sociale, si dy ish-studentë, të cilët studionin jashtë gjatë viteve 2005-2010. Nëse do të kishte një shoqëri më të madhe me të, atëherë padiskutim do të kishte parashtruar dorëheqjen ose do të kishte pranuar kërkesën e tij. Por jo vetëm këtë gjë nuk e ka bërë, por madje e ka dënuar me gjobë për ngritjen e shumë kërkesave të njëjta.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.26.2 Komisioni vëren se subjekti pretendon se nuk ka njohje me z. E. V., duke i konsideruar mesazhet si jo të vërteta.

10.26.3 Subjekti me dërgimin e njoftimit të seancës është orientuar që t'i drejtohet kompanisë telefonike, ku janë të regjistruar numrat e tij të telefonit për të vërtetuar për sa pretendohet nga ana e tij (pra, që ka vetëm një mesazh me denoncuesin dhe jo disa, sikundër pretendohet nga denoncuesi).

10.26.4 Në lidhje me këtë orientim të Komisionit, subjekti ka kërkuar shtyrjen e datës së shpalljes së vendimit me argumentin se kompania “\*\*\*\*” do të kthente përgjigje brenda 5 ditëve. Komisioni, në seancë përpara shpalljes së vendimit, i njoftoi subjektin të rivlerësimit mospranimin e kërkesës së tij, duke e konsideruar atë si të panevojshme, bazuar në pikën 6/a të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me barrën e provës, subjektin nuk është shprehur, pasi ka pretenduar se ka nuk ka njohje me z. E. V.. Ai nuk është shprehur as në lidhje me komunikimet e babait të tij me z. E. V.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se ky denoncim dhe provat bashkëlidhur mbeten në kuadër deklarativ dhe të njëanshme, për sa kohë kemi të bëjmë me komunikime nëpërmjet rrjetit të internetit dhe faktit që vetë denoncuesi nuk ka provuar vërtetësinë e tyre nga kompania celulare që administron numrin e tij të telefonit apo edhe të subjektin të rivlerësimit apo në ndonjë formë tjetër të parashikuar nga ligji.

#### **10.27 Në denoncimin e z. E. V. gjendet dhe ankesa e znj. T. M., me detyrë kancelare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, deri në dhjetor të vitit 2021.**

Në lidhje me ankesën e znj. T. M., në prapësimet e tij, subjekti argumentoi se ato nuk duhen marrë në konsideratë, për arsye se janë bërë nga një person në emër të dikujt, pa pasur një prokurorë përfaqësues dhe se këto ankesa janë trajtuar më parë nga ILD-ja dhe KLGJ-ja. Edhe denoncuesja pretendon se i është drejtuar edhe KLGJ-së në lidhje me problematikat në vijim:

**Me vendimin nr. s’ka, datë 12.12.2019**, me palë paditëse S. M., palë të paditur Bashkia Vlorë dhe objekt “shfuqizim i aktit administrativ”, ky gjyqtar ka vendosur bashkimin e kësaj çështjeje me një çështje tjetër gjyqësore, duke vendosur në dispozitiv detyrimin e kancelares së gjykatës për kryerjen e veprimeve administrative për bashkimin e çështjeve dhe duke e vendosur kancelaren në dispozitiv si palë në proces, pasi urdhëron lajmërimin e saj me dëftesë komunikimi.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe në çështjen me nr. s’ka vendimi, datë 8.5.2020, me palë paditëse shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., i paditur \*\*\* etj., dhe objekt “shfuqizim akti”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga denoncuesja konstatohet se subjekti me vendimin e datës 12.12.2019 dhe datë 8.5.2020, në pikën 3 të dispozitivit të këtyre vendimeve shprehet se: *“Urdhërohet kancelaria gjyqësore e Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Vlorë të kryejë shënimet përkatëse në regjistrat e regjistrimeve të padive që çështjet...janë bashkuar...”*.

10.27.1 Në lidhje me sa më lart, nga Komisioni është konstatuar se subjekti në më shumë se një vendim ka përfshirë si palë në gjykim një punonjëse të administratës, duke e urdhëruar për kryerjen e veprimeve konkrete, vendim i cili duket se nuk përputhet me dispozitat e kodit të procedurës civile dhe, për rrjedhojë, nuk është i argumentuar.

Për konstatimin e mësipërm, subjektin iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektin të rivlerësimit**

10.27.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se në lidhje me detyrimin e saj për të bërë disa veprime administrative për të penguar

manipulimin e shortit elektronik, argumentoi se është detyrim i kancelarit gjyqësor për të hedhur shortin elektronik, në përputhje me ligjin sanksionohet në nenin 25§1,2 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Sakaq, neni 5§2, i vendimit numër \*\*\*, datë 24.12.2008, “Për procedurat e ndarjes në short të çështjeve gjyqësore”, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë sanksionon në mënyrë të shprehur, që kancelaria gjyqësore duhet të mbajë një regjistër apo indeks, për të shënuar të gjitha paditë e regjistruara pranë gjykatës, me qëllim që të parandalohen paditë e dyfishta, të cilat synojnë për zgjedhjen e gjyqtarit (vendimi i KLD-së bashkëlidhur). Në këtë frymë, edhe urdhërimi i tij vinte, pikërisht, bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara. Një urdhërim i tillë nga gjyqtari për kancelaren gjyqësore apo kryesekretaren gjen pasqyrim në Kodin e Procedurës Civile. Sakaq, edhe praktika gjyqësore njeh me dhjetëra raste, kur urdhërohen organe të tjera, jo palë në proces, për të bërë një verifikim konkret administrativ (detyrimin e zyrës së gjendjes civile për të bërë ndryshimin e mbiemrit të bashkëshortëve në vendimin e zgjidhjes së martesës, detyrimin e agjencisë së kadastrës për të regjistruar si pronar gjyqfituesin me parashkrim fitues etj.).

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.27.3 Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit nuk lidhen me sa i është kërkuar në barrë prove, për rrjedhojë, Komisioni konstaton se subjekti në më shumë se një vendim ka përfshirë si palë në gjykim një punonjëse të administratës së gjykatës, duke e urdhëruar për kryerjen e veprimeve konkrete, vendim i cili nuk përputhet me dispozitat e kodit të procedurës civile dhe, për rrjedhojë, nuk është i argumentuar.

Për sa më sipër, subjekti ka treguar njohuri, aftësi dhe gjykim të dobët në drejtim të aspektit të njohurive ligjore dhe të aspektit të arsytimit ligjor, në kuptim të pikave 2 dhe 3, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, pasi ka përfshirë në vendim detyrimet për një punonjëse të administratës pa qenë pjesë e gjykimit dhe e objektit të padisë.

### **Me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.4.2018, gjyqtari Bevis Shehaj ka vendosur pranimin e padisë me palë të paditur ZVRPP-në Vlorë, me objekt “kundërshtim akti administrativ”.**

Me shkresën me nr. \*\*\* prot., të vitit 2018, gjyqtari Bevis Shehaj i kërkon shpjegime titullarit të institucionit z. S. B., në lidhje me mosushtrimin e ankimit në lidhje me vendimmarrjen pozitive të vetë gjyqtarit.

10.27.4 Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga denoncuesja konstatohet se: “Bazuar në shkresën, datë 8.6.2018, drejtuar ZVRPP-së Vlorë dhe për dijeni znj. E. Gj. Ministre e Drejtësisë, z. V. P. Kryeregjistrues i ZQRPP-së Tiranë dhe znj. A. H. Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, subjekti shprehet se gjykata konstatoi se subjekti ZVRPP Vlorë, në kundërshtim me praktikën e punës së saj, nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit brenda afatit prej 15-ditëve. Në këto kushte, gjykata kërkon prej regjistruesit të ZVRPP-së Vlorë të japë informacion se përse ndaj vendimit nuk është ushtruar e drejta e ankimit, ndërsa ndaj këtij vendimi, i cili prek një pasuri dhe interesa relativisht të mëdha nuk është ushtruar ankim gjykata fton Ministrin e Drejtësisë, Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit, por dhe kryeregjistruesin e ZQRPP-së Tiranë, të ndërmarrin një hetim administrativ dhe rezultati i tij t’i komunikohet gjykatës.

Komisioni konstaton se veprimet e mësipërme të subjektit duket se nuk mbështeten në Kodin e Procedurës Civile, si dhe përbëjnë sjellje dhe akte të papërshtatshme që nuk përputhen me detyrën e magjistratit.

10.27.5 Komisioni ka konstatuar se subjekti, nëpërmjet kësaj shkrese ka kërkuar që të ankimohet vendimi i dhënë prej tij, veprim i cili vë në pikëpyetje ligjshmërinë e vendimit të

dhënë nga subjekti, si dhe përbën sjellje të papërshtatshme që nuk përputhet me detyrën e magistratit. Për rrjedhojë, duket se subjekti ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.

Për konstatimin e mësipërm, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.27.6 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se në lidhje me kallëzimin në çështjen R. I. kundër ZVRPP-së Vlorë, përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.4.2018 (vendimi bashkëlidhur), shpjegon se nuk ka kërkuar në asnjë moment që kundër këtij vendimi të bëhet ankim, ashtu sikundër Komisioni ka dalë në konstatim, duke i ngarkuar barrën e provës apo sikundër ka pretenduar denoncuesja. Thjesht, nga informacionet që kishte subjekti, kundër këtij vendimi nuk do të bëhej ankim, pasi Kryetari i Bashkisë Vlorë ishte gati për të nxjerrë një leje ndërtimi për një objekt shumëkatësh në zonën e shëtitorës bregdetare në qytetin e Vlorës dhe pritej vetëm vendimi për heqjen e urdhrit të kufizimit. Ky qëndrim i organit publik për të mos bërë ankim vinte në kundërshtim me praktikën dhe urdhrin e brendshëm të ish-ZVRPP-ve për të ankimuar çdo vendim të gjykatës, i cili shfuqizonte një akt të tyre. Subjekti, pasi u bind që ata nuk kishin asnjë arsye të ligjshme për të mos bërë ankim, ka ushtruar kallëzimin penal. Nga dijenia e subjektit, si pasojë e këtij informacioni që ai parashtrroi pranë Ministrisë të Drejtësisë dhe pranë Avokaturës së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme Tiranë, avokati i shtetit, z. B. B. dhe drejtori i ish-ZVRPP-së Vlorë, z. S. B., janë shkarkuar nga detyra, pikërisht, për këtë shkelje, duke mosankimuar një vendim gjyqësor, i cili kishte konstatuar në shkelje organin publik. Subjekti ka bashkëlidhur edhe vendimin e pranimit ankimit për t'ju treguar se si ish-kancelaria gjyqësore (ankuesja) me metoda jo të ligjshme, bëri të gjitha përpjekjet për t'i dhënë këtij vendimi formë të prerë (nuk i ka komunikuar zyrtarisht vendimin Avokaturës së Shtetit, me dëftesë të posaçme komunikimi, por ja ka dhënë dorazi një avokat shteti, me shumë vendime të tjera, me qëllim ngatërrimin e tij). Subjekti shpjegon se kallëzimi penal është një detyrim që rëndon mbi çdo zyrtar publik, bazuar në nenin 281 të Kodit të Procedurës Penale. Si rrjedhim, ndodhur përpara këtij detyrimi ligjor, ka ndërmarrë të gjitha veprimet për të bërë një punë verifikuese (korrespondenca me organet publike), përpara se të depozitohet kallëzimin penal në prokurori.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.27.7 Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit nuk përputhen me veprimet e tij dhe me sa ka parashtruar në shkresë. Pasi nga ana e tij në këtë shkresë është pretenduar se vendimi i dhënë prej tij nuk është ankimuar. Gjithashtu, nga verifikimi i pranimit të ankimit duket se subjekti sërish është në shkelje të Kodit të Procedurës Civile, pasi ka pranuar një ankim tej afatit të njoftimit.

Në përfundim, Komisioni duke marrë në konsideratë faktin se subjekti ka dërguar një shkresë nëpërmjet së cilës ka kërkuar që të ankimohet vendimi i dhënë prej tij, duke vënë në pikëpyetje ligjshmërinë e vendimit vlerëson se përbën sjellje të papërshtatshme që nuk përputhet me detyrën e magistratit dhe, për rrjedhojë, subjekti ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.

### **Gjyqtari në mënyrë të vazhdueshme ka vendosur gjoba ndaj përfaqësuesve në gjykimet e çështjeve administrative (juristëve të institucioneve) dhe jo për titullarët e institucioneve siç e parashikon ligji.**

Dy raste konkrete denoncuesja i ka bashkëlidhur në ankesë, ku ky gjyqtar i ka vënë gjobë juristes së Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë, me arsyetimin e kërkesave abuzive procedurale, gjobë që i është hequr, më pas, me vendim gjyqësor të një trupe tjetër gjyqësore, por që i është rivendosur përsëri po nga ky gjyqtar.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga denoncuesja konstatohet se:

Bazuar në vendimin nr. \*\*\*, datë 28.1.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë rezulton se:

Subjekti, me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.11.2018, i ka vënë gjobë juristes O. M. në shumën 50.000 lekë, për kërkesë abuzive, pasi ka kërkuar shpalljen jashtë juridiksionit.

Ky vendim i subjektit duket se nuk është i argumentuar, si dhe nuk përputhet me Kodin e Procedurës Civile, pasi nuk mund të konsiderosh kërkesë abuzive një kërkesë paraprake në një proces gjyqësor.

10.27.8 Komisioni ka konstatuar se subjekti ka cenuar të drejtat procedurale të palës në proces, duke u përpjekur t'i kufizojë ato nëpërmjet mekanizmit të vënies së gjobave, të cilat duket se përbëjnë sjellje dhe aktet të papërshtatshme që nuk përputhen me detyrën e magjistratit. Për rrjedhojë, duket se subjekti ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.

Për konstatimin e mësipërm, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### 10.27.9 Komisioni vëren se subjekti nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me këtë konstatim.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti ka cenuar të drejtat procedurale të palës në proces, duke u përpjekur t'i kufizojë ato nëpërmjet mekanizmit të vënies së gjobave të cilat përbëjnë sjellje dhe aktet të papërshtatshme që nuk përputhen me detyrën e magjistratit. Për rrjedhojë, subjekti ka cenuar besimin e publikut te drejtësia. Gjithashtu, subjekti ka treguar njohuri, aftësi dhe gjykim të dobët në drejtim të aspektit të njohurive ligjore dhe të aspektit të arsytimit ligjor, në kuptim pikave 2 dhe 3, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016.

Vendimi i mësipërm është deklaruar i pavlefshëm me vendim nr. \*\*\*, datë 28.1.2019, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë. Pavarësisht këtij vendimi, subjekti sërish në përfundim të gjykimit me vendim përfundimtar nr. \*\*\*, datë 29.7.2020, ka vendosur gjobë në shumën 50.000 lekë, për znj. O. M., si pasojë e ngritjes së kërkesave procedurale abuzive.

10.27.10 Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka argumentuar dhënien e vendimit me gjobë ndaj znj. O. M., si dhe nuk ka respektuar vendimin e mëparshëm të gjykatës, e cila e ka shpallur të pavlefshëm vendimin e tij për vendosjen e gjobës dhe përbën gjë të gjykuar.

Për rrjedhojë, duket se këto veprime të subjektit përbëjnë sjellje dhe akte të papërshtatshme që nuk përputhen me detyrën e magjistratit, veprime të cilat duket se cenojnë besimin e publikut te drejtësia.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### 10.27.11 Subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime, për sa është konstatuar nga Komisioni.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka argumentuar dhënien e vendimit me gjobë ndaj znj. O. M., si dhe nuk ka respektuar vendimin e mëparshëm të gjykatës, e cila e ka shpallur të pavlefshëm vendimin e tij për vendosjen e gjobës, duke përbërë gjë të gjykuar dhe, për rrjedhojë, subjekti ka treguar njohuri, aftësi dhe gjykim të dobët në drejtim të aspektit të njohurive ligjore dhe të aspektit të arsytimit ligjor, në kuptim të pikave 2 dhe 3, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016

Gjithashtu, Komisioni vlerëson se veprimet e subjektit përbëjnë sjellje dhe akte të papërshtatshme që nuk përputhen me detyrën e magjistratit, veprime të cilat cenojnë besimin e publikut te drejtësia.

Në lidhje me çështjen gjyqësore me palë paditëse D. H. dhe palë të paditur Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë etj., subjekti në seancën e datës 25.9.2020 ka vendosur të gjobisë znj. B. A. në vlerën 100.000 lekë, pasi nuk ekzekuton një vendim gjykate. Këtë vendim e ka revokuar në datën 22.10.2020.

10.27.12 Komisioni ka konstatuar se:

- Subjekti ka marrë një vendim ndaj shtetases B. A. pa qenë palë në proces dhe pa i respektuar të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.
- Është e paqartë se në cilën bazë ligjore është bazuar subjekti për të ngarkuar me gjobë znj. A., ku nuk ka qenë palë në proces

Për sa më sipër, bazuar në konstatime e mësipërme, duket se vendimi i marrë nga subjekti është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt gjyqësor i zhvilluar në shkelje të rregullave procedurale, duke cenuar dhe të drejtat e palëve.

Për konstatimet e mësipërme, subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

10.27.13 Komisioni vëren se subjekti nuk ka dhënë shpjegime për konstatimin e Komisionit.

Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar njohuri, aftësi dhe gjykim të dobët në drejtim të aspektit të njohurive ligjore, si dhe të aspektit të arsytimit ligjor, në kuptim të pikave 2 dhe 3, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, si dhe ka cenuar të drejtat e znj. A. për një proces të rregullt duke e gjobitur pa qenë palë në proces.

**Në lidhje me çështjen (kërkesën) me nr. \*\*\* akti, datë 8.9.2020, me objekt “vendosje e sanksionit ligjor për mosekzekutim vendimi”, rezulton se gjyqtar K. Dh. ka dalë me vendimin përfundimtar nr. \*\* prot., datë 18.11.2020, ndërkohë që gjyqtari Bevis Shehaj, në lidhje me këtë çështje, ka vendosur përjashtimin e gjyqtarit K. Dh. në datën 16.12.2020, me nr. \*\* vendimi.**

10.27.14 Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga denoncuesja konstatohet se: subjekti në datën 16.11.2020 ka mbajtur procesverbal për kërkesën për përjashtim të gjyqtarit K. Dh.. Në datën 7.12.2020 ka mbajtur procesverbal për kërkesën me objekt për përjashtimin e gjyqtarit K. Dh.. Në këto seanca kërkuar vendosjen në dispozicion të dokumentacionit të çështjes gjyqësore të shqyrtuar nga gjyqtari K. Dh., duke iu drejtuar sekretares të tij. Seanca e radhës është caktuar në datën 14.12.2020. Në seancën e datës 14.12.2020, subjekti ka vendosur pranimin e kërkesë për përjashtim. Nga regjistri i vendimeve konstatohet se kërkesa për përjashtim i ka kaluar për shqyrtim subjektit që në datën 11.11.2020.

Në datën 18.11.2020 gjyqtari K. Dh. ka dhënë vendim përfundimtar në lidhje me çështjen për të cilën subjekti ka vendosur përjashtim e tij.

10.27.15 Komisioni ka konstatuar se, duket se:

- subjekti ka zvarritur gjykimin e kërkesës për përjashtim ndaj gjyqtarit K. Dh.;
- subjekti i është drejtuar sekretares së gjyqtarit K. Dh., veprim i cili nuk përputhet me Kodin e Procedurës Civile;
- është e paqartë baza ligjore ku është bazuar subjekti për t’ju drejtuar sekretares së gjyqtarit K. Dh.;
- është e paqartë se pse subjekti ka kryer tri seanca për një kërkesë për përjashtim.

Për konstatimet e mësipërme, subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

10.27.16 Komisioni vëren se subjekti nuk ka dhënë shpjegime për konstatimin e Komisionit.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka zvarritur pa arsye gjykimin e kërkesës për përjashtim të një subjekti tjetër, për rrjedhojë, ka treguar sjellje të papërshtatshme dhe një mënyrë punë që nuk pajtohet me pozicionin e tij. Gjithashtu, subjekti ka demonstruar defekte në aspektin e aftësive organizative, sipas nenit 74/1-3 të ligjit nr. 96/2016.

**Në një çështje gjyqësore me palë paditëse A. A. dhe palë të paditur Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, me objekt “kundërshtim akti administrativ, me nr. \*\*\* akti, datë 1.9.2020 regjistrimi”, gjyqtari Bevis Shehaj ka kërkuar përjashtimin e tij nga kjo çështje me arsyetimin se avokat i çështjes është E. H., madje ka kërkuar edhe ndryshimin e sekretares për shkak se ka marrëdhënie në raport kunat-kunatë me avokatin.**

Nga dosja nuk rezulton në asnjë moment, as me prokurë dhe as me deklaratë që avokati të ketë qenë përfaqësues i palës apo është paraqitur ndonjëherë në gjykim, ndërkohë gjyqtari si në vendimmarrje edhe në procesverbale e ka bërë avokatin pjesë të procesit. Madje gjatë procesit e ka ngarkuar avokatin me gjobë. Ai ka deklaruar se ky avokat rishtazi ka bërë kërkesa për përjashtim për gjyqtarin, ndërkohë që në Gjykatën Administrative nuk rezulton e regjistruar asnjë kërkesë për përjashtim prej avokazit.

10.27.17 Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga denoncuesja konstatohet se subjekti në datën 6.11.2020 ka paraqitur kërkesë për zëvendësimin e sekretares, pasi në datën 6.11.2020 ka vendosur të përjashtojë nga asistimi në gjykim sekretaren gjyqësore F. H., e cila ndodhej nën një marrëdhënie krushqie me përfaqësuesin ligjor të subjektit paditës në gjykim z. E. H.

10.27.18 Komisioni ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë dhe të depozitojë dokumentacionin përkatës, lidhur me pretendimet e ankuesit dhe me veprimtarinë procedurale, deri në njoftimin e vendimit përfundimtar palëve në gjykim.

10.27.19 Komisioni vëren se subjekti nuk ka dhënë shpjegime për konstatimin e Komisionit.

10.27.20 Komisioni nuk mund të kryejë një vlerësim në lidhje me këtë pretendim të denoncuesit, pasi subjekti ka refuzuar të depozitojë dokumentacion e kërkuar. Ky refuzim i subjektit do të vlerësohet në një vlerësim tërësor të procedurave.

**Denoncuesja ka paraqitur edhe shkresën e datës 9.11.2020, sipas së cilës subjekti i drejtohet Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke u shprehur si vijon: “Ju ftoj që IT e gjykatës znj. R. Sh. ta konsideroni si bashkëpunëtore të drejtësisë duke i ulur apo përjashtuar nga përgjegjësia penale me kushtin që të deklarojë zyrtarët e tjerë të përfshirë në këtë akt kriminal, sikundër mund të jetë kancelaria apo gjyqtari K. Gj. i njohur ndryshe si K. Dh.”.**

10.27.21 Komisioni ka kërkuar nga subjekti që të japë shpjegime në lidhje me sa më lart, pasi duket se veprimet e tij përbëjnë sjellje, që nuk përputhen me detyrën e magjistratit, si dhe nuk janë të bazuar në Kodin e Procedurës Civile apo Penale, veprime të cilat duket se cenojnë besimin e publikut te drejtësia.

10.27.22 Komisioni vëren se subjekti nuk ka dhënë shpjegime për konstatimin e Komisionit.

10.27.23 Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se përmbajtja e shkresës së dërguar nga subjekti një organi të pavarur nga gjykata, duke e orientuar në lidhje me veprimtarinë e tij, si dhe duke supozuar fajësinë e punonjësës së tij janë veprime të pabazuara në ligj, që përbëjnë sjellje dhe aktet të papërshtatshme që nuk përputhen me detyrën e magjistratit, veprime të cilat cenojnë besimin e publikut te drejtësia.

**Denoncuesja ka paraqitur edhe praktikën e çështjes të z. M., e cila është trajtuar në rezultate e hetimit.**



10.27.24 Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, rezulton se z. M. ka depozituar në datën 16.7.2020 një kërkesë padi të re, e cila i ka rënë me short sërish subjektit të rivlerësimit. Në datën 20.7.2020 z. M. ka paraqitur kërkesën për përjashtim të subjektit, e cila në datën 27.7.2020, me vendimin nr. \*\*\* është pranuar. Nga subjekti, deri në datën e shkresës, pavarësisht vendimit për përjashtimin e tij, nuk është depozituar dosja ende në kryesekretari për t'u rishortuar.

Në dokumentacionin e depozituar gjendet dhe një korrespondencë midis subjektit dhe zv/kryetares së gjykatës, në lidhje me këtë çështje, ku subjekti pretendon se nuk ka sekretare dhe nuk është përgjegjësia e tij dërgimi në kryesekretari të dosjes. Në këtë shkresë komunikimi i subjektit nuk përputhet me etikën e magjistratit.

10.27.25 Komisioni ka konstatuar se:

- Subjekti nuk ka depozituar në kohë dosjen gjyqësore në kryesekretari.
- Subjekti ka zvarritur me dashje procesin gjyqësor të shtetasit F. M. duke cenuar të drejtën e tij ligjore për një proces të rregullt dhe brenda afateve të arsyeshme.

Për konstatimet e mësipërme, subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

10.27.26 Komisioni vëren se subjekti nuk ka dhënë shpjegime për konstatimin e Komisionit.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka zvarritur pa arsye depozitim të dosjes gjyqësore në kryesekretari, për rrjedhojë, ka zvarritur me dashje procesin gjyqësor të z. M. (të cilit sikundër është trajtuar në pikën 10.21 të këtij vendimi i ka cenuar të drejtat e tij), duke i cenuar të drejtat e tij për një proces të rregullt dhe brenda një afati të arsyeshëm, si dhe ka demonstruar defekte në aspektin e aftësive organizative sipas nenit 74/1-3 të ligjit nr. 96/2016.

**Denoncuesja e vijon ankimin e saj, por duke qenë se kjo pjesë e ankimit nuk lidhet me vlerësimin profesional të subjektit, por me marrëdhënien e punës midis denoncueses dhe të tij si zv/kryetar i gjykatës, Komisioni nuk do ta përfshijë në rezultatet e hetimit.**

Subjekti, në prapësimet e tij, ka dhënë shpjegime të cilat nuk është e nevojshme të trajtohen hollësisht, për sa kohë, Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove apo i ka kërkuar shpjegime.

#### ***Në lidhje me kriterin e aftësive profesionale***

Në një vlerësim të përgjithshëm të mangësive të konstatuara nga Komisioni, në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit, arrihet në konkluzion se pavarësisht numrit të tyre ato nuk duket se përkufizojnë subjektin si një magjistrat me nivel të aftësive që do ta bënin atë të papërshtatshëm në kuptim të germës “c”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016.

Ndonëse nuk konsiderohet si i paaftë apo i papërshtatshëm, Komisioni çmon se natyra dhe numri i problematikave të konstatuara gjatë analizimit të çështjeve, si më lart, ngrenë pikëpyetje serioze për aftësitë profesionale të subjektit dhe mënyrën se si ka performuar, duke e çuar Komisionin në përfundim se vlerësimi për kriterin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit duhet të bëhet, sipas germës “b”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me mangësi.

Komisioni, ndërsa arrin në konkluzion e mësipërm në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit, duke konsideruar edhe problematikave të konstatuara në kriterin e pasurisë, çmon se nuk është i aplikueshëm rekomandimi për ndjekjen e programit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, por shihet i arsyeshëm një vlerësim i përgjithshëm i këtyre rezultateve në këndvështrim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Në një analizë të përgjithshme të të gjitha konkluzioneve të arritura në këtë proces dhe të arsyetuara në vendim, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti disponon pasuri, për të cilat

ai dhe personat e lidhur/të tjerë të lidhur me të rezultojnë me mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, por edhe ka rezultuar se një pjesë e denoncimeve të publikut, si shprehje e mosbesimit ndaj mënyrës se si ka ushtruar funksionet e gjyqtarit, kanë qenë të drejta. Në këtë këndvështrim, Komisioni, bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>101</sup>, arrin në konkluzion se plotësohen kushtet dhe rrethanat për zbatimin e nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016 dhe shkarkimin e subjektit nga detyra. Përfundimisht, Komisioni arriti në konkluzionet e mëposhtme mbi të cilat disponoi për zgjidhjen e çështjes.

## **VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

Lidhur me kriterin e pasurisë

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Bevis Shehaj:

- Ka kryer deklarin të pasaktë dhe deklarin të pamjaftueshëm, për arsye se rezultoi me mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e pasurisë apartament dhe garazh.

Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e krijimit të këtyre pasurive me të ardhura të ligjshme (deklaruar si burim të ardhurat nga prindërit e tij), pasi nga analiza financiare, prindërit e tij kanë rezultuar me një balancë negative në shumën 46.763.434 lekë, për periudhën 1994 – 17.11.2011, e cila rritet në masën **-63.544.081** deri më 20.11.2015, përfshirë edhe të ardhurat e subjektit. Ndërsa, duke iu referuar vetëm pasurisë apartament dhe garazh të deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe konsiderimit të prindërve si persona të tjerë të lidhur, subjekti rezultoi në pamundësi financiare për pagesën e shumës 3.518.000 lekë, kjo për arsyen se rezultoi me një balancë negative në shumën 6.905.990 lekë.

Deklarimet e subjektit, për sa kohë nuk janë të shoqëruara me dokumentacion provues, mbeten në nivel deklarativ, duke mbetur e paprovuar për Komisionin vlera reale e paguar nga subjekti për këtë apartament, si dhe zbritja e çmimit në shumën 5.000 euro, e shoqëruar kjo me dokumentacionin përkatës mes palëve.

- Shkëputja e subjektit nga trangu familjar në shtator të vitit 2016, pas miratimit të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerëson se është kryer me qëllim mospërfshirjen e prindërve të tij në kategorinë e personave të lidhur dhe, për rrjedhojë, shmangien e tyre nga përgjegjësia ligjore për deklarimin e pasurive në deklaratën *Vetting*. Komisioni e konsideron këtë sjellje të subjektit të rivlerësimit si shmangie e qëllimtare në përmbushjen e detyrimeve ligjore, duke sjellë si pasojë cenimin e besimit të publikut te drejtësia.

Komisioni, marrë për bazë konkluzionet si më sipër, pavarësisht faktit se balanca negative është krijuar përpara ushtrimit të detyrës, marrë për bazë edhe parimin e proporcionalitetit, i konsideron ato si mëse të mjaftueshme për të kualifikuar subjektin e rivlerësimit, në kushtet e pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me kriterin e figurës

Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Bevis Shehaj është i përshtatshëm për

---

<sup>101</sup>Vendimet: nr. 26/2019; nr. 1/2020; nr. 2/2020; nr. 26/2020; dhe nr. 15/2021.

vazhdimin e ushtrimit të detyrës dhe, për rrjedhojë, ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e figurës.

Lidhur me kriterin e kontrollit të aftësive profesionale

Komisioni arrin në konkluzionin se:

a) Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të vlerësimit të duhur në lidhje me situatën e konfliktit, në dukje të interesit, për sa i përket pjesëmarrjes së tij në gjykimin e çështjeve gjyqësore në të cilat ka qenë palë ndërgjyqëse Spitali Rajonal V., ku ushtronte detyrën babai i subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, shfaq marrëdhënie interesi, si dhe drejtoresha e këtij spitali ka qenë një person me të cilin subjekti ka pasur njohje.

b) Lidhur me çështjet gjyqësore të analizuara konstatohen mangësi në drejtim të aftësive profesionale të subjektit, sidomos në aspektin e kufizimit të së drejtës të palëve për të aksesuar në gjykatë, pasi subjekti i rivlerësimit në disa raste ka vendosur gjoba ndaj palëve pa u përmbushur kriteret e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në ligjin nr. 49/2012.

Mangësitë e vërejtura në çështjet e mësipërme, përfshirë trajtimin jo në mënyrë të duhur të situatave të konfliktit në dukje të interesit, konsiderohen se janë qëndrime që kanë afektuar indikatorët e aftësive profesionale të gjyqtarit në aspektin e njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, parashikuar nga pikat 2 dhe 3, të nenit 72, si dhe aftësive organizative të parashikuara nga pikat 1-3, të neni 74, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, situatë e cila kualifikohet si nivel “me mangësi” i kriterit të aftësive profesionale, në kuptim të gërme “b”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016.

Në kushtet kur mangësitë e konstatuara në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale nuk janë të vetmet, por ato konstatohet se ekzistojnë krahas defekteve në drejtim të burimit të ligjshëm të pasurive të subjektit të cituara më lart, konsiderohen nga Komisioni se duhen vlerësuar në tërësi, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, si një nga alternativat e vlerësimit të kriteve të procesit të rivlerësimit të parashikuar nga ligji. Në zbatim të këtij parashikimi, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit dështoi të kalonte testin e moscenimit të besimit të publikut, për shkak të ekzistencës së të gjitha këtyre shkeljeve dhe se programi i trajnimit njëvjeçar në Shkollën e Magjistraturës nuk mund të shërojë këtë situatë në drejtim të rikuperimit të besimit të publikut, duke bërë të zbatueshëm në këto kushte, parashikimin pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, në pikat 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të pikave 1/c dhe 3 të nenit 58 dhe pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

## **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Bevis Shehaj, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 15.6.2022.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Kryesuese (kundër)**

**Olsi KOMICI**  
**Relator**

**Xhensila PINE**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Resilda Bilaj*